



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.81/1

4 qershor

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Studimi/Azhornimi i Master Planit për Portin e Durrësit,
miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.546, datë
28.5.2009

3



The European Union's EuropeAid – CARDS 2004


EuropeAid 122348/C/SER/AL

Krijimi / Azhornimi i Master Planit per Portin e Durrësit

Albania

Raporti Final

Korrik 2008



Krijimi/Azhornimi i Master Planit per Portin e Durrësit, Albania

Raporti Final





Barbarossastraat 35

Postbus 151

Nijmegen 6500 AD

The Netherlands

+31 (0)24 328 42 84 Telephone

+31 (0)24 328 93 46 Fax

info@royalhaskoning.com E-mail

www.royalhaskoning.com Internet

***Ky publikim eshte pergatitur me asistencen e Bashkimit European.
Permbajtja e ketij publikimi eshte pergjegjesi vetem e Konsulentit dhe
nuk mundet ne asnje menyre te merret si reflektim i pikepamjeve te
Bashkimit European.***

.



Tabela e Permbajtjes

- 1. Hyrje**
- 2. SWOT Analiza e Portit te Durrësit**
- 3. Situata Aktuale**
- 4. Parashikimi I Trafikut**
- 5. Infrastruktura e Duhur**
- 6. Studimi Ambjental Fillestar.**
- 7. Rishikimi i Kuadrit Ligjor dhe Institucional dhe Pjesmarja e Sektorit Privat ne Portin e Durrësit.**
- 8. Identifikimi I Opsineve te Zhvillimit dhe Zgjedhja e Alternatives se Preferuar**
- 9. Rekomandimet**

Annekset:

Aneksi 1	Planimetrite dhe Vizatimet
Aneksi 2	Vleresimi i Infrastruktures Ekzistuese
Aneksi 3	Parashikimi Trafikut
Aneksi 4	Preventivi
Aneksi 5	Analiza shume - kritereshe
Aneksi 6	Vleresimi Ambjental
Aneksi 7	Vleresimi Ekonomik
Aneksi 8	Projektet Konceptuale te Terminaleve
Aneksi 9	Plani i Biznesit te Portit te Durrësit
Aneksi 10	Politika Kombetare





Publikuar Korrik 2008

Ky publikim eshte kryer me asistencen e Bashkimit European .
Permbajtja e ketij publikimi eshte pergjegjesi e vetme e Konsorsiumit dhe te Partnereve te tij
dhe nuk mundet ne asnje menyre te merret si reflektim i pikpamjeve te Bashkimit European.

Raporti Kryesor

Percaktimi / Azhornimi i Master Planit te Portit te Durrës	
Komisioni Europian	
28 Mars 2008	
9S0723.21	

Barbarossastraat 35	
P.O. Box 151	
Nijmegen 6500 AD The Netherlands	
+31 (0)24 328 42 84	Telefon
++31 24 360 96 34	Fax
info@nijmegen.royalhaskoning.com	E-mail
www.royalhaskoning.com	Internet
Arnhem 09122561	CoC

Titulli i Dokumentit	Themelimi / Azhornimi i Masterplanit te Portit te Duresit
Titulli i Shkurter i Dokumentit	Drafti i Raportit Perfundimtar
Statusi	
Data	28 Mars 2008
Emri i Projektit	Percaktimi / Azhornimi i Masterplanit te Portit te Duresit
Numri i Projektit	9S0723.21
Klienti	Komisioni European
Referenca	9S0723.21/DFR/401180/Nijm

Ky publikim eshte pergatitur nen asistencen e Bashkimit European. Permbajtja e ketij publikimi eshte pergjegjesi e Keshilluesit dhe nuk duhet konsideruar si reflektim i pikepamjeve te Bashkimit European.

Hartuar nga	Ekipi i Royal Haskoning	
Kontrolluar nga	Filip Augustyns / Yann Pleindoux	
Data / Kontrolli Fillestar		
Aprovuar nga	Henry Opdam	
Data/aprovimi fillestar		

A COMPANY OF



ROYAL HASKONING

PERCAKTIMI/ AZHORNIMI I MASTERPLANIT TE PORTIT TE DURRESIT

HYRJE



Objektivat

Komisioni European (KE) dhe Autoriteti i Portit te Durrës (APD) kane perzgjedhur Royal Haskoning Nederland B.V. nga Hollanda qe te kryeje detyren themelore “122348/C/SER/AL Themelimi / Azhornimi i Masterplanit te Portit te Durrës, Shqiperi”.

Objektivat e Pergjithshme Objektivi i Pergjithshem eshte pergatitja e nje master plani strategjik te bazuar ne nje analize krahasuese te aktiviteteve portuale dhe perdorimeve te tokes, ne perputhje me çështjen e pergjithshme per sigurine dhe mjedisin. Objektivat e pergjithshme mund te permbliken si me poshte:

- Per te kontribuar ne zhvillimin ekonomik kombetar dhe rajonal te Shqiperise nepermjet zhvillimit te Portit te Durrës si pjese e nje porte me te gjere hyrese per Korridorin European VIII mes Italise dhe zones se Ballkanit.
- Per te prezantuar konventat moderne nderkombetare mbi aktivitetet portuale ne kuader te angazhimit te qeverise shqiptare per privatizimin dhe njohjen siç duhet te drejtimeve te zhvillimit ne tregtine detare mes vendeve fqinje.
- Per te rekomanduar nje perqasje te njohur si “praktika me e mire” per zhvillimin e Portit te Durrës, e cila eshte ne perputhje me rekomandimet e pergjitheshme qe gjenden ne Planin Kombetar te Transportit ne Shqiperi (PKI) te publikuar se fundmi.
- Arritjen e kesaj brenda nje “afati te planifikuar” dhe te realizueshem – ndoshta per nje peridudhe 20 apo 25 vjet ne total, por me afate te ndermjetme 5, 10 apo 15 vjeçare.



▪ **Objektivat Specifike**

- Përgatitja e një Master Plani gjithëpërfshirës, por duke patur parasysh aktivitetet ekzistuese planifikuese dhe Master Planin për qytetin e Durrësit.
- Formulimi i një Plan Biznesi Strategjik, i cili trajton aspektet ekonomike dhe financiare të portit dhe aktivitetet portuale.
- Krijimi i një "plani kohor" për zbatimin e Master Planit dhe Planit Strategjik të Biznesit.

DETYRIMET DHE ÇESHTJET KRITIKE

Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Portual ANTP rekomandon specializimin e portit. Kjo gjë do të kuptonte që Porti i Durrësit të përqendrohej tek shërbimet e kontenierëve, ngarkesave të përgjithshme dhe anijeve. Një strategji kombëtare për zhvillimin portual, sidoqoftë, nuk është krijuar ende. Është rekomanduar që një strategji e tillë të përgatitet urgjentisht për të ofruar direktiva për specializimin e portit, përfshirë prish. ndërtimin e një terminali të posaçëm për mallrat e thata rifuxho. Nderkohe, sidoqoftë, Master Plani për Portin e Durrësit i krijuar në këtë studim konfirmon Portin e Durrësit si të vetmin port me të madh në Shqipëri për të gjitha importet dhe eksportet e planifikuara, dhe si rrjedhojë akomodon facilitetet për importet dhe eksportet e mallrave rifuxho të thata.

Kufinjte e Pronës së Portit Kufinjte aktuale të pronës portuale nuk janë të përcaktuara qartë. Gjithashtu, një pjesë e zonës brenda kufinjve të pronës së portit është një tokë me pronësi private. Objektivat specifike kërkojnë që të merret parasysh Master Plani i qytetit të Durrësit. Megjithatë, ky Master Plan është në hartim e sipër. Rekomandohet që kufinjte e Portit të jenë të përcaktuara qartë, në konsultim me të gjithë përgjegjësit publikë dhe private të përfshirë.

Pozicioni i Autoritetit Portual të Durrësit (APD) Ligji mbi Autoritetin Portual parashikon që Porti i Durrësit të zhvillohet si një port pronar tokë, në të cilin Autoriteti Portual të ofrojë dhe të administrojë zonën e portit dhe infrastrukturën bazë (kalatat), nderkohe që të gjitha autoritetet portuale dhe shërbimet shoqëruese të sigurohen nga sektori privat, nëpërmjet dhenies me konçension dhe liqensave të rregulluara si nga Ligji për Autoritetin Portual, ashtu edhe nga Ligji mbi Konçensionin. Kjo do të thotë se e gjitha toka (dhe uji) brenda kufijve të pronës portuale do të vihet nën administrimin dhe kontrollin e APD-së (shih gjithashtu edhe vezhgimet mbi kufinjte e pronës portuale), dhe që APD-ja ka kompetencën dhe mandatin për të nënshkruar kontratat e dhenies me konçension me operatore publike dhe private të terminalëve dhe ofrues të shërbimeve portuale. Megjithatë, kuadri ekzistues ligjor dhe institucional nuk e konfirmon këtë rol dhe mandat të APD-së.

Interesi Ekonomik Kombëtar dhe Rajonal Objektivat e Përgjithshme sugjerojnë një rol me të rëndësishëm për Portin e Durrësit si një portë me të gjere hyrese për Korridorin e VIII Europian mes Italisë dhe zonës së Ballkanit, duke patur parasysh drejtimet e zhvillimit në tregtine detare mes vendeve fqinje. Megjithatë, pranohej që zhvillimi i Korridorit VIII dhe Portit të Durrësit si një port tranzit për Ballkanin dhe Kosovën, do të kërkojë investime me të mëdha në infrastrukturën e transportit. Për këtë zhvillim do të duhet kohë. Gjithashtu, vendndodhja dhe kushtet fizike të Portit të Durrësit ofrojnë mundësi të kufizuara për zhvillimin e një porti tranzit për Ballkanin dhe Kosovën. Për këtë arsye, pritet që mbështetja dhe kontributi për zhvillimin e ekonomisë kombëtare nga Porti i Durrësit të jetë kriteri i vetëm i rëndësishëm për zhvillimin e tij.



Supozimet

Kufinjte e Prones se Portit Kufinjte e prones se portit do te percaktohen ne kohe dhe qarte, dhe kontrolli dhe administrimi i plote i zones do t'i lihet ne dore APD-se. Kjo do te perfshije, por pa u kufizuar ne pikat e meposhtme:

- Transferimin e rripit te tokes nga Hekurudha tek APD-ja
- Largimin e Portit te Peshkimit dhe transferimi i tokes nen administrimin e APD-se
- Largimin e Zones se Çisternave dhe Bankines se Naftes dhe transferimi i tokes APD-se
- Zona e kantjerit detar te Kurumit t'i transferohet APD-se

Ne vijim, supozohet qe Master Plani te pershtatet brenda kufinjeve aktuale te prones se portit, perfshire edhe rregullimet e permendura me lart. Nese kjo gje nuk eshte e mundur, duhet te gjenden zgjidhje te reja per facilitete (te dedikuara) qofte ne Durres apo ne ndonje vend tjeter.

Pozicioni i APD-se Supozohet qe kompetenca per dhenien me konçesion t'i jepet perfundimisht APD-se per te lehtesuar dhe konfirmuar rolin e saj si nje autoritet portual pronar. Kuptohet qe kjo gje do te kerkoje rregullime te Ligjit. Megjithate, supozohet qe disa zgjidhje afatmesme dhe te perkohshme do te gjenden per te lehtesuar dhe implementuar ne kohe Master Planin dhe Planin e Biznesit.

Rreziqet

Kufinjte e Prones se Portit Nese toka e cila nuk eshte aktualisht nen kontrollin e APD-se, nuk i transferohet ne kohe kesaj te fundit, Master Plani duhet te pershtatet. Kjo gje lidhet sidomos me transferimin e zones se kantjerit detar te Kurumit. Ne rast se kjo hapesire nuk i transferohet ne kohe APD-se, aktivitetet portuale te parashikuara ne Master Planin per ate zone, do te duhet te zhvillohen ne nje vend tjeter brenda kufijeve ekzistues te prones se portit.

APD-ja Nese APD-ja nuk konfirmohet si nje Autoritet Portual Pronar me te gjitha detyrat, pergjegjesite dhe autoritetin e kerkuar, zbatimi i Master Planit dhe Planit te Biznesit do te duhet te shtyhen, apo te bazohen ne marreveshjet e perkohshme ligjore apo institucionale.

Zhvillimi Ekonomik dhe Stabiliteti Politik Ekonomia shqiptare eshte zhvilluar me hapa te qendrueshme keto kater vitet e fundit. Ky zhvillim ka ardhur si rezultat i rritjes se stabilitetit ekonomik dhe bazohet, ne nje mase te gjere, ne trasferimin e fondeve nga qytetaret shqiptare me banim jashte vendit. Nje pjese e konsiderueshme e ketyre fondeve jane investuar ne sektorin e ndertimit dhe turizmit. Sfida e ekonomise shqiptare eshte zgjerimi dhe rehabilitimi i sektorit primar (bujqesise dhe peshkimit) dhe sektorit dytesor (minierat, industria dhe perpunimi i produkteve).

Parashikimi i Ngarkesave Pasigurite ne parashikimin e sasise se ngarkesave dhe numrit te pasagjereve mund te kerkoje fleksibilitet ne zbatimin e Master Planit dhe Planit te Biznesit. Monitorimi i zhvillimit kerkohet ne menyre te atille qe pershtatjet te behen ne kohen e duhur.




Analiza ADOR (Avantazhet / Disavantazhet / Oportunitetet / Rreziqet)

Avantazhet	Disavantazhet
Porta kryesore e tregut shqiptar – Treg i zene Vendndodhja ne hyrje te Adriatikut Vendndodhje strategjike per tranzitin e mallrave per Kosove Lidhje te shumta me rrjetin e trageteve Kosto te ulet operimi Porta e hyrjes ne Korridorin VIII Grup Manaxherial i Motivuar Mbeshtetje te forte nga donatore te huaj	Thellesia disponibel dhe Aksesibiliteti Aftesite fizike te basenit ne nje plan afat-mesem/ afat-gjat Pozicioni prane qendres se qytetit = ndikimi ne mjedis Disponueshmeria e tokes Lidhja me rrjetin hekurudhor Problemet financiare me borxhin e shtimin e financave Strukture e papershtatshme per vjeljen e taksave Nivel i ulet i pajisjeve ne terminale Tokat private brenda teritorit te portit Pozicioni ne hyrje te Adriatikut
Oportunitetet	Rreziqet
Mundesia per te perfituar nga koha e perpunimit Rritje e shpejte ekonomike Norme e larte e kontenierizimit te mallit Zhvendosja e portit te Peshkimit sjell siperfaqe te lira Zhvendosja e tankerave te naftes sjell siperfaqe te lira Potenciali turistik i qytetit te Durrësit Kerkese e larte per trafiqe te reja refuxho te thata Ekzistenca e kapitalit privat i gatshem per t'u investuar Eksport mineralesh nxitur nga kerkesa ne rritje ne tere boten Terheqes per FDI-ne nga reformat institucionale e zhvillimi Rritje te trafikut nga ndertimi i terminalit te ri te trageteve	Mjedis institucional kompleks Investimet ne portin fqinj te Barit Veshtiresi hyrje nga toka Strukture e papershtatshme

PORTI DHE AKTIVITETET PORTUALE


Ngarkesa dhe Pasagjere Plani i Portit te Durrësit paraqitet ne figuren e meposhtme:



Porti i Durrësit perpunon aktualisht ngarkesa te pergjithshme, ngarkese ne konteniere, mall rifuxho (drithera, minerale, qymyrguri, çimento, skorie qelqi), rifuxho likuide, anije (pasagjere



dhe ngarkesa transporti), megjithate, perpunimi i firuxhove likuide do te transferohet ne nje facilitet te ri portual ne Porto Romano.



Gjendja teknike e infrastruktures se portit Baseni i Portit ka nje siperfaqe totale prej 11.5 m. Kanali hyres prej 4 km gjatesi ka nje kthese mu perpara hyrjes se portit. Sipas te dhenave, nje thellim i konsiderueshem i kanalit duhet te kryhet çdo vit (si rrjedhoje e deri ne 30 cm sendimente çdo vit). Siperfaqja e tokes eshte rreth 80 hektare, dhe gjatesia totale e kalates eshte 2.2 km. Tabela e meposhteme paraqet karakteristikat kryesore te gjendjes se kalates gjate nje studimi te kryer.

Kalata	Gajtesia (m)	Thellesia e Projektuar (m)	Viti ndertimit/historia	Tipi i Gjendja Struktures
0	78.0	7.35	1972	Kuverte mbi pilota Gerryerje e konsiderueshme poshte kuvertes + traversat, gjendje e mjerueshme e gureve, e rrjetave. Per t'u riparuar.
1	178.5	7.35	1972, Rikonstruktuar me 1994	Kuverte mbi pilota
2			1949-1951 Rikonstruktuar me 1994	Pjeserisht kuverte mbi pilota dhe pjeserisht mur mbajtes beton armeje (prane kalates 3)
3	30.0	7.35	1949-1951 Rikonstruktuar me 1994	Mur mbajtes beton armeje Projekti per rikonstruktimin eshte pergatitur; buxheti per punimet rikonstruktuese



Kalata	Gajtesia (m)	Thellesia e Projektuar (m)	Viti ndertimit/historia	Tipi i Struktures	Gjendja
4	173.8	7.35	1949-1951 Rikonstruktuar me 1994	Mur mbajtes beton armeje	eshte perfshire ne planin e biznesit te APD-se per vitin 2008
5	235.9	9.85	1966 Rikonstruktuar me 1999-2000	Kuverte mbi pilota	Gjendje e mire
6	265.4	9.85	1966 Rikonstruktuar me 1999-2000	Kuverte mbi pilota	Gjendje e mire
7/8	405.8	9.85	1961-1964 Rikonstruktuar me 1994	Mur mbajtes beton armeje	Rikonstruksioni (ne gjeresine 11.5m) perfshihet ne projektin per terminalin e anijve, te financuar nga BE-ja
9 (terminali i raketave) Porti i Peshkimit	122.0	7.35	1960-1963	Kuverte mbi pilota	Rikonstruksioni perfshihet ne projektin e financuar nga BE-ja
Kantieri Detar					Do te zhvendoset ne zonen perendimore ne perendim te portit brenda nje periudhe afat-shkurter Kantieri Detar Siperfaqe ne pronesi private, me struktura te vjetra dhe te mbajtura keq
Kalata 10	249.7	9.85	1978	Kuverte mbi pilota	Gjendje e keqe, gjendje e mjerueshme e mobilimit te kalates. Projekti eshte pergatitur per rikonstruktim ne nje thellesi prej 11.5m pergjate kalatave
Kalata 11 Bankina dhe Çisterna e Naftes	173.0	9.85	1994-1997	Kuverte mbi pilota Bankine beton armeje me ure dhe bova lidhese prej çeliku	Gjendje shume e keqe Terminalet e naftes do te zhvendosen ne Porto Romano brenda nje kohe te shkurter



LIDHJA ME RRJETIN KOMBETAR TE TRANSPORTIT

Linja Rrugore Porti i Durrësit është i lidhur mirë me rrjetin kombëtar rrugor. Pika kryesore e aksesit për në port është një rrugë 2x2 me Tiranë (e ndërtuar në vitin 2001). Linjat kryesore për transportin e mallrave përmes rrugëve në Shqipëri janë:

Durrës – Tiranë – Elbasan (dhe me tutje në kufi me Maqedoninë)

Durrës/Tiranë – Lezhë – Shkoder – Kukes (dhe me tutje në kufi me Kosovën)

Durrës/Tiranë – Vlorë (dhe me tutje në kufi me Greqinë)

Momentalisht ekzistojnë shumë projekte në zbatim apo të planifikuara për rehabilitimin dhe ndërtimin e rrugëve. Një projekt i rëndësishëm në vazhdim është ndërtimi i rrugës së re drejt Prishtinës, e cila pritet të përfundojë në vitin 2009 – 2010. Rruga do të jetë 170 km e gjatë dhe do të lidhë qytetin e Durrësit, Vores, Fushe Krujes, Milotit, Rreshenit, Repsit, Thirres, Kalimashit, Kukesit dhe Morinës.

Linjat Hekurudhore Porti i Durrësit është i lidhur edhe me rrjetin hekurudhor në Shqipëri. Në të shkuarën, hekurudha shtrihej në pjesën më të madhe të kalatave. Sot, hekurudha në kalatën 1-4 është e bllokuar, dhe lidhja me kalatat 7-8 do të bllokohet nga ndërtimi i terminalit të anijeve. Vetëm facilitetet hekurudhore që ndodhen në pjesën lindore të portit janë parashikuar që të mbeten në gjendje pune. Rrjeti total hekurudhor përbëhet nga 447 km hekurudha paresore dhe 230 km hekurudha dytesore. Binaret janë ndërtuar deri në një gjatësi shinat prej 1.447 m dhe të gjitha rruget janë me një binare me laqe kaluese. Sistemi është ndërtuar kryesisht për trafik transporti mallrash, por edhe për transport pasagjesh.

Tregjet rajonale Figura e mëposhtme paraqet vendndodhjen gjeografike të portit të Durrësit në rajonin e Adriatikut, sëbashku me tregjet e mundshme kryesore (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, Serbi, Bullgari dhe Greqi), dhe tregjet konkurrues për t'i shërbyer këtyre vendeve, Bari (Mal i Zi), Selanik (Greqi), Vamias dhe Burgas (Bullgari).





KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Ligji per Autoritetin Portual Me miratimin e Ligjit Nr. 9130, te dates 8.09.20003, Parlamenti i Republikes se Shqiperise prezantoi konceptin e nje porti pronar dhe percaktoi parimet organizative te autoritetit qe administron porte te tilla, rregullat e tyre, funksionet dhe administrimin, si edhe marredhenien e tyre me operatoret dhe organet qeveritare, por edhe perfaqesimin e ketyre te fundit.

Ligji mbi Konçesionet Sipas Nenit 5 te Ligjit mbi Konçesionet (Ligji Nr. 9663, i dates 18/12/2006), autoriteti kontraktues ne Shqiperi duhet te jete Ministria apo qeveria lokale. Autoriteti Portual nuk eshte asnjeri prej tyre, dhe megjithese Ligji Nr. **9130, i dates 08.09.2003** ne Nenin 31 i jep te drejten Autoritetit Portual qe te jape koncesione (duke iu referuar keshtu Ligjit mbi Konçesionet te 1995), atehere mund te kete shume pak dyshime qe Ministria e Transportit do te duhet te jete autoriteti kontraktues per konçesionet e portit. Ne te vertete, Ligji mbi Konçesionet ka perparesi mbi ligjin per Autoritetin Portual.

Te drejtat e Pronesise Parimi qe perforcon konceptin e portit pronar ka te beje me faktin qe e gjithë toka duhet t'i perkase autoritetit portual, i cili eshte pergjegjes per administrimin, funksionimin dhe mirembajtjen e te gjitha asetëve brenda pronës së portit. E drejta e Pronesise se tokës se dhene kantierit Kurum per ndertimin dhe riparimin e anijeve, i takon Kantierit Detar Durres- Kùrùm. Ky i fundit eshte nje joint venture mes Grupit Kùrùm dhe Ministrise se Ekonomise se Shqiperise me nje perqindje aksionesh prej 65% dhe 35%.

INVESTITORET (stakeholders)

Investitoret perfaqesojne si Agjencite Publike te perfshira ne zhvillimin e portit ashtu edhe sektorin privat. Stakeholder-at per sektorin privat perfshijne APD-ne, Ministrine e Transportit, Bashkia e Durrës, Hekurudhat e Shtetit, Kapiteneria e Portit, Doganat, etj. Interesat e sektorit privat jane organizuar ne Keshillin e Keshilltareve te Portit. Pervec Hekurudhave te Shtetit, Doganave dhe Kapitenerise se Portit, sektori privat perfaqesohet nga Dhoma e Tregtise, perfaqesuesit e kompanive per Dergimin e Ngarkesave, Agjencive te Transportit, Kompanive per sherbimet Detare, Agjencive te trageteve dhe Kompanive te Ngarkim-shkarkimit.

Industritë private ne Shqiperi kane shfaqur interes ne kryerjen e investimeve direkte ne facilitetet portuale ne menyre qe (a) te krijojne hapesire per te kryer tregti nderkombetare si kontenieret, çimenton dhe çelikut, apo (b) te perfshihen ne agjenci tragetesh dhe terminale kroçerash. Keto jane:

- Fabrika e Çimentos Frushe-Kruja, e cila operon aktualisht ne Fushe-Kruje dhe sherben kryesisht ne tregun lokal.
- "Titan Cement" (Grupi ANTEA – Greqi)
- "Kurum Shipyards"
- "Kurum Elbasan Steel Industry".

Pozita Financiare e APD-se



Te ardhurat Aktiviteti me i rendesishem i gjenerimit te te ardhurave per momentin jane sherbimet e perpunimit te ngarkesave. Porti paraqet nje aktivitet te pergjithshem fitimprures, pas te cilit nuk eshte dhene asnje krahasim i detajuar i seciles fushe (perpunim, infrastrukture dhe sherbime te tjera) per te vleresuar fitimin per secilin nga komponentet e ndryshem.

Taksat Portuale Pese lloje taksash (anijesh) portuale mblidhen ne Durres. Sistemi bazohet ne nje vjelje te ndare mes Kapitenerise se Portit dhe Autoritetit Portual. Bazat per perlogaritjen e taksave portuale eshte Tonazhi Neto i Regjistrit (NRT) ¹.

Kapiteneria dhe Taksat e Lehta Kapiteneria e Portit gezon te drejten qe te mbledhe taksat e Kapitenerise dhe Taksat e Lehta. Nga kjo gje kuptohet qe Taksat e Kapitenerise nuk i caktohen ne menyre direkte koshtes se kthimit te infrastruktures se portit si valepritesi apo thellimi i baseneve.

Taksat e Ankormimit dhe Kanalit Si autoritet portual, APD-ja mbledh vetem Taksat e Ankormimit, duke qene se eshte pergjegjese per shfrytezimet dhe mirembajtjen e kalatave, si dhe Taksat e Kanalit. APD-ja ka si detyre mirembajtjen e thellimit te pjeses se lundrueshme per anijet, dhe si rrjedhoje vjel edhe Taksat perkatese.

Sherbimet detare APD-ja nuk gjeneron te ardhura nga sherbimet detare. Keto sherbime kryehen nga kompani te vecanta te specializuara, si publike ashtu edhe private.

Ngarkim-Shkarkimi Ngarkim-Shkarkimi eshte nje tjetere sferë ku eshte kryer privatizimi. Sigurimi i sherbimeve per perpunimin e ngarkesave bashkon kompanite private qe ofrojne force punetore dhe APD-ne qe ofron pajisje (vinça dhe pajisjet e kantierit). Kjo gje vlen per perpunimin e te gjitha ngarkesave te pergjithshme dhe veprimet per perpunimin e drithrave. Per perpunimin e ngarkesave te pergjithshme, libri i çmimeve ka te percaktuar ndarjen e te ardhurave mes APD-se dhe kompanise se ngarkim-shkarkimit. Pjesa e APD-se eshte 58% e te gjitha pageses se pergjithshme per perpunimin ne breg. Per sa i perket terminalit te drithrave, kjo pjese eshte 89% per APD-ne dhe 11% per kompanine e ngarkim-shkarkimit.

Veprimet nga bregu tek kantieri kryhen nga APD-ja. Kompanite e ndryshme te ngarkim-shkarkimit qe operojne ne Durres jane kompani qe kryejne pune perpunuese nga anija tek bregu. Per kete arsye, Porti vjel te gjitha te ardhurat nga perpunimi ne kantier dhe veprimtarite e magazinimit.

Bilanci Bilanci i portit paraqet perberesin e nje borxhi afatgjate nga organizata te ndryshme qeveritare si Kuwait Fund, EIB, OPEC dhe IDA. Porti ka aktualisht shume kredi qe arrijne ne nje shume totale prej 4 miliard Lek. Periudha e maturise se kredive te ndryshme varion nga viti 2012 (Kuwait Fund) deri ne vitin 2038 (IDA). Duke filluar nga viti 2008, APD do te shlyeje borxhet duke filluar nga nje shume totale prej 31 milion Eurosh (3.7 miliard Lek), per huatë e dhena nga IDA dhe EIB-ja. Duke patur parasysh kerkesat e medha te shlyerjes se

¹ Ky system aktualisht eshte nen studim per rristrukturim potencial. Ministria e linjes (MoPWTT) eshte ne ngarkim te nje rishikimi te tille.



borxhit te parashikuara ne 2008 dhe ne vijim, nderkohe qe ne te njejten kohe reforma institucionale pritet te riorganizojë strukturen e te ardhurave me privatizimin e metejshem te aktiviteteve perpunuese, eshte e rendesishme per APD-ne qe te projektoje nje strategji financiare te lidhur fort me prezantimin e skemave te dhenies me konçesion ne terminale te ndryshme. Aftesia e ardhshme e APD-se per te perfituar borxhe shtese per zhvillimin e tij do te influencohet nga shuma apo asetet e qendrueshme si dhe fasilitetet ekzistuese te borxhit qe ndodhen aktualisht ne bilanc. Perqindja e larte e dividendit qe i shperndahet Ministrise perben gjithashtu nje sfide per aftesite vete-financuese te APD-se.

Burimi	Huaja Totale	Data e Pageses	Norma e Interesit	Maturimi	Afati i Shlyerjes grace	Afati	Kursi i Kembimit me 31/12/07 (Te gjitha ne Valute)
Kuwait Development Fund	KWD 2,695,439	1994	2.5%	20 vjet	5c	2012	310 TOTAL
OPEK	USD 5,000,000	1998	2%	16 vjet	5 vjet	2014	85 TOTAL
IDA (USA)	USD 16,808,778 (kthyer ne SDR)	1998	0.75%	40 vjet	10 vjet	2037	85 TOTAL
EIB (BEI)	EURO 17,000,000	2002	4.72%	20 vjet	5.5 vjet	2022	125 TOTAL

Tregtia dhe Trafiku

Metoda e ndjekur per parashikimin e tregtise dhe trafikut eshte e ndryshme per kategorite kryesore te ngarkesave dhe trafikut. Grupet e meposhtme dallohen ne analiza:

- Per importet e mallrave te pergjithshme ndiqet nje metode kompjuterike. Kjo do te thote se parashikimi bazohet mbi raportin mes volumit te trafikut dhe rendimentit ekonomik te nje vendi. Ky raport percaktohet ne baze te vlerave te vezhguara ne te shkuaren, dhe te perlllogaritura per te ardhmen. Nje parashikim per zhvillimin e PBB-se ne te ardhmen eshte konstatuar gjithashtu. Bazuar ne parashikimin e PBB-se nga njera ane, dhe ne raportin PBB- trafik i importuar nga ana tjeter, pergatitet nje parashikim per importet e mallrave te pergjithshme. Pastaj, ngarkesa e pergjithshme ndahet mes trafik ro-ro, ngarkese te pakontenierizuar, dhe ngarkese te kontenierizuar. Dallimi kryhet mes importeve dhe tregjeve te ndryshme.
- Per importet e pergjithshme, jane percaktuar grupet kryesore te produkteve, dhe parashikimet bazohen pastaj mbi rezultatet e perftuara gjaste intervistave me autoritetet perkatese.




- Tranziti i ngarkeses se pergjithshme bazohet ne rendimentin ekonomik te tregjeve te destinuar dhe te dhenat historike ne lidhje me origjinen dhe destinacionin e ngarkesave te trazituara.
- Ashtu si edhe per ngarkesat e importuara, raporti mes PBB-se te tregut te destinuar dhe trafikut te importit percaktohet ne vijim, nga i cili rrjedh edhe nje parashikim per importin e ngarkesave.
- Trafiku i drithrave bazohet mbi normen e rritjes se popullsise dhe konsumit per fryme. Prodhimi vendas i drithrave konsiderohet i paperfillshem.
- Trafiku i mallrave rifuxho te thata bazohet ne zhvillimet industriale te planifikuara ne Shqiperi.
- Tradiku Ro-ro bazohet:
 - Per ngarkesat: perqindja reale e ro-ro ne trafikun total te ngarkesave te pergjithshme.
 - Makinat qe shoqerojne pasagjeret: bazuar ne raportin real mes numrit te pasagjereve dhe automjeteve.
 - Importi i kamioneve dhe makinave presupozohet te rritet me rritjen e PBB-se.

Kontenieret Trafiku total i konteniereve arrihet duke mbledhur flukset e trafikut te kontenierizuar te importit, eksportit dhe tregtise tranzite, si dhe duke i shtuar balancen si konteniere bosh te ngarkuar mbi anije. Diagrama me poshte paraqet trafikun total te konteniereve ne Portin e Durrësit per planin e larte, mesatar dhe te ulet.

Trafiku i Konteniereve (mijera TEU)

Trafiku Total i Konteniereve ne Portin e Durrësit




Importi i Ngarkeses se Pergjithshme

Grafiku i meposhtem tregon ngarkesen e pergjithshme te pakontenierizuar, apo ngarkesen e cila matet aktualisht si ngarkese e pergjithshme ne port. Sidomos atehere kur krahasohet me rritjet e shpejte te pritur te ngarkeses totale te pergjithshme, kjo kategori tregon nje renie te konsiderueshme ne te ardhmen. Kjo renie shkaktohet nga kontenierizimi i ngarkeses se pergjithshme.



Parashikimi traffkut per ngarkesen e pergjithshme lo-lo te pakontenierizuar


Trafiku per ngarkesen e pergjithshme lo-lo te pakontenierizuar



Dritherat

Parashikimi perkates per importet e drithrave permblidhet me poshte.

Importet e Drithrave (mijera tone)



Rifuxho te tjera te thata

Parashikimi perfshin eksportin e mineraleve, çimentos dhe klinkerit, si dhe importet dhe qymyrgurin. Tabela e meposhtme paraqet flukset kryesore te trafikut te mallrave rifuxho te thata (ne ton) qe priten te hyjne ne Portin e Durrës. Kjo gje merret si plani i mesem, nga i cili rrjedh nje plan i larte (trafiku i mesem x 1.5) dhe nje plan i ulet (trafiku i mesem x 0.5).




Plani mesatar i veprimit per volumen e rifuxhos se thate (perveç drithrave) (tone)

	2007	2011	2015	2020	2025	2030
Eksporti çimentos	0	1,000,000	1,000,000	1,000,000	1,000,000	1,000,000
Eksporti Klinkerit	0	1,000,000	1,000,000	1,000,000	1,000,000	1,000,000
Eksporti kromit	222,459	222,459	222,459	222,459	222,459	222,459
Eksporti Ferro-Nikelit	400,000	400,000	400,000	400,000	400,000	400,000
Importi Qymyrgurit	0	857,143	857,143	857,143	857,143	857,143
Total	622,459	3,479,602	3,479,602	3,479,602	3,479,602	3,479,602

Skrapi per industrine e çelikut ne Elbasan si dhe importet e skrapit jane te kerkuara. Volumi i importeve eshte planifikuar te rritet nga 300 mije tone deri me 2010 ne 900 mije tone pas ketij viti.


Ngarkesat Tranzit Ngarkesat tranzit kane te ngjare te zhvillohen me Maqedonine dhe Kosoven.

Tregtia tranzit drejt Maqedonise (mijera tone)





Tregtia tranzit drejt Kosoves (mijera tone)




Ne menyre te ngjashme me importet drejt Shqiperise, ngarkesat tranzit drejt Mqedonise dhe Kosoves presupozohet qe te ndahen mes Ro-Ro (20%) dhe Lo-Lo (80%), dhe trafiku Lo-Lo ndahet ne trafik te kontenierizuar dhe te pakontenierizuar duke aplikuar te njejtat raporte si per importin.


Roll on – Roll off (Sherbimet e trageveve)

Grafiku i meposhtem tregon parashikimin e pjeses se importit te ngarkeses se pergjithshme qe transportohet nga RoRo.


Kamionet/rimorkiot (mije cope, ne te dyja trejtimet).



Numri total i nisjeve dhe mberitjeve te pasagjereve (milion pax)



Parashikimi i mberitjes dhe nisjes se automjeteve (mije cope)



Limani

Kontenieret Kapaciteti mesatar i nje anije kontenier pritet te rritet nga 330TEU ne 20008 ne 1,300TEU ne vitin 2030. Kapaciteti maksimal i mundshmem i nje anije kontenier limitohet ne 1700 TEU, e kufizuar kjo nga konfigurimi i portit.

Klinkeri dhe Çimento Bazuar ne informacionin e siguruar nga investitoret potenciale private, kapaciteti mesatar i nje anije klinker do te jete rreth 25,000 t. Numri i anijeve do te jete rreth 80 ne vit.

Mineralet dhe Qymyrguri Kapacitetet e anijeve per minerale dhe qymyrguri priten te rriten nga 13,000t ne 25,000t kur te vihet ne pune kalata per klinkerin dhe çimenton. Kjo per shkak se qymyrguri do te importohet per prodhimin e çimentos dhe te klinkerit.

Dritherat Kapaciteti mesatar i parcelave te anijeve per drithin pritet te rritet nga 4,000 t ne 8,000 t deri ne vitin 2030. Numri i anijeve pritet te jete diku mes 80 dhe 90. Kapaciteti maksimal i anijes do te varet nga konfigurimi i portit dhe nga kalatat ne te cilat do te sigurohet anija, pasi jo te gjitha kalatat perballojne te njejtin kapacitet maksimal te anijes. Kapaciteti mestar i anijes pritet te rritet nga 5,500 t qe eshte aktualisht, ne 10,500 t ne vitin 2030, me nje maksimum prej 30,000 t, ne varesi te kushteve te portit.

Mallrat e Pergjithshme Mallrat e pergjithshme transferohen nga anije relativisht te vogla. Kapaciteti mesatar i pakos eshte 1,500 t. Ky kapacitet mesatar pritet te mbetet i njejte ne te ardhmen. Numri i anijeve do te rritet nga rreth 800 ne rreth 1,250 per vit deri ne vitin 2030.

Kroçerat (Anijet turistike) Kroçerat do te vijne kryesisht gjate periudhes se veres. Mendohet qe rreth 20 anije do te shkelin ne port. Kjo gje bazohet mbi nje zupozim pasi asnje parashikim nuk eshte bere. Anijet pritet qe te kene rreth 600-800 pasagjere. Keto anije kane nje gjatesi nga 100 ne 170 m.



Ro-Ro/tragetet Tragetet kane nje gjatesi nga 125 m ne 180 m dhe mbajne diku rreth 800 dhe 1000 pasagjere.



Master Plani

Nje numer total prej 8 planesh alternative per Portin e Duresit eshte percaktuar dhe paraqitur per nje vleresim krahasues. Bazuar ne diskustimet me perfaqesuesit e APD-se, me investitoret, ne lidhje me komentet e marra gjate nje takimi te madh me investitoret te zhvilluar ne Janar 2008, u krye nje analize shume kritereshe. Rezultatet e kesaj analize sollen nje plan zhvillimi ne te cilin kapaciteti i basenit aktual te portit eshte zmadhuar, dhe ne te njejten kohe ofron edhe nje fleksibilitet me te madh per te ardhmen. Masterplani i zgjedhur parashikon krijimin e 6 terminaleve kryesore:

1. Terminali i mallit te pergjithshem dhe drithrave
2. Terminali i konteniereve
3. Terminali i trageteve dhe kroçerave
4. Terminali i çimentos dhe klinkerit
5. Terminali i mineraleve dhe qymyrgurit
6. Terminali i skrapit

Parimet per krijimin e terminaleve jane:

- Kerkesa per sherbimet portuale siç percaktohet ne parashikimin e trafikut.
- Te gjitha ngarkesat duhet te perpunohen ne Portin e Duresit.
Derisa rezultati i nje studimi mbi strategjine kombetare portuale te kete treguar te kunderten, i gjithë trafiku, perfshire edhe mallrat rifuxho te thata, do te perpunohen ne portin e Duresit.
- Infrastructure Infrastruktura e duhur e terminalit
Kerkesa per sherbime portuale eshte baza per percaktimin e infrastruktures se kerkuar si dhe per fazat e masterplanit. Perllogaritetet e kapacitetit jane perfshire ne Aneksin 8.
- Kapaciteti i Anijes.
Masterplani eshte krijuar per nje anije 30 000 DWT. Kjo eshte anije me kapacitetet maksimale ne te cilen baseni ekzistues mund te krijohet ne perputhje me standartet nderkombetare te sigurse me nje investim te arsyeshem.
- Terminalizimi
Ne kuader te transformimit te portit te Duresit ne nje port pronar, koncepti i terminalizimit eshte aplikuar per formulimin e opsioneve te master planit. Kjo do te thote qe porti eshte ndare ne subjekte fizike – terminale – te cilat jane dedikuar per perpunimin dhe magazinimin e llojeve te veçanta ngarkesash qe jane te pajtueshme me njera-tjetren. Terminalet e percaktuara jane:
 - Terminali i konteniereve
 - Terminali i mallit te pergjithshem dhe drithrave
 - Terminali i trageteve dhe kroçerave
 - Terminali i mallrave rifuxho te thata e te pista
 - a. Eksporti i çimentos dhe klinkerit
 - b. Importi i qymyrgurit dhe eksporti i mineraleve
 - c. Importi i skrapit



- Projektet tashme të nisura
Disa projekte kanë tashmë në një fazë të zhvilluar të zbatimit, si përsh. ndërtimi i terminalit të trageteve dhe rehabilitimi i kalatave 7/8. Këto projekte janë përfshirë në masterplan ashtu siç janë planifikuar.
- Supozime në ambientet ekzistuese të portit
 - Të drejtat e Pronësive
 - Për masterplanin teknik mendohet se APD-ja ka kompetencën apo mund të sigurojë një kompetencë të tillë mbi token e përshkruar në secilën prej alternativave të masterplanit
 - Terminali i naftës është zhvendosur
 - Porti i anijeve të peshkimit është zhvendosur
 - Rrëpi i tokës, i cili më parë ishte në pronësinë e autoritetit të hekurudhave, i është kaluar portit
 - Zona e kantierit detar është e gatshme për infrastrukturën e portit
- Kontratat e aktuale të qerazë së portit me paletë të treta supozohet që të zgjidhen nëse një gjë e tillë kërkohej nga masterplani i ri
- Të arrihet përdorimi optimal i faciliteteve dhe zonave ekzistuese dhe të shmangët shkatërrimi i kapitalit

Plani i zgjedhur për zhvillimin e portit karakterizohet nga vendndodhja e terminalit të kontenierëve në pjesën perëndimore të basenit dhe vendndodhja e mallrave rifuxho të thata e të pista në anën lindore të basenit. Me këtë plan, aktivitetet e “pastra” kryehen pranë qytetit të Durrësit, ndërsa aktivitetet e “pista” kryehen sa më larg që të jete e mundur nga qyteti i Durrësit.

Avantazhet e master planit janë:

- Zbatimi i master planit mund të fillojë brenda një periudhe të shkurtër pa investime të mëdha, pasi terminalët e ndryshëm do të mbeten në vendin dhe në zonën ekzistuese.
- Ekziston mundësia e realizimit me fazë të Masterplanit.
- Përdorimi i basenit ekzistues të portit dhe sipërfaqeve të tokës janë të optimizuara.
- I gjithë trafiku i planifikuar mund të përpunohet, dhe madje ekziston mundësia për ta zgjeruar më tej (kalata 13) nëse kërkohej
- Ai ofron fleksibilitet, nëse studimi mbi strategjinë kombëtare portuale tregon që një kohë të caktuar në të ardhmen ngarkesat e rifuxhëve të thata duhet të largohen nga porti i Durrësit në një port tjetër (ekzistues apo i ri), terminalët e mallrave rifuxho të thata mund të përdoren për përpunimin e kontenierëve

Me kombinimin e aktiviteteve të trageteve dhe kroqërave në një terminal të kombinuar, zhvillimi i aktiviteteve turistike mund të stimulohet. Me një ndërtesë të re për pasagjerët dhe një zonë të re terminali, hyrja për në Durrës do të jete më tërheqëse nga ç’është tani. Në këtë mënyrë, zhvillimi i aktiviteteve turistike mund të stimulohet dhe të zhvillohet më tej.


Skica e Master Planit, siç paraqitet në faqen tjetër, tregon portin në fund të projektit. Master plani do të zhvillohet në 4 faza, karakteristikat kryesore të të cilave prezantohen më poshtë:



- Faza 1: deri ne vitin 2010, me zgjerimin e terminalit ekzistues te konteniereve ne te gjithe kalaten 6, dhe me punimet e medha rikonstruktuese dhe terminalet e rifuxhove te thata. Zhvendosjen e terminalit te naftes dhe portit te peshkimit
- Faza 2: 2011- 2015; zgjerimi i terminalit te konteniereve me kalaten 7/8, fillimi i punes se terminalit te çimentos/klinkerit, terminalit te skrapit dhe nje terminali te rikonstruktuar per mineralet dhe qymyrgurin.
- Faza 3: 2016-2023; zgjerimi i terminalit te konteniereve me siperfaqe shtese dhe pas kalates 5, dhe zgjerimi i terminalit te trageteve ne zonen qe momentalisht eshte e zene nga anijet e peshkimit
- Faza 4: 2024-2030; zgjerimi i terminalit te konteniereve me kalaten 5, nje siperfaqe magazinimi shtese pas kalates 4. Zvendosja e perpunimit te drithrave nga kalata 5 ne kalaten 4.

Duhet te vihet ne dukje qe nje supozim kritik per zbatimin e masterplanit ka te beje me faktin qe zona ekzistuese e kantierit detar behet e mundshme per krijimin e terminalit te çimentos/klinkerit brenda nje periudhe te shkurter. Nese ky kusht nuk permbushet, dhe ne menyre qe te shmanget mundesia qe eksportet e çimentos/klinkerit te mos perpunohen ne port, mund te merret ne konsiderate qe te vendoset ne kalaten 12 dhe skrapit te spostohet ne kalaten 13 dhe bankina perballe kantierit te ndertimit te konsiderohet si shtese ne te ardhmen.

Vleresimi ekonomik tregoi qe projektet e reja te propozuara, pra, ndertimi i terminalit te çimentos/klinkerit, terminalit te skrapit dhe terminalit te mineraleve dhe qymyrgurit, jane te zbatueshme.





Elementete te tille duhet te merren ne considerate per t'u zbatuar brenda nje kohe te shkurter (1- 3 vjet).

1. Pontili I karburanteve

PONTili I karburanteve eshte ne kushte shume te keqja. Jane bere disa riparime duke perfshire perforcimin e pontilit me nje kapriate metalike qe mban tubin. Kane filluar punimet per nje port te ri ne Porto – Romano. Transferimi I ketij aktiviteti pritet te ndodhe ne vitin 2009 – 2010. Duke pare kushtet e keqja qe ndodhet pontili I karburanteve duhet qe kjo pune te vazhdoje pa vonese. Vonesa ne transferimin e ketij aktiviteti do te vonoje ne zvillimin e terinaleve te mallrave rifuxho dhe te cimentos e klinkerit.

2. Punime te rindertimit

Tenderimi I punimeve te ndertimit per terminalin e trageteve dhe rikonstruksionin e kalatave 7/8 pritet te fillojne se shpejti. Mund te aplikohet per te kerkuar financime per reabilitimitin e kalatave 10/11. Sipas alternativave te zhvillimit te propozuara eshte e dukshme se kalatat 10/11 jane perdorur per perpunimin e mallrave rifuxho duke perfshire dhe eksportin e mineralit. Per kete duhet te konsiderohet prioritare riabilitimi i tyre sepse vonesat reflektojne ne aktivitetin e eksportit te cimentos dhe klinkerit. Per me teper qe me tej ne masterplan jane projektuar edhe ndertesa dhe paisje te pergjithshme si:

- o Nje stacion i ri zjarrefikesish (nen ndertim)
- o Nje ndertese e re per zyra administrative qe do te pozicionohet midis "Qendres se Trainimit" dhe "Gate 2" (e projektuar)
- o Nje punishte qendrore per portin (ngjitur me stacionin e zjarrefikeseve)

3. Heqja e anijeve te vjetra (mbytura)

Ne basenin e portit ka disa anije te vjetra e te mbytura. Keto anije duhet te pastrohen menjehere duke e pare nga pikpamja detare , ambjentale dhe te sigurise. Per meteper duhet te largohet dhe doku i cili eshte prane kalates 11.

4. Zgjerimi I hapsires portuale me zonen e stacionit te vjeter hekurudhor te pasagjereve.

Zona e stacionit te vjeter hekurudhor nga muri rethues i portit deri tek ndertimet e reja eshte nje zone e paperdorur. Per kete na eshte raportuar se eshte akoma ne pronesine e Drej.Pergj. te Hekurudhave Gjithashtu na eshte raportuarr se nje pjese e kasaj siperfaqe do t'i kaloje ne pronesi portit. Ne planin e propozuar kjo hapsire (mbrapa kalatave 5-7) do te jete pjese e zgjerimit te terminalit te kontainerave. Duke pare qe sheshet mbrapa ketyre kalatave eshte relativisht e kufizuar, duke i shtuar dhe ketesiperfaqe do te ndihmonte shume ne operacionet ne kete terminal. Gjithashtu na eshte raportuar se ka patur nje kerkese nga Bashkia e Qytetit te Durrësit per kete teritor per ta perdorur per nje rruge hyrese ne qender te qytetit. Konsulenti sygjeron se teritori eshte i mjaftueshem per te dy palet (Porti dhe Bashkia) dhe per kete arsye te dy palet Porti dhe Bashkia e qytetit nepermjet nje takimi dy palesh ta zgjidhin kete ceshtje duke plotesuar kerkesat e njera tjetres.

5. Punime thellimi

Punimet e thellimit ne kanalin e hyrjes duhet te ekzekutohen sipas projektit. KONSulentit I eshte raportuar se se punimete thellimit kane qene nderprere. Rekomandohet qe te kryhet thellimi ne kanalin e jashtem me thellesi CD - 13.5ml, ne zonen e manovrimit te anijeve ne basenin e portit me nje thellesi CD – 11.5 ml dhe zona perpara kalatave me thellesi sipas projektit perkates. Mbasi te meret miratimi se materiali per mbushje eshte i vlefshem, ky material qe del nga thellimi do te perdoret per te mbushur sheshet



mbrapa kalates 12. Ne menyre qe te realizohet ne kohe riabilitimi i kalates 12 thellimi duhet te kryhet ne 2010.

6. Infrastruktura hekurudhore

Ne planin e zhvillimit te portit lidhja me hekurudhe eshte je ze I rendesishem per te zhvilluar terminalin e mallrave rifuxho. Ne menyre qe te sigurohet nje lidhje transporti eficente ndermjet burimit (minierave apo fabrikave te prodhimit) dhe portit si dhe metej lidhjen me tregun nderkombetar, eshte I nevojshem nje mashkepunim ndermjet Autoritetit Portual dhe Drejtorise se Hekurudhave. Mer me teper perte realizuar zhvillimin e terminalit te mallrave rifuxho eshteshume e rendesishme qe te kemi nje sherbim hekurudhor tecilesise. Per kete eshte e nevojshme qe te shume shpejt te realizohet nje takim ndermjet Autoritetit Portual dhe Drejtorise se Hekurudhave qete koordinojne veprimet dhe te kene nje nivel telarte kooperimi.

7. Kthimi I zones se portit ne zone doganore

Deri tani anijet duhet te kene nje urdher nga dogana qe te hyjne ne port (meperjashtim te anijeve me kontainer). Kthimi i zones se portit ne nje zone doganore do te shmangte pritjen e anijeve per temarre urdherin nga dogana per te hyre ne port. Per rjedhoje do te ulte koston dhe kohen e qendrimit te anijeve.

8. Heqja e portit te peshkimit

Eshte planifikuar projektuar financuar dhe se shpejti fillon zbatimi I Projektit te portit te Ri te Peshkimit jashte teritorit (jug-perendim te portit) te Portit nen vartesine e Ministrise se Ambjentit.

9. Aktivitete te ndryshme qe duhen eliminuar ose zhvendosur.

Ne port ka disa kompani qe kane marre me qera afatshkurter token ne port dhe zhvillojne veprimtari te ndryshme. Keto veprimtari nuk perputhen me masterplanin e propozuar (sepse jane veprimtari jo-portuale ose te parashikuara ne ambiente te tjera), dhe si rrjedhoje duhen hequr nga hapësira protuale:

- ALBTelekom (parashikuar te hiqet ne fazen 1)
- Stacioni i Gazit (parashikuar te hiqet ne fazen 1)
- Magazina e Dritherave (parashikuar te hiqet ne fazen 1)
- Depo (flat store) e Cimentos (kompania Seament, parashikuar te hiqet ne fazen 2, pas mbarimit te qerases ne 2015)

10. Kalimi I pronesise se kantierit detar ne ate te portit.

Ne fakt qenje kompani private te zoteroje ne pronesi nje pjese te portit duke perfshire dhe basenin perpara eshte nje gje e pazaknte. Ne menyre te vecante fakti qe kjo siperfaqe nuk eshte e vlefshme per operacionet ne port eshte nje situatë e padeshirueshme. Kjo siperfaqe duhet t'i kthehet Ministrise se Ekonomise e cila nga ana e vet duhet tja japi Autoritetit Portual ne perdorim. Gjithesesi kjo do tethote qe kompanise Kurum Holding duhet t'i kompesohet kjo siperfaqe, si pronar i saj. Mund t'i proozohet nje zgjidhje ne shkembim te tokes (mundet nje partneritet tjeter joint-venture). Nje kontrate koncesioni afatgjate per zhvillimin e faciliteve te terminalit te tij ne kete toke (kjo mund te behet duke e zgjeruar terminalin e trageteve). Kjo ndoshta eshte e veshtire per ta realizuar sepse bie ne kundërshtim me Ligjin e Koncesioneve per te dhene nje kontrate pa tender. Ne rast te kundert duhet te jepen zgjidhje te tjera si cpronesimi i tokes per nevoja publike. Kjo ceshtje duhet te zgjidhet sa me shpejt sepse ndikon net e ardhmen e disa aktiviteve ne port.

Shenim:

Zbatimi i masterplanit të propozuar varet nga transferimi me sukses tek Autoriteti Portual i pronësise së tokës që aktualisht është e zënë nga Kantiere Detar. Nëse ky transferim nuk realizohet, atëherë duhet hartuar një masterplan tjetër alternativ – referoju kuadrin më poshtë. Në këtë plan, zona e kantiereve detarë nuk është e disponueshme për zhvillimin e portit, vendndëzimi 12 është i parashikuar për cimento/ klinker dhe vendndëzimi 13 për skrapë. Duhet theksuar që ky masterplan nuk është opsioni i preferuar, pasi ai redukton kapacitetin total të portit me rreth 5 milion ton në vit krahasuar me planin e propozuar, dhe nuk i krijon portit hapësirat e nevojshme për të qenë fleksibël në kërkesa të ardhshme të mundshme për zgjerim.



Plani i Biznesit

Port Pronar Tokë

Një përberës i rendesishëm për rikonstruktimin e APD-së është kalimi nga një port që ofron shërbime në një port pronar, duke u përqendruar në manaxhimin dhe në krijimin e vlerave nga prona e portit. Gjithashtu, APD-ja duhet të veprojë si një agjenci rregullatore dhe monitoruese në emër të shtetit shqiptar për të siguruar aktivitete të sigurta dhe të qeta në portin e Durrësit. Masterplanin synon që t'i grupojë qendrat e ndryshme përfituese përpunuese në një numër terminalësh të veçantë. Këto paketa janë përcaktuar, kryesisht mbi llojin e produkteve që do të përpunohen dhe nevojës për të pasur terminale me kapacitete që i bëjnë paketat tërheqëse për investitorët.

Autonomia e APD-së

Qëllimi kryesor i planit të biznesit dhe i vlerësimit të implikimeve financiare të paketave të propozuara është përcaktimi i ndikimit të rikonstruktimit të



portit ne autonomine e APD-se. Megjithate, aspektet ligjore duhet te merren ne konsiderate gjithashtu. Per te gjetur struktura ligjore te pershtatshme dhe ligjerisht te mundshme, eshte kryer nje analize e kuadrit ligjor. Ligji mbi Autoritetin Portual eshte konsultuar ne menyre qe te percaktohen veprimet zyrtare te nevojshme qe APD-ja te kthehet ne nje port pronar.

Reforma Ligjore dhe Institucionale Ne tekstet ligjore jane vene re disa kontradita qe nuk e lejojne Autoritetin Portual qe te veproje si nje autoritet qe jep koncesion, siç percaktohej fillimisht ne Ligjin mbi Autoritetin Portual. Duke qene se ligji mbi Koncesionin nuk i jep shprehimisht te drejten APD-se qe te jape koncesion, kjo gje krijon veshtiresi ne krijimin e strukturave te qarta per zbatimin e Partneriteteve Publike-Private ne Durres.

Per te vepruar ne perputhje me ligjin, propozohet lidhja e marreveshjeve shumepaleshe. Nderkohe qe eshte gjithmone e mundur qe t'i shikosh keto marreveshje nga nje kendveshtrim krejtesisht ligjor, ato krijojne pasiguri per sa i perket pozites se APD-se si investitor, kur ky i fundit ofron infrastruktura te cilat konsiderohen si te nevojshme per te permiresuar nje terminal, por jane jashte qellimit te detyrimeve te investitorit privat. Pertej nivelit te terminalit, kjo gje ngre gjithashtu pyetjen se kush eshte i rendesishem, sipas kushteve te kontrates, per disponueshmerine dhe pershtatshmerine e pergjithshme te faciliteve te portit. Keshtu pra, nje vakuum i mundshem eshte krijuar per sa i perket homologut te investitorit privat, i cili do te ishte pergjegjes nga ana ligjore.

Reforma financiare Pervec strukturimit ligjor dhe institucional te marreveshjeve PPP, APD-ja mund te perballlet me nje ndikim te madh ne poziten e saj financiare, nderkohe qe reformat PPP vazhdojne. Nderkohe qe operacionet e perpunimit jane transferuar jashte Autoritetit, kostot dhe te ardhurat shoqeruese jane nxjerre jashte llogarise se Fitimit dhe Humbjeve te APD-se. Teksa qe kjo gje i heq Autoritetit mundesine e perfshirjes ne operacionet e portit dhe investimet ne pajisje dhe infrastrukture, kjo nxjerr jashte edhe pjese te rendesishme te te ardhurave te portit. Ne menyre qe te kompensohen ndryshimet e perfshira ne kete reforme strukturore, paketat PPP jane krijuar ne menyren me te balancuar te mundshme per secilen pale, gje e cila nenkupton se:

- Kthimi ne nje operator privat terminalesh eshte mese e mjaftueshmeper te nxitur investimet ne Shqiperi.
- Vlera financiare ekstra do t'i shperndahet portit per ta mundesuar ate te investoje ne infrastrukturen e portit dhe per te siguruar nje zhvillim te panderprere te portit, si dhe mirembajtjen e tij ne kushte optimale.

Per kete arsye, analiza ne nivel terminal, duke rezultuar ne nje kthim te projektit fillestar (Norma e Brendshme e Kthimit e planifikuar, bazuar ne flusket operacionale dhe investuese te arkës), mundeson gjithashtu vleresimin e mundesise per paketat PPP qe t'ia shperndajne ne menyre te drejte tepricat Autoritetit, nepermjet mekanizmave paguese koncesionare. Keto mekanizma kontribuojne ne stabilitetin e pergjithshem financiar te Portit te Durresit, nderkohe qe reflektojen edhe perqindjen optimale te fitimeve dhe rreziqeve mes Pronarit dhe operatoreve te ndryshem private.

Figura 6-5 Likuiditeti i APD se (skenari i synuar / kushtet minimale te strategjise PPP)	Error! Bookmark not defined.
Figura 6-6 Te ardhurat e APD.....	Error! Bookmark not defined.
Figura 6-7 Projektimet e Flukseve te Lira te Parave	Error! Bookmark not defined.
Figura 6-8 Fluksi i Parave te APD-se nen kushtet e optimizuara per privatizimin e aktiviteve te trageve	Error! Bookmark not defined.
Figura 6-9 Likuiditeti i APD-se nen kushtet e optimizuara per privatizimin e aktiviteve te Trageve.....	Error! Bookmark not defined.
Figura 7-1 Trafiku i parashikuar i konteniereve nepermjet Portit te Durrësit ne planin e mesem (x mije TEU)	136
Figure 7-2 Planet e veprimit te parashikuara per trafikun e kontenjerave ne Portin e Durrësit (x mije TEU)	137
Figura 7-3 Malli i pergjithshem i lo-lo i pakontenjerizuar i parashikuar ne Portin e Durrësit	139
Figura 7-4 Numri i parashikuar i kamionave/rimorkjove qe kalojn nga Durrësit (x mije njesi, ne te dyja drejtimet)	140
Figure 7-5 Mberritjet totale te pasagjereve dhe largimet nepermjet Portit te Durrësit (x milion pax)	141
Figure 7-6 Mberritjet e veshguara dhe te parashikuara dhe largimet e makinave (x mije njesi)	141
Figura 7-7 Volumi i parashikuar i importeve te dritherave nga Porti i Durrësit (x mije ton)	142



FJALOR

Shkurtime	Fjala e Plote	Shpjegimi
BOT	Nderto-Opero-Transfero	Modeli PPP ne te cilin nje investitor privat do te investoje si ne infrastrukture edhe ne superstrukturen e nje ndertese te caktuar.
C.D.	Grafiku i te Dhenave	Niveli i ujit i cili matet ne thellesite e paraqitura ne grafiqet detare, shpeshhere te barabarta me LAT.
DSCR	Raporti i Sigurimit te Sherbimit te Borxhit	Raporti mes parave te disponushme perpara borxhit dhe pagesave te interesit dhe sherbimit vjetor te borxhit
DWT	Sasia e thate ne ton	Shkalla e kapacitetit (ne tone) te mbajtjes se ngarkeses per nje anije .
eIRR	Norma e Brendshme Ekonomike e Kthimit	Norma e kthimit te perfitimeve dhe kostove ekonomike.
eNPV	Vlera Ekonomike Aktuale Neto	Vlera aktuale e burimit te ardhshem te kostove dhe perfitimeve ekonomike.
EU	Bashkimi European	
GDP (PBB)	Produkti i Brendshem Bruto	Vlera totale e tregut e te gjitha mallrave dhe sherbimeve te perfunduara te prodhuara brenda nje vendi te caktuar ne nje periudhe te caktuar kohore.
GRT	Tonazhi Bruto i Regjistrit	Perfaqeson volumen total te brendshem te nje anije, me disa perjashtime per hapersirat joproduktive, siç jane dhomat e ekuipazhit; 1 ton bruto regjister eshte i barabarte me volumen e 2.8 m ³ (100 feet kub).
IRR	Norma e Brendshme e Kthimit	Kthimi i investimeve i kompensuar nga fluski i arkes.



Shkurtime	Fjala e Plote	Shpjegimi
LAT	Rryma me e Ulet Astronomike	Lartesia e ujit ne rrymen me te ulet teorike te mundshme.
LOA	Gjatesia e plote	Gjatesia totale e nje anije, nga kici tek pupa.
lo-lo	Ngarkim-Shkarkim	Ngarkesa e transferuar nga anija tek bregu apo anasjelltas me vinca.
NPV	Vlera Neto Aktuale	Vlera aktuale e nje burimi te ardhshem te fluksit te arkes
NRT	Tonazhi Neto i Regjistrit	Volumi i ngarkeses qe mund te mbaje nje anije; dmth. Tonazhi bruto i Regjistrit minus volumen e hapësirave qe nuk mbajne ngarkese.
OCC	Kostoja Oportune e Kapitalit	Norma e caktuar per te percaktuar nese nje projekt eshte ekonomikisht i mundur (eIRR te jete te pakten e barabarte me OCC-ne) ose jo (eIRR me pak se OCC).
APD	Autoriteti Portual i Durresit	
ro-ro	Roll-on / Roll-off	Ngarkesat me rrota (kamionet, trailerat, makinat) te transferuara nga anija ne breg apo duke i rrotulluar ato.
RTG (VRG)	Vinç-ure me rrota gome	Vinçi-ure, mbi rrota gome, i perdorur per punimin e kontenierëve ne sheshin e kontenierëve.
STS (VAB)	Vinçi nga Anija tek Bregu	Vinçi-ure kryesor i perdorur per operimet ne breg ne nje terminal kontenieresh (mbi binare).
TEU	Njesia Ekuivalente prej 6 m. (20 feet)	Kontenieri standart IMO me nje gjatesi prej 6 m.
TGS	Twenty Foot Equivalent Ground Slot	Njesia e perdorur per llogaritjen e kapacitetit te nje sheshi kontenieresh, e shprehur me numrin e gjurmeve te kembeve te kontenierëve 6 m qe mund te magazinohen ne shesh.
Tph (tno)	Ton ne ore	Njesia e perdorur per normen e perpunimit: tonet ne ore te transportuar mbi kalate.
Tpy (tnv)	Ton ne vit	Njesia e perdorur per te shprehur volumit vjetor te trafikut.



1 HYRJE

1.1 Objektivat

Komisioni European (KE) dhe Autoriteti i Portit te Durrës (APD) kane perzgjedhur Royal Haskoning Nederland B.V. nga Hollanda qe te kryeje detyren themelore "122348/C/SER/AL Percaktimi / Azhornimi i Masterplanit Te Portit Te Durrës, Shqiperi". Kontrata per kete detyre eshte nenshkruar me 25 Qershor 2007.

Objektivat e Pergjithshme Objektivi i Pergjithshem eshte pergatitja e nje master plani strategjik te bazuar ne nje analize krahasuese te aktiviteve portuale dhe perdorimeve te tokes dhe ne perputhje me çështjen e pergjithshme per sigurine dhe mjedisin. Objektivat e pergjithshme mund te permbliken si me poshte:

- Per te kontribuar ne zhvillimin ekonomik kombetar dhe rajonal te Shqiperise nepermjet zhvillimit te Portit te Durrës si pjese e nje porte me te gjere hyrese per Korridorin European VIII mes Italise dhe zones se Ballkanit.
- Per te prezantuar konventat moderne nderkombetare mbi aktivitet portuale ne kuader te angazhimit te qeverise shqiptare per privatizim dhe njohjen siç duhet te drejtimeve te zhvillimit ne tregtine detare mes vendeve fqinje.
- Per te rekomanduar nje perqasje te njohur si "praktika me e mire" per zhvillimin e Portit te Durrës qe eshte ne perputhje me rekomandimet e pergjitheshme qe gjenden ne Planin Kombetar te Transportit ne Shqiperi (PKI) te publikuar se fundmi.
- Arritjen e kesaj brenda nje "afati te planifikuar" dhe te realizueshem – ndoshta per nje peridudhe 20 apo 25 vjet ne total, por me afate te ndermjetme 5, 10 apo 15 vjeçare.
- **Objektivat Specifike**
- Pergatitja e nje Mater Plani gjithperfishires, por duke partur parasysh aktivitetet ekzistuese planifikuese dhe Master Planin per qytetin e Durrës.
- Formulimi i nje Plani Strategjik Biznesi, i cili trajton aspektet ekonomike dhe financiare te portit dhe aktivitetet portuale.
- Krijimi i nje "plani kohor" per zbatimin e Master Planit dhe Planit Strategjik te Biznesit.

1.2 Pengesat dhe Çështjet Kritike

Ne shqyrtimin e situates aktuale dhe objektive te pergjithshme dhe atyre specifike, Konsulentet jane perballur me nje numer pengesash dhe çështjesh kritike. Ato mund te permbliken si me poshte:

Strategjia Kombetare per Zhvillimin Portual ANTP rekomandon specializimin e portit. Kjo gje do te nenkuptonte qe Porti i Durrës te perqendrohej tek sherbimet e konteniereve, ngarkesave te pergjithshme dhe anijeve. Nje strategji kombetare per zhvillimin portual, sidoqofte, nuk eshte krijuar ende. Eshte rekomanduar qe nje strategji e tille te pergatitet urgjentisht per te ofruar direktiva per specializimin e portit, perfshire prsh. ndertimin e nje terminali te posaçem per mallrat e thata rifuxho. Nderkohe, sidoqofte, Master Plani per Portin e Durrës i krijuar ne kete studim konfirmon Portin e Durrës si portin e vetem me te madh ne Shqiperi per te gjitha importet dhe eksportet e planifikuara, dhe si rrjedhoje akomodon facilitetet per importet dhe eksportet e mallrave rifuxho te thata.



Kufinjte e Prones se Portit

Kufinjte aktuale te prones portuale nuk jane te percaktuar qarte. Gjithashtu, nje pjese e zones brenda kufinjeve te prones se portit eshte nje toke me pronesi private. Objektivat specifike kerkojne qe te merret parasysh Master Plani i qytetit te Durrës. Megjithate, ky Master Plan eshte ne hartim e siper. Rekomandohet qe kufinjte e Portit te jene te percaktuar qarte, ne konsultim me te gjithë investitoret publike dhe private te perfshire.

Pozita e Autoritetit Portual te Durrës (APD)

Ligji mbi Autoritetin Portual parashikon qe Porti i Durrës te zhvillohet si nje port pronar toke, ne te cilin Autoriteti Portual te ofroje dhe te administroje zonen e portit dhe infrastrukturën baze (kalatat), nderkohe qe te gjitha autoritetet portuale dhe sherbimet shoqeruese te sigurohen nga sektori privat, nepermjet dhenies me konçension dhe liçensave te rregulluara si nga Ligji per Autoritetin Portual ashtu edhe nga Ligji mbi Konçensionin. Kjo do te thote se e gjitha toka (dhe uji) brenda kufijeve te prones portuale, do te vihet nen administrimin dhe kontrollin e APD-se (shih gjithashtu edhe vezhgimet mbi kufinjte e prones portuale), dhe qe APD-ja ka kompetencen dhe mandatin per te nenshkruar kontratat e dhenies me konçension me operatore publike dhe private te terminaleve dhe ofrues te sherbimeve portuale. Megjithate, kuadri ligjor dhe institucional ekzistues nuk e konfirmon kete rol dhe mandat te APD.

Interesi Ekonomik Kombetar dhe Rajonal

Objektivat e Pergjithshme sugjerojne nje rol me te rendesishem per Portin e Durrës si nje porte me e gjere hyrese per Korridorin e VIII European mes Italisë dhe zones se Ballkanit, duke patur parasysh drejtimet e zhvillimit ne tregtine detare mes vendeve fqinje. Megjithate, pranohet qe zhvillimi i Korridorit VIII dhe Portit te Durrës si nje port tranzit per Ballkanin dhe Kosoven do te kerkoje investime me te medha ne infrastrukturen e transportit. Per kete zhvillim do te duhet kohe. Gjithashtu, vendndodhja dhe kushtet fizike te Portit te Durrës ofrojne mundesi te kufizuara per zhvillimin e nje porti tranzit per Ballkanin dhe Kosoves. Per kete arsye, pritet qe mbeshtetja dhe kontributi per zhvillimin e ekonomise kombetare nga Porti i Durrës te jete kriteri i vetem i rendesishem per zhvillimin e tij.

1.3 Supozimet dhe Rreziqet (risqet)

Supozimet

Ne kuader te kufizimeve dhe çeshtjeve kritike, kjo pjese e dokumentit thekson supozimet dhe rreziqet ne lidhje me analizat e kryera.

Kufinjte e Prones se Portit

Kufinjte e prones se portit do te percaktohen ne kohe dhe qarte, dhe qe kontrolli dhe administrimi i plote i zones do t'i lihet ne dore APD-se. Kjo do te perfshije, por pa u kufizuar ne pikat e meposhtme:

- Transferimi i rripit te tokes nga Hekurudha tek APD-ja
- Largimi i Portit te Peshkimit dhe transferimi i tokes nen administrimin e APD-se
- Largimi i Zones se Çisternave dhe Bankines se Naftes dhe transferimi i tokes APD-se
- Zona e kantjerit detar te Kurumit t'i transferohet APD-se

Ne vijim, supozohet qe Master Plani te pershtatet brenda kufinjeve aktuale te prones se portit, perfshire edhe rregullimet e permendura me lart. Nese kjo gje nuk eshte e mundur, duhet te gjenden zgjidhje te reja per facilitete (te dedikuara) qofte ne Durrës apo ne ndonje vend tjeter.

Pozita e APD-se

Supozohet qe autoriteti per dhenien me koncension t'i jepet perfundimisht APD-se per te lehtesuar dhe konfirmuar rolin e saj si nje autoritet portual pronar. Kuptohet qe kjo gje do te kerkoje rregullime te Ligjit. Megjithate, supozohet qe disa zgjidhje afat-



mesme dhe te perkohshme do te gjenden per te lehtesuar dhe implementuar ne kohe Master Planin dhe Planin e Biznesit.

Rreziqet Zbatimi siç duhet dhe i favorshem i Master Planit dhe Planit te Biznesit per Portin e Durresit perballat me rrezique. Rreziqet nuk shoqerohen vetem me shkallen e supozimeve te mesiperme, por edhe me zhvillimet qe jane pertej kontrollit te autoritetit portual te Durresot dhe qeverise shqiptare; zhvillimi i ekonomise kombetare dhe tregtise nderkombetare:

Kufinjte e Prones se Portit Nese toka e cila nuk eshte aktualisht nen kontrollin e APD-se nuk i transferohet ne kohe kesaj te fundit, Master Plani duhet te pershtatet. Kjo gje lidhet sidomos me transferimin e zones se kantierit detar te Kurumit. Ne rast se kjo hapësire nuk i transferohet ne kohe APD-se, aktivitetet portuale te parashikuara ne Master Plan per ate zone, do te duhet te zhvillohen ne nje vend tjetër brenda kufijeve ekzistues te pronës se portit.

APD-ja Nese APD-ja nuk konfirmohet si nje Autoritet Portual Pronar me te gjitha detyrat, pergjegjesite dhe autoritetin e kerkuar, zbatimi i Master Planit dhe Planit te Biznesit do te duhet te shtyhen, apo te bazohen ne marreveshjet e perkohshme ligjore apo institucionale.

Zhvillimi Ekonomik dhe Stabiliteti Politik Struktura aktuale e ekonomise shqiptare perben nje rrezik te rendesishem. Ekonomia shqiptare eshte zhvilluar me hapa te qendrueshme keto kater vitet e fundit. Ky zhvillim ka ardhur si rezultat i rritjes se stabilitetit ekonomik dhe bazohet, ne nje mase te gjere, ne transferimin e fondeve nga qytetet shqiptare me banim jashte vendit. Nje pjese e konsiderueshme e ketyre fondeve jane investuar ne sektorin e ndertimit dhe turizmit. Sfida e ekonomise shqiptare eshte zgjerimi dhe rehabilitimi i sektorit primar (bujqesise dhe peshkimit) dhe sektorit dytesor (minierat, industria dhe perpunimi i produkteve). Kjo do te varet ne terheqjen e Investimeve Direkte te Huaja ne keto sektore dhe ne infrastrukturen e transportit. Sidoqofte, ekonomia shqiptare varet edhe ne stabilitetin politik te vete vendit, por edhe te rajonit.

Parashikimi i Ngarkesave Zhvillimi ekonomik dhe stabiliteti politik jane supozime te rendesishme per parashikimin e perberjes dhe volumit te ngarkeses dhe numrin e pasagjereve dhe turistëve qe do te manaxhohen ne Portin e Durresit. Nese politika shqiptare per te terhequr Investime Direkte te Huaja ne sektorin paresor dhe dytesor te ekonomise nuk do te jete e suksesshme, atehere edhe zhvillimi ekonomik nuk do te ndodhe. Kjo gje do te kete nje ndikim te menjehershëm ne parashikimin e ngarkesave. Pyetje te rendesishme jane: Si do te zhvillohet industria e minierave? A do te vazhdoje ekonomia te zhvillohet me te njejtin ritëm? A do te zhvillohet kerkesa per sherbimet e tragetit dhe kroçerave siç eshte planifikuar? Pasigurite ne parashikimin e sasise se ngarkesave dhe numrit te pasagjereve mund te kerkoje fleksibilitet ne zbatimin e Master Planit dhe Planit te Biznesit. Monitorimi i zhvillimit kerkohet ne menyre te atille qe pershtatjet te behen ne kohen e duhur.

1.4 Perberja e Draft-Raportit Final

Raporti perbehet nga kapitujt e meposhtem:

- Permbledhja
- Kapitulli 1 Hyrje
- Kapitulli 2 Vleresimi i kushteve aktuale
- Kapitulli 3 Tregtia dhe Trafiku
- Kapitulli 4 Strategjite Alternative per Zhvillimin e Portit



- Kapitulli 5 Master Plani
- Kapitulli 6 Plani i Biznesit
- Kapitulli 7 Konkluzione dhe Rekomandime

1.5 Falenderimet

Konsulentet do të donin të shprehnin mirënjohjen e tyre të sinqerte të gjithë personave, agjensive dhe instituteve në Shqipëri që kanë kontribuar në kryerjen me sukses të detyrës. Ketu përshihen, por jo vetëm kaq:

Delegacioni i Bashkimit Europian

- Daniele Maniscalco
- Irene Giribaldi
- Ben Slee
- Arian Hoxha
- Ardian Metaj

Autoriteti Portual i Durrësit

- Eduard Ndreu
- Mentor Bunguri
- Eugen Gashi
- Agon Çopja
- Tomor Spahiu
- Najada Skuka

Kapiteneria e Portit

- Vladimir Beja
- Gezim Dosari

Doganat Shqiptare

- Arben Ibroja

Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore

- Konstanca Rexhepi

Hekurudhat Shqiptare

- Zamir Ramadani
- Vullnet Pepellashi

Ministria e Transportit

- Ervin Minarolli
- Andi Toma
- Qemal Sina
- Eliana Laha
- Patric Treacy
- René Kist
- Kees van Krieken
- Robert Lamont

Ministria e Finances

- Luiza Jano



Ministria e Ekonomise

Ministria e Industrise dhe Minierave

Instituti i Statistikave

- Emira Galanxhi

Qyteti i Durrës

- Adrian Cela

Grupi Kurum

- Dr. Zeki Kaya
- Erjola Seraj
- Sokol Plani

Çimento Fushe Kruje

- Sadi Dahdale

Kompania e Çimentos Titan

- Nick Pantazaras

Per t'u perfunduar

Ekipi i Konsulenteve

Ekipi pergjegjes per sherbimet e kryera perbehet nga:

Filip Augustyns	Planifikues i Portit dhe Transportit
Paul van Eulem	Ekspert per Zhvillimin e Biznesit
Attie Kuiken	Ekspert i Modelimit Financiar
Gustaaf de Monie	Ekspert per Zhvillimin Ligjor dhe Institucional te Portit
Henry Opdam	Drejtor i Projektit
Yann Pleindoux	Analist Financiar
Ewout van der Reijden	Inxhinier Porti



2 VLERESIMI I KUSHTEVE AKTUALE

2.1 Hyrje

Ky kapitull paraqet vleresimin e Konsulentit mbi kushtet aktuale ne Portin e Durrësit. Çështjet e mëposhteme trajtohen njera pas tjetres:

- Analiza ADOR: karakterizimi i pozicionit të portit të Durrësit brenda ambjentit të tij të biznesit, nepermjet analizes se avantazheve, disavantazheve, opotuniteteve dhe rreziqeve të Portit të Durrësit
- Kufijte e prones se portit
- Karakteristikat e portit
- Operacionet portuale
- Kushtet teknike të infrastruktures se portit
- Situata financiare
- Kuadri ligjor dhe institucional

2.2 Analiza ADOR

Per te ilustruar, nxjerre dhe mbështetur opsionet strategjike të zhvillimit të Portit të Durrësit, është projektuar një analize ADOR (Avantazhet, Disavantazhet, Oportunitetet, Rezikimet), që identifikon karakteristikat e brendeshme dhe të jashteme të Portit të Durrësit brenda ambjentit të tij të biznesit.

Tabela e mëposhteme, jep matricen e analizes ADOR për Portin e Durrësit:

Avantazhet	Disavantazhet
Porta kryesore e tregut shqiptar – Treg i zene Vendndodhja ne hyrje te Adriatikut Vendndodhje strategjike per tranzitin e mallrave per Kosove Lidhje te shumta me rrjetin e trageteve Kosto te ulet operimi Porta e hyrjes ne Korridorin VIII Grup Manaxherial i Motivuar Mbeshtetje te forte nga donatore te huaj	Thellesia disponibel dhe Aksesibiliteti Aftesite fizike te basenit ne nje plan afat-mesem/ afat-gjat Pozicioni prane qendres se qytetit = ndikimi ne mjedis Disponueshmeria e tokes Lidhja me rrjetin hekurudhor Problemet financiare me borxhin e shtimin e financave Strukture e papershtatshme per vjeljen e taksave Nivel i ulet i pajisjeve ne terminale Tokat private brenda teritorit te portit Pozicioni ne hyrje te Adriatikut
Oportunitetet	Rreziqet
Mundesia per te perfituar nga koha e perpunimit Rritje e shpejte ekonomike Norme e larte e kontenierizimit te mallit Zhvendosja e portit te Peshkimit sjell siperfaqe te lira Zhvendosja e tankerave te naftes sjell siperfaqe te lira Potenciali turistik i qytetit te Durrësit Kerkese e larte per trafike te reja refuxho te thata Ekzistenca e kapitalit privat i gatshem per t'u investuar Eksport mineralesh nxitur nga kerkesa ne rritje ne tere boten Terheqes per FDI-ne nga reformat institucionale e zhvillimi Rritje te trafikut nga ndertimi i terminalit te ri te trageteve	Mjedis institucional kompleks Investimet ne portin fqinj te Barit Veshtiresi hyrje nga toka Strukture e papershtatshme



Table 2-1 Analiza ADOR e Portit të Durrësit

Nje shpjegim i hollesishem i elementeve te konstatuara ne ADOR, jepet ne tabelen e meposhteme. Per secilin element, analizohen nxitet kryesore ne prespektiven e implikimeve strategjike per portin e Duresit.

Çeshtjet	Shpjegimet
Avantazhet	
Porta Kryesore e Tregut Shqiptar	Porti i Durrësit është Pika e parë e hyrjes së import-exporteve për Shqipërinë dhe lidhet me qendrat me të mëdha ekonomike të vendit. Kjo rezulton në një aktivitet të lartë të mallrave shqiptare
Vend-ndodhja në hyrje të Adriatikut	Kjo karakteristike është dhe në avantazh dhe në disavantazh. Duke qenë porti i parë i hyrjes në Adriatik, ai ka kohë të shkurtër tranziti dhe kosto të ulët. Kështu, duke qenë porti i parë, anijet vijnë plot dhe kërkojnë thellësi zhytje me të madhe.
Pozicioni Strategjik për Tranzitimin e Tregëtisë në Kosovë	Durrësi ka një pozicion gjeografik strategjik për një prespektive politike për të tërhequr mallrat nga Kosova, ndërsa vendi është në procesin e ristrukturimit, hapet një mundësi me shumë për zhvillimin ekonomik
Rrjeti i dendur i Lidhjeve me Tragetë	Linjat e trageteve janë një trafik i rëndësishëm dhe sigurojnë një të ardhur të konsiderueshme dhe konstante.
Kosto e Ulet Operative	Shqipëria është një vend me rroga relativisht të ulëta, gjë që ul koston operative.
Grupi i Motivuar Manaxherial	Një grup i motivuar manaxherial siguron një zbatim me të mirë të vendimeve strategjike dhe manaxhimit e ndryshimeve.
Porta e Korridorit VIII	Zbatimi i Korridorit të VIII i jep Durrësit një pozicion strategjik sidomos për tregun Maqedonas.
Një Mbeshtetje e Fuqishme nga Donatorët Nderkombëtarë	APD përfiton nga disa financues të huaj me çmime atraktive gjë që i jep dorë në zhvillimin e kapaciteteve.
Disavantazhet	
Thellessia, Aftësia Pranuese dhe Dimensionet e Basenit	Thellessia e kufizuar e Portit është një disavantazh për të zhvilluar modelin e anijes dhe standartet. Karakteristikat e Portit kufizojnë pranimin e anijeve me të mëdha se 200m gjatësi.
Vend-ndodhja Pranë Qytetit	Mallrat industriale prodhojnë efekte ambientale, siç janë zhurma, pluhur meqenëse porti është pranë qytetit dhe shtëpive të banimit.
Bashkëjetesa me Zonën Perreth	Porti është pranë zonave urbane dhe turistike dhe zgjerimi i tij bëhet i vështirë.
Lidhjet me rrjetin Kombëtar	Megjithatë do të përfundojë rruga lidhëse me Kosovën lidhjet me hekurudhe kërkojnë një përmirësim të fuqishëm për të ofruar një konkurrencë në prodhimin intermodal.
Borxhet	Ndërsa porti përfiton nga kredite e buta, borxhi vjen duke u rritur në terma afatmesme dhe afatgjatë nga njëra anë



	dhe nga ana tjetër të ardhurat vijne duke u zvogeluar me privatizimin e terminaleve gjë e cila kërkon permiresim të fuqishëm të infrastrukurës. Mekanizmi i koncesionit kërkon që porti të sigurojë vlerat konsiderueshme për të mbështetur zhvillimin. Terheqja në zgjidhje të reja sfidohet nga detyrimet e borxhit.
Struktura e Grumbullimit të të Ardhurave	Struktura e sistemit të grumbullimit të të ardhurave në port është e tillë që jo të gjitha të ardhurat mbledhen nga Autoriteti Portual, gjë që nuk është një sistem i përshtatshëm.
Niveli i ulët i Paisjeve në terminale	Niveli i ulët i paisjeve në terminale penalizon mbi të gjitha rendimentin dhe kërkon investime të mëdha që të rinovohen.
Tokat Private në Territorin e Portit	Ekzistenca e teritoreve private në territorin e portit vështirëson organizimin e terminaleve.
Oportunitetet	
Mundësia për të përfituar nga Koha e perpunimit	Distanca e shkurtër që ka me portet e tjera, i jep trafikut të konteinerave avantazhin për të reduktuar kohën e tranzitit dhe koston e transportit.
Rritja e shpejtë e Ekonomisë në Shqipëri	Rritja e shpejtë e ekonomisë në Shqipëri është mbështetja direkte e rritjes së trafikut në të ardhmen në vlerë sasiore dhe cilësore.
Rritja e shpejtë e Konteinerizimit të Transportit	Rritja e shpejtë e trafikut të mallrave me konteiner mbështet nevojën për modernizimin e shërbimeve portuale dhe për të shtuar shërbimet në territorin e portit.
Largimi i Tankerave të Naftës dhe Portit të Peshkimit	Se shpejti, largimi i tankerave të naftës dhe portit të peshkimit do të hape sipërfaqe të reja portit.
Durrësi si potencial Turistik	Hapja e Shqipërisë ndaj turizmit krijon potenciale në port për të prituri anijet turistike dhe për të zhvilluar një shërbim të ri.
Rritja e trafikut të mineraleve dhe gadishmeria e investimeve private	Zhvillimi ekonomik në Shqipëri do të japë një zhvillim të ri shtimit të trafikut të mineraleve, dhe ardhja e investitoreve private do të mbështesin rritjen afatgjatë.
Rritja e prodhimit të mineralit	Shqipëria ka rezervë të mëdha minerali. Tregu botëror do të kërkojë gjithnjë e më shumë minerale të tilla si: nikel, baker, krom. Kjo do të hapë portit një mundësi për të bërë si pike dalje për tregun me vëllime të mëdha.
Zhvillimi i Kuadrit Ligjor	Zhvillime të mëdha janë bërë në kuadrin ligjor në Shqipëri për të mbështetur FDI nëpërmjet besueshmërisë dhe transparencës.
Rritja e Transportit me Tragete nëpërmjet Terminalit të Ri	Ndërtimi i terminalit të ri do të japë një shtytje në rritjen e cilësive dhe produktivitetit të operacioneve në terminal.
Rreziqet	
Kuadri institucional	Në lidhje me privatizimin e mëtejshëm, kuadri institucional do të jetë me kompleks sepse do të jenë disa ministri dhe autoriteti portual të përfshira në këto marrëdhënie dhe përgjegjësi nuk do të jetë shumë e qartë.
Zhvillimi i Portit të Barit	Porti i Barit është porti më i afërt me Durrësin, kështu që është një konkurrent i fuqishëm për të ofruar shërbime me moderne dhe thellesi me të madhe për mallrat tranzit për

	ne vendet e Ballkanit.
Struktura e papershtateshme e Trafikut per Biznesin e Konteniereve	Struktura tarifore ne terminalin e konteinerave, nuk eshte e pershtateshme per operacionet ne nje terminal modern konteinerash dhe krijon nje boshlek te dukshem per te gene i gatshem per privatizim.
Veshtiresite e Hyrjes ne port nga toka	Zhvillimi i trafikut ne te ardhmen do te krijoj veshtiresi per hyrjen ne port nepermjet portave tokesore ne termat afatmesme dhe afatgjata.

Tabela 2-2 Analiza ADOR

Keto elemente do te çojne drejt zgjedhjes se varianteve me optimale per te ndertuar Strategjine e Portit te Durrës, qe me vone te perkthehet ne Plan Biznesi. Ky Plan Biznesi do te jete zbatimi i opsionit te strategjise se zgjedhur.

2.3 Kufijte e prones se Portit

Porti i Durrës ndodhet ne pjesen jug-perendimore te qytetit te Durrës dhe 36 km ne Lindje te kryeqytetit te vendit, Tiranes.

Porti eshte i krijuar nga dy valepritesa te cilet mbrojne nje basen te brendshem prej 67 hektaresh, me nje thellesi nga 7.5 ne 11.5 metra dhe 11 vende ankorimi me 2200 m kalate. E gjithë siperfaqja e tokes eshte 80 hektare.

Ne pergjithesi, mund te vihet re qe zona qe eshte momentalisht e disponueshme nuk perdoret ne menyre optimale, ku shihet prania e skrapit dhe magazinave te vjetra te cilat jane jashte perdorimit dhe zene nje siperfaqe te çmuar te portit, si dhe pranine e rrenojave te anijeve qe zene nje pjese te basenit. Pastrimi i zones se portit dhe rindertimi i terreneve eshte nje fitore e shpejte qe mundeson permiresimin e efçenses operacionale te portit brenda nje periudhe afatshkurter dhe pa ndonje investim te madh.

Figure 2-1 Pamje ajrore e portit te Durrës



Ne baze te nje diskutimi mes bashkise se Durrës dhe APD-se, eshte rene dakord qe Portit t'i transferohet nje rrip toke 40 m i gjere. Kjo siperfaqe ndodhet pas zones ku perpunohen

kontenieret. Ne Masterplan eshte marre parasysh edhe ky rrip toke me nje gjeresi pra prej reth 40 m.

Momentalisht, zona prane kalates 10 eshte e zene nga Durrës-Kurum Shipyards Sh.a. prania e saj fiziike brenda ambjenteve te portit nderkohe qe pronesia eshte private, mbeshtet logjiken e portit pronar toke, ku e gjithë toka duhet t'i perkase autoritetit portual pergjegjes per manaxhimin, operimin dhe mirembajtjen e te gjitha aseteve brenda ambjeteve te portit.


Nje çeshtje e rendesishme per planifikimin e portit te Durrësit eshte se per momentin nuk ka nje caktim te qarte te kufijve te nje siperfaqeje per zgjerimin e portit ne te ardhmen. Ne menyre qe te ruhen potencialet per rritje te portit, eshte e rendesishme qe te bihet dakord mbi nje zone qe te rezervohet per zhvillimin e aktiviteve qe kane lidhje me portin.

2.4 Karakteristikat e Portit

2.4.1 Skica e portit dhe aktivitetet

Situata ne portin e Durrësit paraqitet ne menyre sistematike ne skicen e Figures 2-2 ne vijim:

Figura 2-2 Zonat ekzistuese te aktiviteve ne Portin e Durrësit



Akresi ne port realizohet permes nje kanali me uje me nje gjeresi prej 10.4 m. Nga dy valepritset, njera eshte moli Lindor qe shtrihet ne Jug Jug Perendim, ndersa e dyta eshte Moli Jug Lindor qe shtrihet ne Juglindje dhe Lindje, duke lene nje hyrje te hapur ne Lindje Jug Lindje mes kokes se moleve me nje largesi prej 01 miljesh detare.

Kanali i gjate i aksesit prej 4 km ka nje kthese mu perpara hyrjes se portit. Amplituda prej 0.5 m mes batices dhe zbatices eshte e neglizhueshme dhe sezonale. Ajo eshte thelluar ne 11.5



m kohet e fundit (thellesia mbetet ende per t'u konfirmuar). Na eshte bere e ditur qe thellimi i kanalit eshte i nevojshem çdo vit (deri ne 40 cm sedimente çdo vit).

Harta tregon me perafersi perdorimin aktual te tokes se portit bashke me veprimtarite kryesore. Duke filluar nga kahu jugor i valepriteses, dhe duke vazhduar ne kahun orar, dallohen zonat e meposhtme:

Tabela 2-3 Shperndarja e zonave dhe kalatave ne Portin e Duresit

Shperndarja e Zonave dhe Kalatave ne Portin e Duresit	
Kalata 1: ngarkese e pergjithshme + shkarkimi i çimentos	Kalat 9: Tragete
Kalatat2-4: ngarkese e pergjithshme	Porti i Peshkimit
Kalata 5: shkarkimi i drithrave	Toke private (Kurum Shipyards)
Kalata 6: perpunimi i konteniereve (ne te vertete, kalata shtrihet pertej kalatave 5 dhe 7.	Berth 10: dry bulk (minerals + cement)
Kalatat 7/8: rifuxhot e thata (mineralet)	Kalata 11: importet e naftes

Zonat per “Sherbimet e Pergjithshme Portuale” perfshijne ndertesen e administrates, repartet, zyren e kapitenerise se portit, zyrat e doganes dhe kompleksionin e portave (gate-ve).

2.4.2 Lidhja me Rrjetin Kombetar te Transportit

Linja Rrugore

Porti i Duresit eshte i lidhur mire me rrjetin kombetar rrugor. Pika kryesore e aksesit per ne port eshte nje rruge 2x2 mes Tiranes (e ndertuar ne vitin 2001). Kapaciteti i aksesit te portit mund te perlllogaritet deri ne 650 automjete ne ore per drejtim (Instituti Japonez i Zhvillimeve Bregdetare Nderkombetare).

Harta ne faqen tjeter tregon rrjetin aktual rrugor ne Shqiperi. Linjat kryesore per transportin e mallrave permes rrugeve ne Shqiperi jane:

- Durres – Tirane – Elbasan (dhe me tutje ne kufi me Maqedonine)
- Durres/Tirane – Lezhe – Shkoder – Kukes (dhe me tutje ne kufi me Kosoven)
- Durres/Tirane – Vlorë (dhe me tutje ne kufi me Greqine)

Tarifat per transportin rrugor per /dhe nga porti i Duresit thuhet te jene 13 - 15 Lek/ton km (0.10 – 0.12 Euro /ton km) ne kohen e hartimit te ketij raporti.

Aktualisht jane ne zbatim apo jane planifikuar disa projekte per rehabilitimin dhe ndertimin e rrugeve. Nje proçes i rendesishem qe ka nisur eshte ndertimi i rruges se re per ne Prishtine, e cila pritet te jete gati ne vitin 2009 – 2010. Rruga do te jete 170 km e gjate dhe do te lidhe qyetetet e Duresit, Vores, Fushe Krujes, Milotit, Rreshenit, Prepsit, Thirres, Kalimashit, Kukesit dhe Morines. Kjo rruge do te permiresoje ne menyre te konsiderueshme aksesibilitetin e kombit te ri te Kosoves me portin e Duresit, dhe me tregjet boterore ne pergjithesi.



Linjat Hekurudhore Porti i Durrës është i lidhur me rrjetin hekurudhor në Shqipëri. Në të shkuarën, hekurudha shtrihet në pjesën më të madhe të kalatave. Sot, hekurudha në kalatën 1-4 është e bllokuar, dhe lidhja me kalatat 7-8 do të bllokohet nga ndërtimi i terminalit të anijeve. Vetëm facilitetet hekurudhore që ndodhen në pjesën lindore të portit janë parashikuar që të mbeten në gjendje pune. Rrjeti total hekurudhor përbëhet nga 447 km hekurudhe pasesore dhe 230 km hekurudhe dytesore. Binaret janë ndërtuar deri në një gjatësi shina prej 1.435 m, dhe të gjitha rrugët janë me një binar me laqe kaluese. Sistemi është ndërtuar kryesisht për trafik transporti mallrash, por edhe për transport pasagjerësh.

Megjithatë sistemi është në gjendje që të operojë 24 orë në ditë, momentalisht ka vetëm pak trena që punojnë natën.

Porti i Durrës është i lidhur mirë me rrjetin rrugor dhe atë hekurudhor. Hartat² në Figura 2-4 dhe Figura 2-5 në faqet në vijim, tregojnë rrjetin kryesor rrugor dhe atë hekurudhor në Shqipëri.

Figura 2-4 dhe Figura 2-5 në vijim tregojnë rrjetin hekurudhor në Shqipëri. Tarifat për transportin hekurudhor të mallrave janë rishikuar vitin e kaluar, dhe kjo ka çuar në një bilanc pozitiv për transportin e mallrave që nga ajo kohë. Tarifat variojnë tani nga 5 – 7 Lek toni për Km (Rreth 0.04 – 0.05 Euro/ ton km), në varësi të distancës. Distancat përkatëse për këtë studim paraqiten në Tabelën 2-5 më poshtë.

Tabela 2-4 Distancat (në km) hekurudhore në vendet e shënuara

	Durrës	Podgorice (kufiri Shqipëri – Mal i Zi)	Porti i Barit (Mali i Zi)
Durrës	-	143	255
Tiranë	36	140	252
Fushë Krujë	35	126	240
Elbasan	73	216	328

Skema e mëposhtme paraqet në mënyrë sistematike rrjetin hekurudhor dhe vëllimin e trafikut të vërejtur në vitin 2003. Linjat më të ngarkuara janë Durrës – Tiranë, Elbasan – Durrës – Shkoder dhe Ballsh – Rrogozhinë.

Figura 2-5 paraqet gjithashtu edhe disa të dhëna mbi koston e investimit të kërkuar për rindërtimin.

Sasia totale e mallrave të transportuara nëpërmjet rrjetit hekurudhor është relativisht e ulët, siç tregohet edhe në Tabelën 2-5 më poshtë. Trafiku kryesor konsiston në mallrat rifuxho, të transportuara me trena që nisen nga vendi i origjinës drejt destinacionit. Në vitin 2003, rruga mesatare ishte 60 km, e cila është tepër e shkurtër.

Table 2-6 Trafiku i mallrave të transportuara nëpërmjet rrjetit hekurudhor në Shqipëri

	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005
Mijera ton	305	361	412	259	349	517	417	404
Million ton/ km	25	26	28	19	21	31	32	26

² Burimi: Plani Kombëtar i Transportit në Shqipëri – Studimi i Fazës 2- "Final Report Volume 2", Louis Berger S.A., 2005




Dy korridore kryesore hekurudhore mund te vihen re:

- Njeri qe shtrihet ne veri-jug dhe qe lidh Podgoricen (ne Mal te Zi, duke u lidhur me tej me Portin e Barit) me Durresit dhe me tej ne jug me Rrogozhinen dhe Vloren.
- Nje korridor perendim-lindje qe lidh Rrogozhinen me Elbasanin, dhe me tej me progradecin prane kufirit me Maqedonine.


Infrastruktura hekurudhore dhe vagonat veteshkarkues te mallrave jane ne gjendje te mjere. Sipas nje raporti, vendkalimet e trenave jane jashte perdorimit, ku pjesa me e madhe prej tyre nuk ka linja komunikimi, gjendje e braktisur e rruges permanente pergjate te gjithë sistemit, rreziqe te vazhdueshme sigurie, mungese te theksuar mirembajtje dhe drenazhim te keq te urave, sisteme kullimi jashte pune, etj. Kjo gje ka çuar ne kufizime te gjera ne sistem, duke shkaktuar nje renie te interesit per hekurudhat. Eshte sjelle ne vemendje te Konsulentit qe eksporti i ferro-nikelit i zhvilluar kohet e fundit permes Portit te Durresit, u desh te nderpritej per shkak te gjendjes se keqe te sistemit hekurudhor qe dergonte xeheroret ne port.

Figura 2-3 Rrjeti kryesor rrugor ne Shqiperi³



³ Burimi: Plani Kombetar i Transportit per Shqiperine – Studimi i Fazes 2 (Louis Berger, 2004)

Figura 2-4 Rrjeti hekurudhor shqiptar dhe volumi i trafikut te mallrave (2003)



Tarifat per transportin hekurudhor te mallrave jane rishikuar vitin e kaluar, dhe kjo ka çuar ne nje bilanc pozitiv per transportin e mallrave qe nga ajo kohe. Tarifat variojne tani nga 5 – 7 Lek toni per Km (Rreth 0.04 – 0.05 Euro/ ton km), ne varesi te distances. Distancat perkatese per kete studim paraqiten ne Tabela 2-7 me poshte.

Tabela 2-7 Distances (in kilometres) via rail between selected locations

	Durrës	Podgorica (border Albania – Montenegro)	Port of Bar (Montenegro)
Durrës	-	143	255
Tirana	36	140	252
Fushe Kruje	35	126	240
Elbasan	73	216	328

Skema e meposhtme paraqet ne menyre sistematike rrjetin hekurudhor dhe volumin e trafikut te verejtur ne vitin 2003. Linjat me te ngarkuara jane Durres – Tirane, Elbasan – Durres – Shkoder dhe Ballsh – Rogozhine.

Figura 2-5 Rrjeti hekurudhor ne Shqiperi dhe Kostoja e llogaritur per rehabilitim



Per kete studim, seksioni qe lidh Durresin me Rogozhinen dhe Rogozhinen me Elbasanin jane te nje rendesie te vecante. Ne vitin 2003, kapaciteti i seksionit qe lidh Durresin me Rogozhinen ishte 28 trena ne dite, duke pasur parasysh kushtet e linjes dhe vagonat e mallrave ne ate kohe. Duke supozuar 700 ton/tren, dhe duke supozuar qe trenat arrijne plot



ne Durrës dhe kthehen bosh, kjo do të na japë një kapacitet ditor prej 9800 tonesh, ose rreth 3.5 milion ton në vit. Në një intervistë të dhënë me “Hekurudhat e Shqipërisë”, u konfirmuar se pas riparimit të infrastruktures, sidomos të sinjalizimit, dhe me investimet e bëra për vagonë mallrash, ky kapacitet mund të arrijë shumë lehtë në 7 milion ton në vit.

2.5 Operacionet Portuale

2.5.1 Ngarkese e Pergjithshme e pakontenierizuar

Operacionet në det

Aktualisht, anijet presin të ankoruara deri sa të kenë përfunduar të gjitha procedurat doganore duke përfshirë dhe pagesën e detyrimeve doganore. Është e qartë që kjo procedurë shkakton humbje kohe të anijes dhe për rrjedhojë rrit koston e qëndrimit. Pra, është tepër e rekomandueshme që i gjithë territori i portit të kthehet në zonë fiskale. Procedurat dhe formalitetet duhet të rishikohen së bashku nga Drejtoria e Doganave, Porti i Durrësit dhe investitorët private gjatë kohës së këtij studimi.

Trafiku

Mallrat e përgjithshme vijnë në Portin e Durrësit nepermjet trageteve, (Ro – Ro, Roll – on/Roll – off) ashtu si dhe me anije mallrash konvencionale (Lo – Lo, Lift – on/Lift – off). Mallrat Ro – Ro trajtohen vakant nën zerin “Tragete”.

Përveç eksportit të një sasi të vogël të tullave/tjegullave, mallrat e përgjithshme Lo – Lo i perkasin teresisht importit. Në vitin 2006, volumi total prej 924 mijë tonesh i mallrave të përgjithshme është import. Rreth 70% e mallrave të përgjithshme të importuara i perkasin materialeve të ndërtimit (305 mijë ton çimento e paketuar, 261 mijë ton hekur, tulla/tjegulla dhe 38 mijë ton materiale të tjera ndërtimi, 35 mijë ton blloqe mermeri, 11 mijë ton xham). Mallrat pa kontenier përpunohen kryesisht në kalatën 1 – 4, që ndodhen përgjatë skolierës perëndimore të portit. Tabela e mëposhtme jep karakteristikat kryesore të trafikut të mallrave të përgjithshme për 25 vitet e fundit.

Tabela 2-8 Trafiku i anijeve me mallra të përgjithshme në Portin e Durrësit

Treguesi	Njesi	2005	2006	2007(*)
Anijet	numër	835	731	272
Mallra total në vite	tone	954,989	934,281	346,885
Ngarkimi mes. i anijeve	Ton/anije	1,144	1,278	1,275
Kapaciteti mes. i anijeve	DWT	1,636	1,731	1,786
Koeficienti i ngarkimit të anijeve		70%	74%	71%

(*) Vetëm 6 muji i parë.

Përpunimi në kalatë

Mallrat pa kontenier përpunohen kryesisht në kalatat 1 – 4 që ndodhet përgjatë skolierës perëndimore të portit. Nga statistikat e portit, koeficienti i përpunimit është 115 ton/ore për anije.

Tabela 2-9 Operacionet ne kalata per perpunimin e mallrave te pergjithshme

	Njesia	Viti 2005	Viti 2006	Viti 2007(*)
Trafiku	Ton	1,366,449	1,265,342	485,877
Koha e perpunimit	Ore	12,296	10,386	4,269
Koeficienti i perpunimit	Ton/ore	111	122	114

(*) Vetem 6 mujori i pare.



Figura 2-6 Pamje nga kalatat 2-4: shkarkimi direkt i mallrave te pergjitheshme

Magazinimi

Mallrat e pergjitheshme pa kontenier praktikisht shkarkohen direk ne mjete. Kamionet parkohen pergjat kalates dhe ngarkimi i tyre behet direct nga anija per te dale jashte nga porti ose per transit (tulla/tjegulla, pllaka). Magazinat me sa duket jane jashte perdorimit ndersa sheshet e depozitimit perdoren vetem rastesisht.



Figura 2-7 Pamje nga zonat e depozitimit ne Kalatat AMC-2 dhe pjesa e jashtme e magazines pas kalates 5

Dergimi / Marrja nga jashte portit

Dergimi i ngarkeses se pakontenierizuar behet me kamion.

2.5.2 Kontenieret

Operacionet Detare

Per momentin, anijet e konteniereve jane te perjashtuara nga detyrimi qe te kryejne te gjitha procedurat doganore perpara ankorimit.

Trafiku

Trafiku i kontenierave eshte rritur shume shpejt gjate 5 viteve te fundit, nga pothuaj asgje, ne 22 mije TEU ne vitin 2006. Shumica e kontenierave shkojne ne eksport bosh.

Kohet e fundit ka filluar exporti i mineralit te kromit me kontenier. Ky eshte nje zhvillim interesant. sepse ka nje kosto te ulet te transportit (dihet qe cmimi i transportit te kontenierave bosh ose plot eshte pothuaj i njejte).

Eshte interesante per tu shenuar qe raporti i kontenierave 20 ft me konteinerat 40 ft shpie ne nje koeficient TEU/box te ulet 1.05 gjate 4 viteve te fundit. (zakonisht koeficienti TEU/kuti varion nga 1.4 – 1.6)



Tabela 2-10 Karakteristikat kryesore te anijeve qe transportojne konteniere ne Portin e Durrësit

	Njesia	Viti		
Treguesit		2005	2006	2007 (6 mujori pare)
Numri i anijeve	Cope	236	316	135
Dimensioni mesatar i anijeve	GRT	1838	2375	3188
Kapaciteti mesatar i anijeve	DWT	2532	2956	3616
Gjatesia mesatare e anijeve	LOA (m)	66	75	82
Transporti mes. per prekje kalate.	Ton	793	819	946

Perpunimi ne kalate

Porti i Durrësit perpunon kontenierat ro – ro si dhe kontenierat lo – lo. Kontenierat ro – ro vijne ne port me tragete dhe me pas dalin nga porti me kamiona. Kontenierat lo – lo aktualisht perpunohen ne kalaten 6, me nje gjatesi kalate ne dispozicion te tyre prej rreth 135ml (ndermjet mureve rrethues).

Deri para nje viti e gjysem, koeficienti i perpunimit ishte 9 konteinera ne ore. Normalisht, nje vinç i levizshem duhet te perpujoj rreth 15 konteinera ne ore. Ky koeficient i ulet i perpunimit vjen ndoshta ngaqë vinçi qe perdoret eshte shume i rende per te pasur nje efektivitet me te madh ne perpunim.

Tabela 2-10 Operacionet e perpunimit te kontenierave ne kalate

	Njesia	2005	2006	2007(*)
Trafiku	Kontenier	11,902	15,977	8,740
Koha e perpunimit	ore	2,575	1,765	997
Koeficienti i Perpunimit	Kontenier/ore	4.6	9.1	8.8

(*) Vetem 6 mujorin e pare.



Figure 2-8 Vinçi me goma (Fantuzzi-Reggiane MHC 200)qe perdoret aktualisht per perpunimin e kontenierave

Transporti horizontal ndermjet kalates dhe hapsires se depozitimit.

Ngarkim – shkarkimi eshte bere nga nje kompani private. Duke perdorur 2 reachstacker qe jane ne pronesi te portit. Mbas shkarkimit te kontenierave ne kalate ato kapen nga reachstackersat dhe transportohen ne sheshin e depozitimit te kontenierave.

Gjate vizites qe beri konsulenti ne vend ju raportua se vetem nje reachstacker eshte ne pune. Kjo e veshtireson procesin e ngarkim shkarkimit sa kohe qe nuk ka nje paisje tjeter per ngarkimin e kamjonave gjate kohes qe nje anije eshte duke u perpunuar.

Magazinimi

Gjeresia e terminalit te kontenierave eshte rreth 130 ml, e matur nga qoshja e kalates deri tek muri ne buze te rruges mbrapa sheshit. Siperfaqja totale brenda murit rrethues eshte 3.3 hektare e vlefshme per magazinim. Gjithsejt ka nje densitet depozitimi prej 500 TEU/hektar me perdorimin e reachstackerit, pra hapsira e disponibel ka nje kapacitet depozitimi prej 1500 TEU. Me nje mesatare 10 ditore hapsira disponibel mund te perpunoje deri ne 50 mije

TEU ne vit. Kompanite e ngarkim-shkarkimit kane gjithashtu te vlefshem nje shesh mbrapa kalates 1 ku mund te operohet me nje reachstacker me vehte. Sheshi ka nje numer te kufizuar *reefer slots*.



Figure 2-9 Reachstacker ne sheshin e konteniereve

Hyrja e mallrave ne port nga jashte

Reachstackerat jane perdorur per ngarkimin e kontenierave te importuar ne kamiona ose per t'i shkarkuar ne rastin e eksportit. Shumica e kontenierave te mbushur jane te rreshtuar ne destinacionin e tyre final.

2.5.3 Drithrat

Operacionet Detare

Per momentin, nje anije duhet te prese ne ankorim derisa te kryhen te gjitha proçedurat doganore, perfshire edhe pagesen e taksave doganore. Eshte e qarte qe kjo proçedure i ben anijet te presin per nje kohe te gjate, dhe si rrjedhoje ka pagesa per vonese ne ngarkim.

Traffiku

Importi i drithrave ka variuar nga 300 mije ne 400 mije ton ne vit per 5 vitet e fundit. Tabela e meposhteme jep karakteristikat e anijeve qe sjellin drithra ne Portin e Durrësit.



Table 2-11 Trafiku i anijeve te drithrave ne Portin e Durrësit

Treguesit	Njesia	2005	2006	2007(*)
Anijet	Numri	82	83	26
Sasia Totale	ton	264,726	301,481	92,193
Ngarkimi mes. i anijeve	Ton/anije	3,228	3,632	3,546
Kapaciteti mes. i anijeve	DWT	3,439	3,852	3,709
Koefic. i ngarkimit.		94%	94%	96%

(*) Vetem 6 mujori i pare

Perpunimi ne kalate

Drithrat jane shkarkuar nga anijet me vinçin (Reggiane) me grif. Vinçat e shkarkojne drithin ne 5 bunkera (qe shpesh i quajne dhe sillosa) qe ndodhen ne kalaten 5. Kur fryn ere, drithi shperndahet ne ajer.

Tabela e meposhteme prezanton karakteristikat e perpunimit ne 3 vitet e fundit.

Tabela 2-12 Operacionet ne kalate per perpunimin e drithit

	Njesia	2005	2006	2007(*)
Trafiku	Ton	264,726	301,481	92,193
Koha e perpunimit	Ore	8,565	4,505	1,134
Koeficienti perpunimit	Ton/ore	31	67	81

(*) Vetem 6 mujorin e pare

Magazinimi

Drithi shpesh perpunohet duke e ngarkuar direkt ne kamion, keshtu qe eleminon nevojën per magazinim. Ne kalate ndodhen dhe 5 bunkera (sillosa) me nje kapacitet magazinues prej 300 ton secili, duke dhene ne total 1500 ton kapacitet magazinimi.

Dalja jashte dhe brenda portit

Drithi del jashte nga port me kamiona qe kryesisht ngarkohen nga bunkerat (sillosat).

2.5.4 Çimentoja dhe Klinkeri

Operacionet Detare

Per momentin, nje anije duhet te prese ne ankorim derisa te kryhen te gjitha proçedurat doganore, perfshire ehde pagesen e taksave doganore. Eshte e qarte qe kjo proçedure i ben anijet te presin per nje kohe te gjate, dhe si rrjedhoje ka pagesa per vonese ne ngarkim.

Trafiku

Deri vitin e kaluar, Shqiperia varej nga importi per te siguruar çimenton. Ne vitin 2006 jane importuar 635 mije ton cemento dhe 185 mije ton klinker nepermjet Portit te Durrësit. Ne 4 vitet e fundit importi total i cimentos dhe klinkerit ka qene rreth 800 mije ton.



Figura 2-10 Vinçat e kalates per perpunimin e drithrave (Reggiane - 10t x 30m)

Duhet vene ne dukje qe se fundi ka filluar prodhimin nje fabrike çimentoje me kapacitet 1.5 milion tone ne vit. Kjo sebashku dhe me fabrikat e tjera te prodhimit, çojne ne faktin qe Shqiperia do ta perballoje vete nevojën per çimento, keshtu qe importi i çimentos nuk do te ekzistojë me.

Perpunimi i Kalates

Importet perpunohen nga shkarkuesit Siwetell (prone e kompanive private, nje ne Kalaten AMC dhe nje ne Kalaten 10). Ne kohen kur vizituam portin, nuk kishte asnje ngarkues per perpunimin e eksporteve.

Magazinimi

Mbrapa kalates 10 eshte ndertuar nje magazine per depozitimin e cimentos se bashku me nje bunker dhe nje paisje paketimi.



Figura 2-11 Shnek per shkarkimi e cimentos rifuxho (kalata 1)



Figura 2-12 Magazine private per depozitimin e cimentos (mbrapa kalates nr. 10)



Dalja nga porti

Cimento rifuxho transportohet jashte portit me kamiona te specializuar ose me kamiona normal kur eshte e paketuar.

2.5.5 Mineralet

Operacionet Detare

Per momentin, nje anije duhet te prese ne ankorim derisa te kryhen te gjitha proçedurat doganore, perfshire edhe pagesen e taksave doganore. Eshte e qarte qe kjo proçedure i ben anijet te presin per nje kohe te gjate, dhe si rrjedhoje ka pagesa per vonese ne ngarkim.

Trafiku

Ne te kaluaren Shqiperia ka qene nje nga 3 exportuesit kryesor ne te gjithë boten per mineralin e kromit. Mineralet jane prodhimi kryesor qe eksportohet nga Shqiperia nepermjet Portit te Durrësit. Mbas nje renie te pergjithshme te prodhimit gjate periudhes se tranzicionit tani ka filluar perseri nje rritje te prodhimit. Nga 124 mije ton ne vitin 2003 ne 223 mije ton ne vitin 2006 (184mije ton mineral kromi + 20 mije ton koncentrat kromi + 19 mije ton ferro – krom). Shqiperia, sic raportohet ka rezerva te konsiderueshme minerali akoma, keshtu qe duhet marre ne considerate vazhdimesia e exportit.

Tabela e meposhteme jep karakteristikat kryesore te anijeve qe transportojne mineralin e kromit nga Shqiperia.

Table 2-13 Trafiku i anijeve te mineralit rifuxho nga Porti i Durrësit

Treguesit	Njesia	2005	2006	2007(*)
Anijet	Numri	50	42	21
Sasia Total	ton	102,562	200,897	175,629
Ngarkimi mes. i anijeve	Ton/ Anije	2,051	4,783	8,363
Kapaciteti mes. I anijeve	DWT	2,656	6,961	12,181
Koeficienti ngarkimit		77%	69%	69%

(*) Vetem 6 mujorin e pare

Sic shihet nga tabela per periudhat e vrojtuar, verehet nje rritje e dimensioneve te anijeve qe hyjne ne Portin e Durrësit. Vihet re qe gjate periudhes se vezhguar, kapaciteti mesatar i anijeve te perdorura eshte rritur ndjeshem, dhe keto jane mes anijeve me te medha qe jane vendosur ndonjehere ne portin e Durrësit.

Perpunimi ne kalate

Shumica e mineraleve jane sjelle ne port kryesisht me tren, me vagona vetshkarkues, dhe jane depozituar ne nje zone te posacme per mineralet ne veri-lindje te hapsires portuale. Tani minerali vjen me kamiona dhe e depozitojne mineralin ne anen tjeter te portit ne kalatat 7/8 . perfundimisht minerali I depozituar ne sheshet mbas kalates 7/8, ngarkohet ne anije me dy vinca nga 15 ton (me grif) qe ndodhen ne kalate dhe punojne me nje rendiment 200 ton/ore/ (rreth 20 cikle/ore x 5 ton/cikel x2 vinca). Na eshte raportuar qe do t'i behet remont



vinçave ne kalaten 10 brenda 6 mujorit, dhe mbas kesaj depozitimi i mineraleve per eksport do te zhvendoset nga kalatat 7/8 ne kalaten 10.

Tabela e meposhteme jep karakteristikat kryesore te operacioneve te perpunimit te kromit gjate 3 viteve te fundit.

Table 2-14 Operacionet ne Kalate per ngarkimin e kromit

	Njesia	2005	2006	2007(*)
Traffiku	Ton	102,562	200,897	175,629
Koha e ngarkimit	Ore	1,536	1,393	900
Koeficienti i perpunimit	Ton/ore	67	144	195

(*) Vetem 6 mujorin e pare

Nje zhvillim interesant eshte eksportimi i mineralit te kromit me kontnier 20 ft. Gjate kohes qe po shkruhej ky raport, rreth 70 konteniera me mineral jane ngarkuar tashme.

Gjithsesi, transporti i mineralit rifuxho me konteinera nuk eshte shume i arsyeshem. Kjo ka kuptim sa kohe qe ne port vijne konteinerat plot dhe kthehen bosh, por me ritjen e eksportit te mallrave te pergjitheshme do te regullohet dhe ballancimi i konteinerave. Kjo do te jete dhe menyra me e lire e futjes se konteinerave ne tregun nderkombetar. (p.sh. ne vendet qe eksportojne kontenierat plot siç eshte Kina)

Magazinimi

Mineralet qe vijne me tren shkarkohen me vagonat veteshkarkues ne veri-lindje te portit, prane estakades se linjes hekurudhore ne jug te tankerave te haftes.

Hyrja e mineralit nga jashte ne port

Shumica e mineralit rifuxho vjen ne port me hekurudhe.



Figura 2-13 Minerali per eksport (kalata 7) me 4 vinça (Kranbau Eberswalde)

2.5.6 Tragetet

Tragetet perpunohen ne nje terminal te vecante te ri. Punmet e ndertimit per infrastrukturen e pjeses tokesore (rruge sheshe, etj.) duke perfshiredhe godinen e terminalit te pasagjereve, pritet te fillojne se shpejti me perfundimin e tenderit.



Figura 2-14 Terminali i Trageteve (Pamje nga kalata 7/8)



2.6 Gjendja teknike e infrastruktures se portit

2.6.1 Vleresim i gjendjes se infrastruktures se portit

Baseni i Portit ka nje siperfaqe totale prej 67 hektarësh. Kanali hyres prej 4 km gjatesi ka nje kthese mu perpara hyrjes se portit. Sipas te dhenave, nje thellim i konsiderueshem i kanalit duhet te kryehet çdo vit (si rrjedhoje e deri ne 30 cm sendimente çdo vit). Siperfaqja e tokes eshte rreth 80 hektare, dhe gjatesia totale e kalates eshte 2.2 km.

Konsulenti ka kryer nje kontroll viziv te infrastruktures ekzistuese te portit. Rezultatet e detajuara jane perfshire si aneks i ketij kapitulli. Skica nr. 9S0723.21/DFR/110, e perfshire ne aneksin e ketij raporti, tregon infrastrukturen aktuale te portit te Durrësit. Tabela e meposhtme paraqet karakteristikat kryesore te kalateve ne dispozicion.

Tabela e meposhtme paraqet karakteristikat kryesore te kalatave ekzistuese.

Tabela 2-15 Karakteristikat kryesore te kalatave ne Portin e Durrësit

Kalata	Gjatesia (m)	Thellesia e Projektuar (m)	Viti i ndertimit/historia	Tipi i Struktures	Gjendja
0	78.0	7.35	1972	Kuverte mbi pilota	Gerryerje e konsiderueshme poshte kuvertes + traversa, gjendje e keqe e gureve, rrjetave metalike Per t'u riparuar
1	178.5	7.35	1972, Rikonstruktuar me 1994	Kuverte mbi pilota	
2			1949-1951 Rikonstruktuar me 1994	Pjeserisht kuverte mbi pilota dhe pjeserisht mur mbajtes beton armeje (prane kalates 3)	
3	30.0	7.35	1949-1951 Rikonstruktuar me 1994	Mur mbajtes beton armeje	Projekti per rikonstruktimin eshte pergatitur; buxheti per punimet rikonstruktuese eshte perfshire ne planin e biznesit te APD-se per vitin 2008
4	173.8	7.35	1949-1951 Rikonstruktuar me 1994	Mur mbajtes beton armeje	
5	235.9	9.85	1966	Kuverte mbi	Gjendje e mire



Kalata	Gajtesia (m)	Thellesia e Projektuar (m)	Viti i ndertimit/historia	Tipi i Struktures	Gjendja
6	265.4	9.85	Rikonstruktuar me 1999-2000 1966	pilota Kuverte mbi pilota	Gjendje e mire
7/8	405.8	9.85	Rikonstruktuar me 1999-2000 1961-1964	Mur mbajtes beton armeje	Rikonstruksioni (ne gjeresine 11.5m) perfshihet ne projektin per terminalin e anijve, te financuar nga BE-ja
9 (terminali i rageseve) Porti i Peshkimit	122.0	7.35	1960-1963	Kuverte mbi pilota	Rikonstruksioni perfshihet ne projektin e financuar nga BE-ja
Kantieri Detar					Do te zhvendoset ne zonen perendimore ne perendim te portit brenda nje periudhe afat-shkurter Kantieri Detar Siperfaqe ne pronesi private, me struktura te vjetra dhe te mbajtura keq
Kalata 10	249.7	9.85	1978	Kuverte mbi pilota	Gjendje e keqe, gjendje e mjerueshme e mobilimit te kalates. Projekti eshte pergatitur per rikonstruktim ne nje thellesi prej 11.5m pergjate kalatave
Kalata 11 Bankina dhe Çisterna e Naftes	173.0	9.85	1994-1997	Kuverte mbi pilota Bankine beton armeje me ure dhe bova lidhese prej çeliku	Gjendje shume e keqe Terminalet e naftes do te zhvendosen ne Porto Romano brenda nje kohe te shkurter

Nje pershkrim me i detajuar i gjendjes teknike te infrastruktures se portit jepet ne Aneksin 2.

2.6.2 Kushtet e Kantierit

1. Kushtet Meteorologjike



Veçoritë e përgjithshme të klimes në gjirin e Durrësit

Durrësi ndodhet në pjesën Adriatike të Detit Mesdhe. Adriatiku si dhe pjesa tjetër e Mesdheut, është i karakterizuar nga një klimë e butë. Era zakonisht është e lehtë dhe stuhit janë të rralla. Stinat kryesore janë vera dhe dimri. Pranvera dhe vjeshta janë periudha kalimtare. Këto periudha kalimtare janë mjaft të trazura dhe të karakterizuara nga një mot të paqendrueshëm dhe nga erëra të forta.

Ererat

Gjatë periudhës verore, era është zakonisht e butë në zonën e Adriatikut, mesatarisht me Forcë 2 ose 3. Ndërsa era e dimrit është më e fortë. Forca mesatare e erës është afërsisht baras me 4. Të dhënat mbi drejtimin e erës janë të paraqitura në Tabelën 2-16. Një stacion meteorologjik është i vendosur direkt në zonën e portit të Durrësit. Duhet përmendur se ky stacion është i mbrojtur nga ererat që fryjnë nga lindja dhe verilindja dhe kjo domethënë se do të ketë frekuencë të ulta të erërave nga këto drejtime.

Tabela 2-16 Drejtimi i erës (që fryn nga) dhe frekuenca (stacioni i Portit të Durrësit)

Drejtimi i erës	E qete	V	VL	L	JL	J	JP	P	VP
Frekuenca %	6.2	27.3	4.3	3.8	21.9	7.6	6.6	13.3	8.5

Në bazë të Tabelës 2-16, drejtimi kryesor është ai i Veriut. Megjithatë, era më e fortë vjen nga drejtimi jug-lindor dhe jugor. Shpejtesitë mesatare të erërave në muaj dhe në bazë të drejtim janë të paraqitura në Tabelën 2-17. Si mund të shohim nga kjo tabelë, shpejtesia mesatare e erës në muaj shkon nga 3.1 në 4.8 m/s. Shpejtesia më e lartë e vërejtur ka qenë 40 m/s. Tabelën 2-18 paraqet frekuencën e shpejtesisë së erës. Gjatë një viti kalendarik, vetëm në 20 ditë ererat janë më të forta se 15 m/s. Drejtimet kryesore të këtyre erërave të forta janë jugu dhe jug-perëndimi.

Tabela 2-17 Shpejtesia mesatare e erës (stacioni i Portit të Durrësit)

Muaji	Drejtimi							
	veri	Verilindje	Lindje	Juglindje	Jug	Jugperëndim	Perëndim	Veriperëndim
J	3.6	2.6	3.5	4.9	7.5	6.1	4.4	2.1
Sh	4.5	2.6	2.8	4.3	7.1	7.2	5.5	3.6
M	3.4	2.5	3.3	4.4	7.6	6.7	4.2	3.6
P	2.8	2.5	2.7	3.9	7.0	6.1	4.8	3.5
M	2.5	1.9	1.8	3.1	6.3	4.6	4.6	3.9
Q	2.4	2.0	1.6	2.7	5.1	4.8	4.8	3.5
K	2.3	1.4	1.5	2.6	3.6	4.8	4.9	4.4
G	2.1	1.7	1.8	2.9	4.5	4.8	4.9	4.1
SH	2.6	1.9	2.3	3.2	5.8	4.7	4.6	3.8
T	2.7	2.2	3.6	3.7	6.0	6.0	3.6	3.2
N	2.9	2.2	2.9	4.9	6.9	6.9	4.9	2.7
DH	3.3	2.9	3.7	5.3	9.1	7.7	6.2	1.9

Tabela 2-188 Frekuenca e shpejtesisë së erës (Stacioni i Portit të Durrësit)



Klasa	Shpejtesia eres [m/s]				
	0 - 1	2 - 5	6 - 10	11 - 15	>15
Frekuenca [%]	22.5	55.7	17.6	2.2	2.0

Temperatura ajrore

Mesatarja e temperatures ajrore ne Portin e Durresit varion midis 8.3 dhe 24.0°C. Temperatura absolute maksimale e verejtur ka qene 38.6°C (07-08-1988), ndersa absolutja minimale ka qene -0.6°C (14-01-1968).

Tabela 2- paraqet mesataren vjetore dhe mujore te temperaturave ajrore. Te dhenat bazohen ne te dhenat e periudhes 1961 – 1990.

Tabela 2-19 Temperatura ne Portin e Durresit (°C)

Temperatura ajerore mesatare ne muaj [°C]	Muajt												
	J	S	M	P	M	Q	K	G	S	T	N	D	Vjetore
	8.3	9.0	11.0	14.2	18.2	21.8	24.0	23.9	21.4	17.6	13.4	9.8	16.0

Reshjet

Table 2-19 me poshte paraqet mesataren e reshjeve ne muaj dhe ne vit. Reshjet me te shpeshta mund te parashikohen gjate periudhave dimerore nga tetori ne janar.

Table 2-19 Mesatarja e reshjeve ne muaj (mm)

Mesatarja e Reshje ne Muaj [mm]	Muajt												
	J	S	M	P	M	Q	K	G	Sh	T	N	D	Vjetore
	111	91	95	76	51	39	24	35	63	10	13	11	932
										1	3	3	

Tabela 2-20 Reshje: Propabiliteti qe reshjet te jene siper nje sasie te caktuar (mm) ⁴

Siguria %	1%	2%	5%	10%	20%	50%
Maks.muaj	495	447	383	334	282	204
Maks. 24 h	199	178	151	130	108	74
Maks 12 h	165	147	124	106	87	59
Maks 6 h	127	115	98	85	71	50
Maks 2 h	94	85	73	64	54	39
Maks 1 h	73	66	57	50	43	32
Maks 30 min	56	50	43	38	32	24
Maks 20 min	44	40	35	31	27	20
Maks 10 min	31	28	25	22	19	15

2. Batimetria

⁴ Burimi: Dr. Engr. Kristo Goga (per projektin e terminalit te trageteve ne Durres)



Aneksi "Plane dhe Vizatime" I ketij raporti perfshin harten batimetrike e cila bazohet ne nje fushate vezhigimi e ekzekutuar ne vitin 2006 per basenin e portit dhe kanalin, dhe tabelen qe jep me tej rrethinat e portit.

3. Kushtet hidraulike

Ky seksion jep nje permbledhje te kushteve hidraulike ne Gjirin e Durresit⁵.

Valet

Gjendja e valeve ne kete seksion bazohet mbi te dhenat e transmetuara nga stacioni hidrografik i vendosur ne perendim te skolieres me nje thellesi prej 7m. Ky stacion eshte I mbrojtur nga drejtimet veri dhe lindje. Veçorit e verrejtura te valeve ne gjirin e Durresit jane pjeserisht rezultat i morfologjise se bregut. Pjesa e ceket e detit ne Durres ndodhet ne veri te gjirit dhe valet ne drejtimin e veriut jane te ndikuara nga cektina.

Tabela 2-22 Frekuenca e lartesis se valeve

Klasa	Lartesia e vales (metra)				
	<0.25	0.25 – 0.5	0.5 – 0.75	0.75 – 1.25	1.25 – 2.0
Frekuenca [%]	72.55	20.31	4.04	2.73	0.37

Duke shqyrtuar lartesine e valet me te medha ashtu si i paraqet tabela sipërme, frekuenca per klasen e valeve me te medha, mund te nendahet ne drejtime individuale te valeve ne kete menyre: jug 0.26%, jug-perendimi 0.08%, dhe perendimi 0.03%.

Table 2-21 Drejtimi I vales (>0.5m) frekuenca

Drejtimi I vales	<0.5 m	ESE	SE	SSE	S	SSW	SW	WSW	W	WNW	NW
Frequency [%]	74.8	0.10	0.17	1.37	5.31	6.18	5.15	3.24	2.65	0.78	0.24

Tabela e meposhtme paraqet lartesis e dallgeve ne afersi te skolieres te Portit te Durresit per periudha riperseritjeje te ndryshme⁶.

Table 2-22 Propabiliteti I lartesis maksimale te vales

Lartesia e Vales [m]	Periudha e kthimit (vite)			
	100	50	20	10
	3.20	2.90	2.50	2.25

Rrymat

Pergjithesisht, rrymat e bregdetit Shqiptar prodhoen nga forca gradiente, fenomenet e batices dhe valet. Matjet jane kryer qoft nga matesi i rrymave qoft nga pluskuesi (ne thellesi te ndryshme). Shpejtesia e rrymave te matura nuk tejkalon 0.25% dhe drejtimi kyesor eshte veri-perendimi. Ne det te hapur, pertej gjirit te Durresit, jane matur rryma me te qendrueshme me nje shpejtesi qe nuk kalon 0.4m/s ne drejtimet veri dhe veri-perendim.

⁵ Burimi: Wilbur Smith, Raporti i Rishikimi Ambjentalist te Gerryerjes (Nentor 2002), dhe Adriatik Pilot, Trevor and Dinah Thompson Edicioni i Katert

⁶ Burimi: Tablea Nr. 1590 e Forcave Detare



Nivelet e ujit

Luhatjet e niveleve të ujit në bregdetin shqiptar janë një shkak i fenomeneve të baticave dhe i fenomeneve hidro-meteorologjike (sidomos ererat). Periudha e baticës zgjatë 12 orë dhe është e çrregullt. Proçeset e baticave në bregdetin shqiptar janë javore dhe luhatja ditore në amplitudën e nivelit të ujit është mesatarisht 0.3m.

Tabela e mëposhtme paraqet nivelet e baticave për vendin e interesuar nga projekti.

Tabela 2-23 Nivelet e baticave në Durrës

Vendi	LAT	LONG	Lartësia në metra mbi nivelin datum			
	N	E	MHWS	MHWN	MLWN	MLWS
Durrës	41°19'	19°27'	0.3	0.2	0.1	0.0

Vini re: datum është afërsisht Batika me e Ulet Astronomike.

Ndikimi i ererave të forta, sidomos nga jugu provokon një luhatje me të lartë në amplitudën e nivelit të ujit. Niveli i ujit me të lartë i vërejtur në gjirin e Durrësit ka qenë 0.92 ndërsa me të ulët ka qenë 0.48m. Tabela 2-26 paraqet nivelet ekstreme të ujit të parashikuara me probabilitetin ripërseritjes të tyre.

Tabela 2-24 Mundësia e Niveleve Ekstreme të Ujit (m)

	Periudha e kthimit (vite)				
	100	50	20	10	5
Niveli maksimal	1.07	1.04	0.99	0.94	0.89
Niveli minimal	-0.48	-0.43	-0.41	-0.38	-0.35

4. Parametrat Gjeoteknik

Nga investigimet që janë bërë në Portin e Durrësit është vërejtur që profili i përgjithshëm gjeologjik konsiston në shtresa rere, suargjila argjila, torfe, lym. Ndeshen depozitimet detare (Qu dt) dhe ato të neogjenit (N2h N13).

Depozitimet e Neogjenit

Keto depozitime përbehen nga torfa, argjila dhe rera, me një cimentim të dobët deri mesatar të argjilave. Trashësia e Shtresës është rreth 15-20m. Keto formacione përfshijnë kodren e Durrësit dhe atë të Rashbullit. Mendohet që ndërmjet dy kodrave ka ekzistuar një kanion i cili me vone është mbushur me depozitimet detare. Depozitimet e neogjenit vijnë duke u zvogëluar nga perëndimi në lindje. Në anën perëndimore ato ndeshen me shtresa me trashësi rreth 10 deri 30m, ndërsa në drejtimin lindor keto ndeshen me trashësi 80 – 100m.

Depozitimet Detare

Keto depozitime janë të përfaqësuara me argjila në lym, argjila, lymra ranore, rera. Depozitat janë me një ngjeshmëri të butë dhe kapërcejnë në disa vende trashësinë 38-42 m, ku depozitimet detare kanë një ngjeshmëri të mirë. Keto depozitime janë pothuajse uniforme. Trashësia e depozitimeve detare rritet nga perëndimi në lindje, ku fillojnë me 10-30m dhe në pjesën lindore të portit arrijnë në 80 – 100m.

Te dhenat e Shtresave



Bazuar ne studimet e mepareshme dhe sondave gjeologjike te kryera ne vend me poshte jepen te dhenat e shtresave qe ndeshen ne zonen e Portit te Durrësit.

Shtresa n. 1. Kjo shtrese ka material mineral dhe gure gelqeror dhe ne disa vende zhavor lumi. Ne menyre qe te identifikohen karakteristikat e kesaj shtrese jane mare kampione ne vende te ndryshme dhe jane bere nje numer provash.

Shtresa n.2. Kjo shtrese eshte karakterizuar nga lymra ranore, me ngjyre grite ngopura me uje, dhe me permbajtje materiali organik dhe pak te ngjeshura. Shtresa ndeshet ne nje thellesi te madhe ose prane mbushjes me depozitime detare.

Shtresa n.3. Kjo shtrese eshte karakterizuar nga Argjila lymore, ngjyre gri, me permbajtje materiali organik I shperndare ne menyre heterogjene ne masen e argjiles, me ngjeshmeri te . Shtresa ndeshet nen shtresen nr.2 nga sheshi trageteve deri tek Ura e dajlanit. Kjo shtrese vazhdon deri ne thellesine 38m.

Shtresa n.4. Kjo shtrese eshte e perfaqesuar nga argjit ngjyre bezhe me pakklageshti , e forte dhe e konsoliduar. Ndeshet ne thellesine 38 – 40 m me 3.5 – 4.0 m trashesi. Shume studiues e kane quajtur kete si formacion shkembor por se fundi studiuesit e kane quajtur si normal depozitim.

Shtresa n.5. Perfaqesohet nga argjila lymore ne ngjyre gri me lageshti, e bute, me permbajtje shtresash te holla me rere me trashesi 15-20cm. Ndeshet nen shtresen nr.4 ka nje trashesi rreth 30m.

5. Sizmika

Ne raportin e projektit te zbatimit te Terminalit te Trageteve sizmiciteti eshte marre ne konsiderate. Akselerimi horizontal maksimal I truallit gjate termetit eshte marre me 0.26g. Kjo shifer eshte bazuar ne Kategorine 3 te argjilave dhe ne shkallen VIII balle. Ngarkesat sizmike duhet te percaktohen pergjithesisht ne pajtim me UBC 1997 Kushtet e Projektimit ne Termete.

2.7 Kuadri aktual ligjor dhe institucional

2.7.1 Kuadri ligjor – prezantimi I konceptit Landlord

Ligji I Autoritetit Portual Me adoptimin e Ligjit Nr. 9130 I dates 8 Shtator 2003, Parlamenti I Republikes se Shqiperise prezantoi konceptin e portit landlord dhe dhe perkufizoi parimet e organizimit te autoritetit qe manaxhon porte te tilla, rregullat e tyre, funksionet dhe administrimin si dhe marredheniet e tyre me operatoret dhe organet shteterore dhe perfaqesimin e ketij te fundit.

Ligji i Autoritetit Portual eshte hartuar per te reformuar sektorin portual ne Shqiperi dhe I siguron autoriteti portual te tille si APD me te gjitha fuqite e nevojshme dhe aftesine pet e vepruar si organizate landlord ne emer te Qeverise Shqiptare.

Roli i portit landlord keshtu kerkon qe Autoriteti Portual ti jape sektorit privat nje rol me te madh ne drejtimin e portit dhe ne vecanti ne operimin e shume sherbimeve portuale, ne vecanti, edhe pse jo ne menyre ekskluzive, nepermjet akordimit te koncesioneve.



Nje nen shume kritik ne ligj eshte Neni 5 i cili perkufizon funksionimin e Autoritetit Portual. Neni f ne menyre te drejtperdrejte deklarone qe Autoriteti Portual duhet te fitoje statusin e 'portit landlord' brenda periudhes se percaktuar ne Nenin 9.3. (p.sh. brenda nje periudhe prej tre vjetesh). Zhvillimi I master planit keshtu duhte te marre plotesisht ne konsiderate deklaratat e ligjit te Autoritetit Portual te cilat e perkufizojne portin landlord si nje port te administruar nga Autoriteti I cili manaxhon token e portit dhe infrastrukturen, por jo I perfshire ne performancen e sherbimeve portuale dhe sigurimin e pajisjeve portuale. Kjo ateheere duhet te jete baza per zhvillimin e ardhshem dhe manaxhimin e portit te Durrësit.

Ligji mbi Koncesionet

Bazuar ne Nenin 5 te Ligjit per koncesionet (Ligji # 9663 te dates 18/12/2006) autoriteti kontraktues shqiptar duhet te jete Ministria ose pushteti lokal. Autoriteti portual nuk eshte asnje prej tyre edhe pse ligji # 9130 I 8 shtatorit 2003 ne nenin 31 edhe pse e vesh autoritetin portual me te drejta kontraktuese (referuar qe ketej e tutje si Ligji i Koncesioneve i vitit 1995), ka shume pak dyshim se Ministria e Transportit do te jete autoriteti kontraktual per koncesionet ne port mbi autoritetin portual. Net e vertete ligji per Ligjin e koncesioneve ka precedence mbi ligjin e Autoritetit Portual.

Ligji I pergjithshem per koncesionet ne kete menyre konsideron se aktivitetet dhe objektet portuale e kane te pamundur te mbijetojne. Kete e mbeshtet dhe Keshilli I Ministrave me iniciativen qe favorizon investoret lokale dhe nderkombetare, Shqiperia 1 Euro nga pikpamja financiare dhe ajo komerciale.

Situata aktuale sidoqofte, kur objektet ne port jane prona te rendesishme dhe nese kushtet administrative per administrimin dhe perdorimin e terminaleve te konteniereve behen te favorshme, do te lere shteg per investime serioze dhe investoret do te jene ne gjendje te paguajne qerate dhe shpenzime te tjera. Nje faktor komplikues ne Shqiperi eshte se e drejta e pronesise per token mbeten ne autoritetin e Ministrise se Ekonomise, duke e vene ne rrezik rolin e 'landlord' te autoritetit portual, ne kete rast ngrihet pyetja nese duhet te jete apo jo kjo ministri qe do te perfitoje pagesat e qerases. autoriteti portual duke lene shteg per pyetje nese duhet te jete ministria qe duhet te marre qirate ne kete rast.

Kontradite Neni 31 I ligjit te Autoritetit Portual, i cili parashikon per Bordin Mbikqyres dhe Autoritetin Portual per te akorduar koncesione dhe I referohet ligjit per koncesione te vitit 1995, eshte ne kundërshtim me Nenin 12 te 12 Janar 2007 dhe deklarone se autoriteti kontraktues mund te jene ministrite e linjes ose njesite e qeverive lokale. Autoriteti Portual nuk eshte ne asnje prej tyre dhe ndersa Neni 24 I Ligjit per koncesion thote se ne rast te ndonje konflikti ndermjet ligjit te koncesionit dhe cdo ligji ekzisues, merr precedence ligji per koncesionet, kjo do te thote qe Autoriteti Portual nuk lejohet te jete autoritet kontraktues.

2.7.2 Pronesia e tokes

Pronesia e tokes alokuar kantierit Kūrūm I perket Durrës-Kūrūm Shipyard Sh.a. Kjo e fundit eshte nje joint venture ndermjet Kūrūm Group dhe Ministrise se Ekonomise se Shqiperise mbi bazen e 65%/35% te aksioneve. I gjithë kantieri, I cili ndodhet ne mes te prones aktuale te portit, eshte 82 000 metra katrore siperfaqe tokesore dhe 40 000 metra katrore siperfaqe ujore. Per sa kohe qe joint venture eshte active, pronesia mbetet me Durrës-Kūrūm Shipyard Sh.a.



Problemi me token e okupuar nga kantierin e KËrËmit eshte prezenca fizike brenda pronesise se portit nderkohe qe pronesia eshte private. Parimi qe nenvizon konceptin e portit landlord eshte qe e gjithë toka duhet ti perkase autoritetit portual i cili eshte pergjegjes per manaxhimin, operimin dhe mirembajtjen e te gjitha asetëve brenda prones portuale. Keshtu, zgjidhja ndaj problemit te krijuar nga pronesia e kantierit nga Kurumi duhet te zgjidhet sa me shpejt te jete e mundur.

2.8 Biznesi (Stakeholders)

Biznesi perfaqeson Agjensite Publike te perfshira ne zhvillimin e portit dhe sektorin privat. Sektori public ne perspective jane:

Grupi drejtues i APD
Ministria e Transportit
Komisioni European
Bashkia Durrës
Hekurudha Shtetërore
Kapiteneria
Dogana

Interesi I sektorit privat identifikohet si meposhte ne dy nivele:

Fillimisht, Porti I Durrësit karakterizohet nga Komiteti Keshillues I Portit. Ky komitet ka per qellim te perfaqesojë spektrin me te gjere te klientëve te portit ne koordinim me Hekurudhen Shtetërore, Doganen dhe Kapitenerine. Keto jane natyrisht linja e pare e interesit ne ristrukturimin e portit dhe ftohen te kontrollojne propozimet e ndryshme dhe te sigurojne analizen e tyre, zonat e fokusit dhe rekomandimet. Kjo perfshin interesat e meposhtme:

Dhoma e Tregtise
Perfaqesuesit e kompanive speditonere
Perfaqesuesit e agjensive te transportit
Perfaqesues te kompanive te sherbimeve detare
Perfaqesues te agjensive te Tragetëve

Lloji I dyte I paleve te sektorit privat eshte ne nje rreth me te zgjeruar ne lidhje me interesin e perdorimit te portit ne lidhje me zhvillimin e portit dhe pjesemarrjen ne operacionet e tij.

Aktualisht jane identifikuar disa trafike industriale te nje shkalle te larte, shumica tregti mallrash te thata refuxho. Pergjate me keto lloj tregtish, industrite private ne Shqiperi kane treguar interes ne kryerjen e investimeve direkte ne facilitetet portuale me qellim qe te krijojne kapacitetin per te perpunuar tregtine e mallrave nderkombetare te thata refuxho, te tilla si cemento, celik, kohet e fundit ka nje rritje ne tregun boteror ne kuader te kerkeses dhe cmimit.

Keshtu, perfaqesuesit e interesav te tilla jane ftuar te marrin pjese per te diskutuar propozimet e ndryshme dhe te vleresojne mundesite e parashikuara PPP ne lidhje me tregtine e ketyre mallrave. Keto jane:

Fabrika e Cimentos Frushe-Kruje, te cilat aktualisht operojne ne nje fabrike ne Fushe Kruje dhe sherbejne kryesosht per tregun e brendshem.
Titan Cement (ANTEA Group – Greece)



Kurum Shipyards

Perfaqesues nga industrite Kurum, kryesisht ne sektorin e prodhimit te celikut.

Keto kompani private perfaqesojne nje potencial te madh te klienteve per portin, duke rritur industrine dhe prodhimin shqiptar, si dhe duke rritur eksportet e vendit, por gjithashtu investitoret potenciale ne zgjerimin e portit dhe planet e zhvillimit.

Per keto importues dhe eksportues eshte e rendesishme qe te kete kapacitet te mjaftueshem ne Durres per te siguruar qe industrite e tyre te mund te punojne. Keshtu porti perfaqeson nje lidhje kritike ne zinxhirin e pergjithshem te logjistikës, dhe duhet te siguroje terminale te modernizuar me eficence te larte ne operacione dhe ne kapacitetin e tranzitit, duke siguruar furnizim ose dalje te vazhdueshme te njesive te prodhimit.

2.9 Situata aktuale financiare

2.9.1 Te Pergjitheshme

Te dhenat financiare jane siguruar nga Sektori I Finances I APD. Shifrat me te fundit financiare te audituara I perkasin viteve 2003, 2004 dhe 2005. Gjithashtu edhe te dhenat e paaudituar jane marre parasysh ne modelin financiar. Auditimi I llogarive eshte bere nga Deloitte Albania.

Aktiviteti me I rendesishem qe gjeneron te ardhura aktualisht jane sherbimi I perpunimit te ngarkesave. Porti paraqet nje aktivitet te pergjithshem me fitim, nderkohe qe asnje krahasim I detajuar I seciles nga fushat (perpunimi, infrastruktura, dhe sherbime te tjera) nuk jane siguruar per te vleresuar peshen individuale te komponenteve te ndryshem.

Bilanci I portit paraqet borxhe afatgjata nga organizata te ndryshme qeveritare si Fondi Kuvajtjan, EIB, OPEC and IDA. Aktualisht porti ka disa hua qe arrijne vleren totale 4 Miliard LEK.

Maturimi I ketyre huave varion nga 2012 (Kuwait Fund) deri 2038 (IDA). Duke filluar ne 2008, APD do te kete ripagesat duke filluar nga nje vlere totale prej 31 Milion EURO (3.7 Miliard LEK), per huate e marra nga IDA dhe EIB (Banka Europiane e Investimeve).

Duke marre huate qe duhen shlyer nga 2008 e me tej, nderkohe qe pritet nje reforme institucionale per te riorganizuar strukturen e tarifave me privatizimin e metejshe me te aktiviteve te perpunimit, eshte e rendesishme qe APD te hartoje nje strategji financimi e cila nderlidhet fort me prezantimin e skemave koncesionare ne terminale te ndryshme. Mundesia ne te ardhmen qe APD te mund te marre hua shese per zhvillimin e tij do te ndikohet shume nga shuma e aktiveve fikse dhe huate ekzistuese aktualisht ne Bilanc. Perqindja e larte e dividenteve qe I paguhen ministrise gjithashtu sfidon mundesite vete-financuese te APD-se.

2.9.2 Struktura e te Ardhurave

Autonomia financiare e APD-se si Autoritet Portual eshte ndikuar shume nga korniza institucionale aktuale dhe e ardhme ne portet Shqiptare. Analiza dhe modelimi I ndikimit I reformes se struktures se te ardhurave se APD-se do te jete pika fillestare e percaktimit te



projektimeve te flukseve te parave dhe kerkesave per financim. Per kete perspektive do te dizenojohen disa skenare.

Tarifat portuale

Ne portin e Durrësit mblidhen 5 lloj tarifash portuale. Sistemi bazohet ne nje mbledhje te perbashket ndermjet Kapitenerise dhe Autoritetit Portual. Baza per qarkullimin e tarifave portuale eshte Tonazhi Neto I Regjistruar I anijeve (NRT)⁷. Duke perdorur NRT-ne ka nje lloj paqartësie ne lidhje me llojin e anijes. Ky sistem me shume mund ti pershtatet anijeve qe transportojne mall refuxho se sa tragetet, meqenese ato paraqesin proporcione te ndryshme te NRT-se krahasuar me volumen e pergjithshem te seciles anije. Ky efekt ne nje fare menyre korrigjohet ne librin aktual te tarifave, me ane te aplikimit te niveleve te ndryshme te NRT-se per anijet e mallrave refuxho dhe anijeve te tjera.

Kapiteneria ka te drejte te mbledhe Tarifa Portuale dhe Tarifa Light. Keshtu kuptohet qe Tarifat Portuale nuk i alokohen drejtperdrejte rikuperimit te koston per infrastrukturen e portit te tille si skoliera, dragimi i basenit, sic jane skemat tradicionale te porteve. E nejtja aplikohet edhe per tarifat Light (e lehta), meqenese ndihmat e lundrimit ne kanalin e hyrjes operohen dhe mirembahen nga Marina Kombetare (Departamenti i Hidrografise.)

Si Autoritet Portual, APD mbledh Tarifa Ankorimi, duke qene pergjegjese per operacionet dhe mirembajtjen e kalatave, dhe tarifave te Kanalit. APD eshte ne ngarkim te mirembajtjes se thellimit dhe keshtu mbledh tarifat koresponduese.

Sherbimet e Marines

Sic u permend me pare, APD nuk ka asnje te ardhur te lidhur me sherbimet e marines. Keto performohen nga kompani te vecanta te specializuara, publike dhe private (shih seksionin 2).

Sherbimet e mgarkim -shkarkimit

Nje fushe tjeter ku eshte bere privatizimi jane sherbimet stivadore. Sherbimi kryhet ne bashkepunim me APD-ne e cila siguron pajisjet (vincat dhe makinerite e sheshit), ndersa kompania stivadore siguron forcen e punes. Kjo aplikohet per perpunimin e te gjitha ngarkesave te pergjithshme dhe perpunimit te dritherave.

Per perpunimin e ngarkesave te pergjithshme, libri i tarifave siguron alokimin e te ardhurave ndermjet APD-se dhe kompanise stivadore. Perqindja e APD-se eshte 58% per pagesat e pergjithshme te perpunimit ne breg. Per terminalin e drithit kjo perqindje eshte 89% dhe 11% per kompanine Stivadore.

Operacionet breg-shesh performohen nga APD-ja. Kompanite stivadore qe operojne ne Durrës perpunojne vetem operacionet nga Anija ne Breg. Keshtu porti mbledh te gjitha te ardhurat nga perpunimi i sheshit dhe aktivitetet e magazinimit.

⁷ Ky system aktualisht eshte nen studim per ristrukturim potencial. Ministria e linjes eshte ne ngarkim te nje rishikimi te tille.



3 TREGTIA DHE TRAFIKU

3.1 Hyrje

Ky kapitull paraqet perfundimin e vleresimit te Konsultetit per parashikimin e trafikur deri ne vitin 2030 ne Portin e Durrësit.

Metoda e ndjekur eshte e ndryshme per kategorite kryesore te trafikut. Setet e meposhtme dallohen ne analiza:

Per importete e ngarkesave te pergjithshme ndiqet metoda nga maja ne fund. Kjo do te thote qe parashikimi eshte i bazuar ne nje marredhenie ndermjet volumit te trafikut dhe performances ekonomike ne vend. Kjo marredhenie percaktohet ne baze te vlerave te vezhguara ne te kaluaren, te ekstrapolohen ne te ardhmen. Nje parashikim per evoluimin e GDP-se ne te ardhmen identifikohet. Bazuar ne parashikimin e GDP-se nga njera ane, dhe marredhenies GDP – trafik importi ne tjetren, eshte perpunuar nje parashikim per ngarkesat e pergjithshme te importit. Me tej, ngarkesa e pergjithshme eshte ndare ndermjet trafikut ro-ro, ngarkesave te pakontenierizuara dhe te kontenierizuara. Dallimi eshte bere ndermjet importeve me tregje te ndryshme. Kjo metode ilustruhet ne Figuren 3-1 ne faqen qe vijon.

Per eksportet e ngarkesave te pergjithshme jane identifikuar grupet kryesore te produkteve, dhe parashikimet aty jane ne baze te rezultateve te intervistave me autoritetet relevante.

Tranziti i ngarkesave te pergjithshme bazohet ne performancen ekonomike te tregjeve te destinacionit dhe ne te dhenat historike ne lidhje me origjinen dhe destinacionin e ngarkesave tranzit. Ngjashmerisht si me ngarkesat e importit, ka nje marredhenie ndermjet GDP-se se tregut destinacion dhe trafikut nga importi, nga e cila derivohet nje parashikim per importet e mallrave te pergjithshme nga importi.

Trafiku i drithit bazohet ne rritjen e popullsise dhe ne konsumimin per koke. Prodhimi lokal i drithit konsiderohet si i neglizhueshem.

Trafiku i mallit te thate refuxho bazohet ne zhvillimet industriale te planifikuara ne shqiperi.

Trafiku i pasagjereve bazohet ne analizat e prirjeve keto 15 vitet e fundit.


Trafiku ro-ro bazohet ne

Per ngarkesen: perqindja historike e ro-ro ne trafikun total te ngarkesave te pergjithshme
Makinat qe shoqerojne pasagjeret: bazuar ne perqindjen historike ndermjet pasagjereve dhe automjeteve

Importi i kamioneve dhe makinave supozohet te rriten me GDP-ne



Figure 3-1 Top-down approach general cargo and containers





3.2 Historia e trafikut te perpunuar ne Portin e Durrësit

3.2.1 Hyrje

Kjo pjese paraqet nje permbledhje te statistikave mbi historikun e trafikut nepermjet portit te Durrësit. Keto te dhena do te perdoren si input per perpunimin mbi parashikimet e trafikut. Seksioni i pare ne kete kapitull paraqet evoluimin e trafikut total. Ne seksionet e ardhshme, trafiku total ndahet ne nen-kategorit e rendesishme sipas menyres se transportit dhe origjines ose destinacionit te ngarkeses:


- Ngarkese e pergjithshme
 - E pakontenierizuar
 - E Kontenieizuar
 - Ro-ro
- Mall I thate refuxho
- Mall I lengesh refuxho
- Pasagjere

Nje pershkrim me I detajuar I Parashikimeve te Ngarkesave dhe analizat e tij sigurohen ne Aneksin 3 Tregtia dhe Trafiku. Te dhenat baze te perdorura per analizat paraqiten ne Anekset A dhe B ne Aneksin 3.

3.2.2 Trafiku total ne portin e Durrësit

Porti I Durrësi paraqet nje nderfaqeje te rendesishme per tregtine nderkombetare shqiptare dhe vepron si nje port hyrje per ne kryeqytet. Duke qene 42 km larg Tiranes, ne lidhje te Detit Adriatik me Jonin, Durrësi eshte gjithashtu nje vendodhje kyce per rrjetet e trageteve dhe tranzitin e pasagjereve. Kjo i jep Durrësit nje pozicion strategjik ne lidhje me Korridorin VIII, qe do te facilitoje tranzitin e pasagjereve dhe te mallrave me kontinentin Europian.

Figura 3-2 Volumi total I ngarkesave ne Portin e Durrësit



Porti aktualish ka 77% te importeve dhe 89% te eksporteve Shqiptare; kjo eshte baraz me 78% te tregtise totale detare ne nivel kombetar. Nderkohe Durrësi eshte kryesisht I orientuar ndaj importeve. Durrësi eshte nje alternative interesante per shtete pa dalje ne det si Kosova dhe Maqedonia, duke qene I pozicionuar ne pozicionin kyc ne uren Jug-Perendimore dhe Jug-Lindore te rrjeteve tregtare Europiane.


Nje prirje ne Durrës kohet e fundit është zhvillimi i shërbimeve të kontenerizuar. Për shkak të pesës së madhe në tregtinë Shqiptare, si dhe afërsinë që ka me Tiranën, Porti i Durrësit paraqet një ndikim të madh në rritjen e ekonomisë dhe tregtisë Shqiptare.

Zhvillimi i mallit të përpunuar në dekadën e fundit (1997-2006) tregon një normë rritje të shëndetshme prej 12% në vit për trafikun total të portit, deri në 3.4 milion ton në vitin 2006⁸. Edhe pse një pjesë e kësaj rritje mund të atribuohet rritjes së ngarkesave të përgjithshme këto 5 vitet e fundit, nxitja kryesore për rritjen e trafikut janë mallrat e thata refuxho. Kjo peshë relative e mallit të thatë refuxho në trafikun total është rritur mjaft nga 20% në fund të viteve nëntëdhjetë deri në afro 50% në 2006.

3.2.3 Ngarkesat e përgjithshme

Ngarkesa totale e përgjithshme Figura mëposhte tregon trafikun total të ngarkesave të përgjithshme në Portin e Durrësit⁹. Duhet të vini re që numrat përfshijnë të kontenerizuarat dhe të pa-kontenerizuarat, trafikun e trageteve, dhe jot e trageteve, importet, eksportet si dhe tranzitin.

Figure 3-3 Trafiku total i përgjithshëm në Portin e Durrësit



Origjina dhe destinacioni Harta në Figura 3-4 paraqet vendodhjen gjeografike të portit të Durrësit në rajonin e Adriatikut, bashkë me tregjet potenciale dhe portet konkurente. Tregjet sipas prioritetit janë: and the competing ports.

- Shqipëria
- Kosova
- Maqedonia
- Mali i Zi
- Serbia
- Bullgaria
- Greqia

Porte të tjera që mund të konsiderohen për të shërbyer këtyre rajoneve janë:


- Bar (Mali i Zi)
- Selanik (Greqi)

⁸ Burimi: Dep. i Statistikës në APD. Shifrat paraprake tregojnë një total trafikun prej 3.5 milion ton në 2007

⁹ Burimi: Dep. i Statistikës në APD.

- Varna dhe Burgas (Bullgari)

Figura 3-4 Porti I Durrësit, portet konkurente përgjate Korridorit VIII



Menyrat e transportit

Ne portin e Durrësit ngarkesa e përgjithshme vjen në mënyra të ndryshme, siç tregohen në matricën mëposhte.

Tabela 3-1 Metodat e transportit të konsideruara për ngarkesën e përgjithshme

	Ro-Ro ¹⁰	Lo-Lo ¹¹
Te pakënterizuar	Ne linjë me statistikën e mbajtura nga APD, kjo analizë nuk do të dallojë trafikun ro-ro me të njëjtin trafik të pakënterizuar ose të kontenerizuar. Edhe pse një pjesë relativisht e vogël e importeve të ngarkesave të përgjithshme që mbërrin në target (ro-ro) është e kontenerizuar, kjo nuk ka ndikim në operacionet në port. APD e regjistron këtë ngarkesë nën 'Trafik me Target'.	This category comprises cargo that is transported in loose units (eg. steel profiles), pre-slung (e.g. reinforcement steel), palletised (such as cement bags) etc. The PDA registers this cargo under the heading "General Cargo".
Te Kontenerizuar		This category comprises the containers that are handled on the container terminal. The PDA registers this cargo under the heading "Containers"

¹⁰ Ro-ro: *eng.* "Roll-on/Roll-off": ngarkesa me rrota, si automobila, rimorkiotorë ose makina hekurudhore. Gjate veprimtarisë ngarkuese/ shkarkuese ngarkesa drejtohet/rimorkiohet për tek/ nga anija dhe mbetet në kontakt me anijen/vend ankorimin.

¹¹ Lo-lo: *eng.* "Load-on/Load-off": ngarkesa që ngarkohet/ shkarkohet nga anija duke u ngritur lart me vinc ose mjete të tjera të ngjashme.



Ne vecanti ngarkesat e kontenierizuara tregojne nje rritje qe nga viti 2002. Ne vitin 2006 volumi i ngarkesave te kontenierizuara te shkarkuara ishte rreth 200 mije ton nga 1.4 milion ton ngarkese te pergjithshme te shkarkuar ne portin e Durrësit ne total.

Importet Durrësi eshte hyrja kryesore per importin e mallit te pergjithshem ne Shqiperi. Veç kesaj, porti merret me trafikun e tranzitit, kryesisht per shtetet fqinj si Kosova dhe Maqedonia qe nuk kane dalje ne det.

Fatkeqesisht te dhenat e disponueshme per portin e Durrësit nuk e bejne dallimin midis importit dhe mallit transit, dhe te dhenat nga zyra doganore jane perdorur per te llogaritur pjesen e seciles prej ketyre dy mallrave.

Tregjet kryesore per Portin e Durrësit jane Kosova dhe Maqedonia. Mund te verehet se afersisht 85% e mallit te shkarkuar eshte mall qe importon vet Shqiperia, dhe pjesa qe ngel, 15%, eshte tranzit per vendet e tjera. Ky raport eshte kostant per qellimin e ketij studimi, dhe aplikohet te historiku i te dhenave mbi trafikun per Portin e Durrësit deri ne vitin 2003 per te percaktuar historikun e importeve. Zhvillimi ne vitet e fundit mund te karakterizohet si vijon:

- Nga vit 2000, importet e mallit te pergjithshem ne Shqiperi eshte rritur me nje koeficient mesatar prej 6% ne vit afersisht.
- Trafiku Ro-Ro perben rreth 20% te importeve te mallit te pergjithshem total. Fakti qe importet ro-ro vine kryesisht nga Italia, tregon qe tregu me Italine, si partner i tregut te importeve ne Shqiperi, mbeten pak a shume kostante ne nje te pesten e importeve totale.
- Qe nga fillimi i trafikut te kontenjerve ne portin e Durrësit ne vitin 2000, kuota realtive e trafikut te kontenjerizuar eshte rritur me shpejtesi ne krahasim me mallin e pergjithshem te pakontenjerizuar.

Exportet Duke pare ngarkesen e pergjithshme te ngarkuar ne Portin e Durrësit, i gjithë trafiku konsiderohet te eksportohet, dhe ngarkesat e tranzitit nuk konsiderohen vecantazi¹². Eksportet konsistojne kryesisht ne tekstile dhe prodhime agrikulturore. Edhe pse volumet totale jane ende te vogla, nje rritje e qarte nga 2003 e me tej mund te verehet. Shumica ngarkesave te pergjithshme eksportohet me ro-ro.


3.2.4 Malli i thate refuxho

Importi i mallit te thate refuxho ne 1990 eshte dominuar nga luhatje te importit te drithit. Kohet e fundit gruri, drithi, misri importohen ne shqiperi pasi te korrat ne vend mnund te luhaten. Rritja e perpunimit te mallit te thate refuxho shkaktohet nga kerkesa per cemento, qe coi ne importimi e saj si mall refuxho. Investimet ne impiantet e cimentos ne Shqiperi kane stabilizuar importet per cemento dhe klinker ne vitin 2004.

Eksporti i mallit te thate refuxho ne Shqiperi, kryesisht perfshin xeherorin e kromit dhe ferokromin. Pas kolapsit te viteve te fundit te viteve 1990s minierat u mbyllen pasi nuk mnund te konkuronin indurstrine nderkombetare. Pas viteve 2000, minierat u rihapen dhe eksporti eshte rritur ne nivelet e viteve '90.

¹² Bazuar ne statistikat e APD, me perjashtime te vogla, praktikisht nuk ka mallra te ngarkuar neper anije ne portin e Durrësit, qe vijne te tilla nga vendet fqinje. Perjashtim bejne disa sasi te vogla vere maqedonase ne tranzit.

Figura 3-5 Trafiku I mallit te thate refuxho




3.2.5 Mall refuxho leng

Porti trajton aktualisht importet e naftes se Shqiperise, me nje bankine naftes te ndertuar ngjitur me skolieren e lindjes dhe nje depozite naftes ne zone veri-lindje te portit. Eshte raportuar se ky aktivitet do te hiqet nga porti i Durrësit brenda 18 muajsh afersisht – po kryen punime pajisje te tjera te marrjes se naftes ne Porto Romano, nje vend 20 km larg nga porti i Durrësit. Per kete arsye, ky mall nuk do te konsiderohet me ne studimin e master-planit. Mallra te tjera te lengshme, si per shembull vaj guzhine do te konsiderohen te perfshira ne trafikun e mallit te pergjithshem.

3.2.6 Trafiku I pasagjereve

Pasagjeret ne terminalin e trageteve perfshijne shoferet e kamioneve si dhe pasagjeret e makinave qe perdorin tragetin. Trageti kryesisht perdoret nga emigrantet shqiptare qe jetojne dhe punojne ne Europe dhe vizitojne familjet e tyre ne Shqiperi.

Figura 3-6 Trafiku I pasagjereve dhe automjeteve te pasagjereve





Ne të njëjtin grafik numri i makinave është planifikuar në varesi të numrit të pasagjereve. Importi i makinave është verifikuar dhe kjo duket se po stabilizohet në rreth 25 mijë në vit këto 3 vitet e fundit.

3.3 Parashikimi i Mallit të Brendshëm

3.3.1 Performanca Makro-ekonomike e Shqipërisë

Treguesi makro-ekonomik i përdorur për hartimin e parashikimeve të trafikut në Portin e Durrësit është Produkti i Brendshëm Bruto me çmime konstante. Është një matës i rendimentit ekonomik të Vendlindjes, për të ardhurat që prodhojnë kapacitetet dhe për fuqinë blerëse të popullsisë. Për këtë arsye, PBB-ja në çmime konstante shpesh shfaq një korrelacion të mirë me importet e mallit të përgjithshëm. Tabela 3-7 dhe Tabela 3-2 paraqesin vlerat aktuale të vëzhguara për GDP (në konstante 1990 miliard leke) për 15 vitet e fundit.

Figure 3-7 Evoluimi historik i GDP real në Shqipëri (x miliard Lek)




Table 3-2 GDP Historike GDP¹³ (x miliard leke, vlera konstante 1990)

Viti	1,992	1,993	1,994	1,995	1,996	1,997	1,998	1,999	2,000	2,001	2,002	2,003	2,004	2,005	2006
GDP (X miliard leke)	221	242	265	289	315	283	319	351	376	404	417	442	468	497	526

E njëjta gjë është paraqitur në diagramen e mëposhtme ku mund të verrehet që:

- Ka një rënie të qarte të ekonomisë nga viti 1996 në 1997

¹³ Burimi: Global Econ Data – Banka Botërore për Zhvillim, Data – IMF Pikepamje Ekonomike Botërore (WEO) (<http://econstats.com/weo/C002V017.htm>, statusi i website-it në 18 Janar 2008)



- Gjate 15 viteve te fundit PBB-ja eshte rritur me nje koeficient rritjeje mesatar rreth 6.4%.

Kohet e fundit, Oxford Economic Intelligence Unit ka zhvilluar nje studim mbi rritjen e PBB-se Shqiptare deri ne vitin 2013 – rritja e PBB-se eshte paraqitur ne tabelen e meposhtme.

Tabela 3-3 Rritja e parashikuar e GDP-se real ne Shqiperi¹⁴

	2007	2008	2009	2010 - 2013
Parashikimi rritjes GDP real (%p.a.)	5.9%	5.7%	4.7%	4.5%

Ka perputhje te gjere me parashikimet e bera ne prezantime te tjera dhe me studime te disponueshme te Konsulentit dhe perdoret si plan baze veprimi per rritjen e GDP-se ne Shqiperi.

Per qellimin e ketij studimi, eshte i nevojshem nje parashikim qe shkon deri ne vitin 2030 dhe Konsulenti propozon te ekstrapolohen te dhenat dhe te vendoset nje ecuri rritje kostante baraz me 4.5% p.a. per periudhen 2014-2030. Rritja e GDP-se reale per skenaret e ulet dhe te larte eshte vendosur te jete 1.5% per supozimin e ulet, perkatesisht siper shifres se rritjes ne planin e veprimi baze.

3.3.2 Mallrat e pergjithme

Importet


GDP reflekton performancen e nje ekonomie. Meqenese performance e ekonomiese eshte nje factor i rendesishem i aftesise se nje shteti per te blere produkte importi mallrash te pergjithshem, ka gjithnje nje lidhje ndermjet GDP real dhe ketyre importeve. Diagrama meposhte sqaron importet e ngarkesave te pergjithshme kundrejt GDP (ne miliard leke kostante) per Shqiperine. Identifikohet lidhja e meposhtme:

$\text{Importi i mallit te pergjithshem [x mije ton]} = -389 + 3.1 \times \text{PBB [miliard Lek, 1992]}$

Vlera (R^2)= 0.83 eshte nje tregues qe verteton se lidhja e percaktuar mund te pranohet. Lidhja midis GDP-se dhe importeve te mallit te pergjithshem te percaktuara nga 15 vitet e fundit mbeten te vlefshme edhe per te ardhmen, dhe aplikimi tyre te cmimet e parashikuara te GDP-se mundeson parashikimin e mallit te pergjithshem si tregon diagrama e meposhtme

¹⁴ Burimi: Njesia e Inteligjences Ekonomike e Oxford-it


Figura 3-8 Parashikimi i importit te ngarkeses se pergjithshme ne Shqiperi



Ne planin e veprimit baze, llogaritet se importet e mallit te pergjithshem do rriten nga 1.2 milion ton per vitin 2006 ne 4 milion ton aferesisht nga fundi i projektit te master-planit, per vitin 2030. Grafiku gjithashtu ilustron qe skenari pershkruan trafikun e kaluar (indikuar me ngjyre blu ne periudhen 1993-2006) shume mire duke mbeshtetur vlefshmerine e modelit te perdorur.

Per zhvillimin e master-planit, duhet ditur se cila perqindje e importit te mallit te pergjithshem mund transportohet me trafikun ro-ro, kontenjer apo me lo-lo te pakontenjerizuar. Paragrafet e ardhshem do te vleresojne kete menyre ndarje te importit te mallit.


Figura 3-9 Parashikim i ngarkesave te pergjithshme te importuara ne Shqiperi



Ro-Ro Historikisht perqindja e trafikut ro-ro ne importet e ngarkesave te pergjithshme ka luhatur nga 15% ne 25%. Ndersa importet ro-ro e kane kryesisht origjinen nga Italia, kjo mund te tregojte qe pjesa e tregut e Italise si partner tregtar i Shqiperise per importet mbetet pak a shume ne vleren 20% te importeve totale te mallrave te pergjithshme. Duke e aplikuar kete ne importet e ngarkesave te pergjithshme totale kemi nje projektim per

importet e ngarkesave te pergjithshme nepermjet ro-ro sic tregohet ne diagramen meposhte. Kjo ngarkese e importuar nepermjet kamioneve ose trailerave, e cila analizohet ne seksionin e trafikut ro-ro.

Figura 3-10 Importi i parashikuar i ngarkesave te pergjithshme nepermjet Portit te Durrësit.



Pas trafikut ro-ro, importet e mallit te pergjithshem qe tepron duhet te transportohen si mall lo-lo, ose si mall i perthshem i kontenjerizuar ose i pakonenjerzuar.

Kontenieret Megjithese tendenca e pergjithshme eshte per te rritur kontenierzimin e mallit te pergjithshem, do te kete gjithmone mallra jo te pershtatshem per transportin ne kontenjera. Per shembull: shufra hekuri ose llamarina, etj

Per te shprehur ndarjen e ngarkesave te pergjithshme qe do te transportohen me konteniere, perdoret ekuacioni i meposhtem:

$$\frac{\text{ContainerisedGeneralCargo}}{\text{TotalGeneralCargo}} = \frac{\text{ContainerisedGeneralCargo}}{\text{ContainerisableGeneralCargo}} \times \frac{\text{ContainerisableGeneralCargo}}{\text{TotalGeneralCargo}}$$

Ana e majte e ekuacionit quhet shpesh “perqindja e kontenierizimit”.

Faktori i pare eshte ne anen a djathte te ekuacionit dhe quhet shpesh “koeficienti i kontenierizimit” – eshte perqindja e mallit te kontenjerizueshem qe transportohet me kontenjera.

Faktori i dyte ne anen e djathte te ekuacionit i referohet perqindjes se mallit te pergjithshem qe mund te transportohet me kontenjera. Gjithcka varet nga llojet e mallrave te perpunuara ne portin perkates.

Per te percaktuar perqindjen e mallit te kontenjerzueshem nga gjith mallrat qe vine per import, Konsulenti percaktoj per secilin nga mallrat kryesor te importuar sasine qe do mund te kontenjerzohet. Tabela e meposhtme paraqet kontenjerzimin e percaktuar per klasat e mallrave te perdorur ne statistikat e Portit te Durrësit.




Table 3-4 Kontenjerzimi i mallit te pergjithshem sipas klasave

Malli	Kontenjerzimi	Malli	Kontenjerzimi
Mjell	100%	Kimikate	100%
Sheqer	100%	Barit	100%
Oriz	100%	Makineri	70%
Artikuj ushqimor	100%	Blloqe mermeri	0%
Vaj guzhine (paleta)	100%	Ushqim kafshesh	100%
Banane	100%	Xham	100%
Zarzavate	100%	Makineri	50%
Blloqe çimento	100%	Tulla/pllaka	100%
Çelik	50%	Gur/pllaka gipsoj	100%
Tulla/pllaka	100%	Hekurishte	100%
Material ndertimi	70%	Vere	100%
Blloqe Nitrat-Uré	100%	Mall tjetër	100%

Perfundimi i kesaj analize tregon se afersisht 90% i mallit te pergjithshem eshte i kontenierizueshem. Perderisa Konsulenti nuk parashikon asnje ndryshim radikal ne perberjen e mallit te pergjithshem, kjo perqindje mendohet se do qendroje ne menyre kostante gjate afatit te projektit. Ne te vertet nuk do te transportohet gjithë malli i kontenierizueshem me konteniera. Do te ekzistojë gjithmone nje pjese e mallit qe do te transportohet jashte konteniereve, si pershembull malli neper thasa. Kjo do te thote qe shkalla e kontenierizimit do te jete me ulet se 100%. Diagrama e meposhtme paraqet evolucionin historik te importeve ne Portin e Durrësit

Statistikat tregojne nje rritje te konsiderueshme te rendimentit kontenjer gjate 15 viteve te fundit. Gjate periudhes 2003-2006 rendimenti kontenjer eshte shumezuar me 6. Megjithese rendimenti i te gjithë llojeve te mallit eshte rritur gjate kesaj periudhe, asgje nuk eshte rritur as shpejts sa kontenieret. Kjo sepse procesi i kontenjerizimit eshte futur keto kohet e fundit ne Shqiperi.


Figure 3-11 Parashikim importet e kontenierizuara (million ton)



Zakonisht trafiku konteniereve ne nje port shprehet me TEU (Twenty Foot Equivalent Units – nje standart ISO kontenier prej 20 ft). Trafiku importeve ne TEU mund te llogaritet duke ndare importet e kontenierizuara permes ngarkimit mesatar te nje kontenjeri per import.

Bazuar ne informacionet te viteve 2005 – 2007 (gjysma e pare), mund te llogaritet nje ngarkim mesatar prej 17 ton/TEU per kontenieret e importit plot. Kjo shifer eshte me e larte ne Shqiperi se ne shume shtete te tjera, dhe mendohet se gradualisht do te zbrese ne nje nivel afersisht me 14 ton/TEU ashtu si ka ndodhur neper portet e tjera. Per parashikimin, eshte percaktuar se ngarkimi mesatar per TEU do te zbrese me 0.2 ton/TEU nga 17 ton/TEU ne 2006 deri sa te arrihet niveli 14 ton/TEU. Ne diagramen e meposhteme eshte paraqitur rezultati i plote kontenjereve te parashikuar per importin.


Figura 3-12 Parashikim per importet e kontenierizuara (mije TEU)



Malli i Pergjithshem I Pa-pakontenierizuar

Ne paragrafin e meparshem u studiuan importet e mallit ro-ro dhe importet e mallit te kontenierizuar. Importet e mallit te pergjithshem qe teprojne jane perpunuar si mall i pergjithshem lo-lo. Diagrami i meposhtem paraqet rezultatin e parashikuar per planet e ndryshme te veprimit per importet e mallit te ngarkuar dhe te shkarkuar (me vinçat e kalatave) te pakontenierizuar.

Figure 3-13 Parashikim importet e pakontenierizuara te ngarkesave te pergjithshme (mije ton)



Duke pare formen e pergjithshme te diagramit mund te theksohet se:



- Plani i ulet i veprimi tregon një rendiment më të lartë se plani i mesëm dhe i lartë i veprimi. Arsya është se plani i lartë i veprimi përfshin një rritje më të shpejtë të shkallës së kontenerizimit, dhe provokon një kalim të shpejtë nga importet e pakontenerizuar të ato të kontenerizuar, duke lënë për të rregulluar një trafik të mallit të pakontenerizuar relativisht të ulet.
- Këto tre plane veprimi tregojnë në radhë të parë një trafik që pakesohet dhe që do shtohet perseri pas disa vitesh. Kjo është një pasojë e një përjasje matematikore e ndjekur nga një parashikim për evolucionin e ardhshme të trafikut¹⁵. Interpretimi i saktë do të ishte që ngarkesat e përgjithshme të pakontenerizuara pritet të mbeten pak a shumë konstante gjatë horizontit të projektit, rreth një niveli prej 1.0 milion- 1.2 ton në vit.

Eksportet

Për eksportin e ngarkesave të përgjithshme është e rëndësishme të shihen produktet prej të cilëve përbehen produktet e eksportit. Tabela mëposhte paraqet detajet e mallrave të eksportuara gjatë viteve të fundit.

Nga një analizë del se produktet e eksportuara më të rëndësishme të Shqipërisë janë aktualisht: kepuçet, tekstili, rroba, hekuri dhe produkte çeliku. Sidomos këto të fundit në ton janë të rëndësishme. Në vitin 2006 është firmosur një marrëveshje midis Shqipërisë dhe BE-së, në të cilën është vendosur se gjithë taksat e importit në produktet e çelikut shqiptare duhet të shfuqizohen dhe se industria shqiptare e çelikut duhet të rekonstruktohet për të rritur konkurrencën e saj brenda 3 vitesh. Volumet e ardhshme të parashikuara janë bazuar në volumet historike me 4%, 3% dhe 2% rritje përkatësisht për një plan veprimi të lartë, të mesëm dhe të ulët.

Table 3-5 Analiza e eksporteve të ngarkesave të përgjithshme

Malli			2004	2005	2006
	Makineri	[ton]	1,462	3,066	1,257
	Tulla/pllaka	[ton]	0	0	5,272
	Gur/pllaka gipsoj	[ton]	702	3,627	14,385
	Hekurishte	[ton]	69,485	24,984	49,850
	Vere tranzit nga Maqedonia	[ton]	0	0	0
	Mallra të tjera	[ton]	1,781	7	10
	Shuma	[ton]	73,430	31,684	70,774
I kontenerizuar		[ton]	8,500	16,970	26,443
RoRo		[ton]	98,000	155,000	206,000
Malli		[ton]	179,930	203,654	303,217

Në të njëjtin studim të pasurisë së Vëndit figuron se bujqësia është një nga të ardhurat më të fuqishme për zhvillimin ekonomik në të ardhmen e shkurtër. Kjo u konfirmuar në debatin me Ministrin e Bujqësisë. Ulja në eksportin e produkteve bujqësore është e shkaktuar aktualisht mungesa e lidhjeve me tregun. Gjatë regjimit komunist kooperativat krijojnë

¹⁵ Kjo ndodh sepse në periudhën e parë shkalla e kontenerizimit rritet shpejt, deri sa arrijë një nivel përtej të cilit rritja fillon të bjë (shiko më poshtë). Deri në atë nivel kalimi nga trafiku i pakontenerizuar në atë të kontenerizuar le pas rritjen e përgjithshme të importeve të ngarkesës së përgjithshme. Përtej këtij niveli rritja në importin e ngarkesës së përgjithshme le pas rritjen e shkallës së kontenerizimit, duke dhënë si rezultat rritje të trafikut jo të kontenerizuar.




lidhjen midis bujkut dhe tregut. Pas regjimit komunist u prishen kooperativat dhe bujkët nuk krijuan me të tilla. Megjithatë mendohet se shoqëri private do të futen në këtë treg dhe zhvillimi i eksportit të produkteve bujqësore do të rritet me të njëjtin koeficient të koheve të fundit. Për këtë qëllim janë mbledhur nga FAO të dhëna të tjera mbi eksportimin e produkteve bujqësore. Ky koeficient nga viti 1999 në vitin 2006 ka qenë 25% në vit. Ky koeficient rritjeje është përdorur për periudhën që shkon deri në 2010 për planin e lartë të veprimit. Planin mesëm dhe i ulët i veprimit është bazuar në projektimet e bëra nga Ministria e Bujqësisë, si i prezantuar në raportin e Louis Berger (2005) dhe përdor një koeficient rritjeje baraz me 10% dhe 5%. Në të ardhmen e largët është përdorur një koeficient rritjeje baraz me 1%, në lidhje me koeficientin e rritjes së popullsisë, afërsisht si parashikimi i Louis Berger (2005).

Për pjesën e mallit të përgjithshëm që tepron nuk dihet asnjë detaj dhe plani i veprimit për rritjen janë bazuar në principin se rritja e eksportit është për një pjesë të madhe e varur nga krijimi i bizneseve të reja dhe është më pak e varur nga autonomia e rritjes së biznesve ekzistues. Prandaj rritja deri në vitin 2010 është parashikuar me një volum rritje të stabilizuar prej 50.000 tpa, 30.000 tpa dhe 20.000 tpa përkatësisht për planin e lartë e mesëm dhe të ulët të veprimit. Në të ardhmen e largët mendohet se rritja do të bazohet më shumë nga autonomia e rritjes së bizneseve ekzistuese të krijuara deri atëherë. Për këtë arsye janë përdorur koeficientë rritjeje prej përkatësisht 4%, 3% dhe 2% për planin e lartë e mesëm dhe të ulët të veprimit.

Ro-Ro Për eksportin Ro-Ro përqindja e transportit Ro-Ro të mallit të përgjithshëm total është llogaritur të jetë 50%, 60% dhe 70% përkatësisht për planin e lartë, e mesëm dhe të ulët të veprimit. Kjo do të thotë se në planin e lartë të veprimit parashikohet shifra më e ulët për mallin Ro-Ro (plani i lartë i veprimit fokusohet në një rendiment më të lartë kontejneresh dhe kur një volum më i madh mallrash mbahet nëpër kontejner më pak i takon transportit Ro-Ro) Transporti Ro-Ro është trajtuar me imtesisht në seksionin tragete/Ro-Ro.

Figura 3-14 Eksporti i ngarkesave të përgjithshme RoRo




Shifrat e mësipërme paraqesin eksportin e mallit të përgjithshëm Ro-Ro. Pritet që volumet Ro-Ro do të vazhdojnë të shtohen në të ardhmen. Por nga mesi i periudhës të parashikuar transporti Ro-Ro do të humbë përqindje në treg të malli i kontejnerizuar, e cila gjë do të provokojë uljen e koeficientit të rritjes për Ro-Ro.

Kontenierizuar Pasi qe u llogarit perqindja e volumit te mallit Ro-Ro, pjesa qe mbetet eshte e supozuar te jete e kontenierizueshme dhe eshte 80%. Per te nxjerre volumin e kontenjerve eshte aplikuar kurba e kontenjerizimit te malli i kontenjerzueshem.

Te pakontenierizuar Ne fund, afersisht si malli i impotuar, malli i pergjithshem LoLo i pakontenierizuar eshte llogaritur duke zbritur nga volumi total i mallit te pergjithshem ate te kontenjerizuar dhe te transportit RoRo.

Figure 3-15 Eksporti i ngarkesave LoLo te pakontenierizuara




3.3.3 Mallrat e thata refuxho

Importet

Per importet, dallimi behet midis importit te dritherave dhe importit te produkteve te tjera rifuxho.

Per importin e dritherave, Konsulenti ndoqi nje parashikim te paraqitur nga studimi i Planit te Transportit Kombetar per planin e mesem te veprimit, dhe 80% / 120% te ketyre vlerave i perkasin perkatesisht planit e ulet dhe te larte te veprimit. Ky studim u bazua mbi studimin e konsumit per njeri dhe mbi studimin e prodhimit kombetar ne Shqiperi. Grafiku i meposhtem paraqet rezultatet e parashikuara te perdorura per kete studim.

Figura 3-16 Parashikim mbi importet e drithit (mije ton)





Kategoria e produkteve të tjera është e përbërë kryesisht nga çimento dhe klinker. Parashikohet se me zhvillimin e fabrikës së çimentos, importi i çimentos dhe i klinkerit do të eliminohet. Me zhvillimet e planifikuara të fabrikave të çimentos pritet se do të ketë një rritje të kërkesës së qymyrgurit, e cila gjë do të provokoj rritjen e importit të qymyrgurit. Duhet përafërsisht 1 ton qymyrgur për çdo 3.5 ton çimento. Që të vendoset një kapacitet prodhimi baras me 2 x 1.5 milion ton, duhet importuar një volum vjetor qymyrguri baras me 850 ton që nga momenti që këto fabrika do të fillojnë të punojnë. Në bazë të këtij studimi është llogaritur se këto fabrika do të punojnë me kapacitet të plotë nga viti 2011 e tutje.

Eksportet

Burimet natyrore të Shqipërisë ofrojnë këto mundësi për eksportin e mallit rifuxho:

- krom, hekur-krom

Kromi është eksportuar nga Porti i Durrësit që me kohë. Pas kolapsit të viteve të fundit të viteve 1990s eksporti i kromit dhe i ferro-kromit zbriti në nivelet e viteve të para të 1990s. Për qëllimin e këtij projekti plani bazë i veprimit do të përcaktohet për një eksport vjetor prej 200 mijë ton. Plan i ulët i veprimit do të përcaktohet në gjysmën e kësaj vlerë, dhe plani i lartë i veprimit në 50% më shumë.

Ferro-nikel. Është raportuar se një kompani kineze ka firmosur një kontratë kohë të fundit (në mes të vitit 2007) për të eksportuar 400 mijë ton ferro-nikel nga Shqipëria në Kinë. Ky mall do të mbërrijë me tren në portin e Durrësit. Plan i ulët i veprimit Plan i ulët i veprimit do të përcaktohet në gjysmën e kësaj vlerë, dhe plani i lartë i veprimit në 50% më shumë,

- çimento dhe klinker

planet e raportuara të Konsulentit përfshijnë një eksport vjetor baras me 1 milion ton klinker për një uzinë, dhe 1 milion ton çimento për një uzinë tjetër. Plan i ulët i veprimit do të përcaktohet në gjysmën e kësaj vlerë, dhe plani i lartë i veprimit në 50% më shumë. Sipas projektit është përcaktuar se këto eksportime do të realizohen nga viti 2011 e tutje.


3.3.4 Skrap

Shqipëria ka një impiant celiku - Kurum steel - I cili ndodhet në Elbasan, rreth 70km nga porti i Durrësit, dhe është i lidhur me hekurudhë. Raportohet që për operimin e metalurgjikut kerkohet një input prej 300 mijë ton skrap, dhe që kjo kerkese do të rritet në 900 mijë ton nga 2011 e më tej.

3.3.5 Pasagjeret

Për trafikun e pasagjerëve, studimi i Planit të Transportit Kombëtar (2005) ka projektuar një rritje vjetore baras me 6.35%. Megjithatë, po të konsiderohen shifrat që nga viti 2000 tendenca ka qenë për ulje graduale të një niveli që është afërsisht 4.0% në vit. Prandaj Konsulenti sugjeron që rezultati i Planit të Transportit Kombëtar të vendoset si plan i lartë i veprimit, tendenca si plani i mesëm dhe plani i ulët i veprimit të jetë 2% në vit.

Figura 3-17 Mberritjet totale te pasagjereve dhe largimet (million pax)



Skenari I mesem ka parashikime gati dyfishimin e trafikut te pasagjereve deri ne 2 milion pasagjere deri ne fund te 2030. Kjo eshte pak a shume shifer me e ulet se sa ajo qe sherbeu si baze per planimetrine e terminalit te trageteve¹⁶.

3.4 Ngarkesat tranzit

3.4.1 Hyrje

Pervec parashikimit te ngarkesave te brendshme, eshte bere nje studim I ngarkesave te tranzitit per ne dhe nga shtetet fqinje. Eshte studiuar rrjeti rrugor dhe hekurudhor qe ndodhet midis portit dhe qendrave ekonomike me te rendesishme te rajonit me qellim qe te kryhet nje studim i konkurences se porteve dhe te behet nje vleresim i perqindjes qe porti i Durrësit mund te fitoj ne tregun e tranziteve te rajonit ne Ballkan.

Korridori VIII

Korridori VIII lidh rajonet e Adriatikut dhe te Jonit me rajonet ballkanike dhe shtetet e Detit te Zi dhe Ballkanit. Nga nje pikepamje ekonomike, me rrjetet tranz-Europiane, Komisioni European synon realizimin e nje hyrje teritoriale me te gjere per shtetet e BE-se, dhe ne kete menyre te mundesoje zhvillimin e qarkullimit te njerezve dhe mallrave sipas objektivave te Single Market (Tregut Unikal) dhe principeve te qarkullimit te durueshem. Nga nje pikpamje e transportit, Korridori 8 eshte nje sistem transporti multi-modal ne aksin Lindje-Perendim perfshire portet detare dhe lumore, aeroporte, porte multi-modale, sistemi rrugor dhe hekurudhor, me nje shtrirje prej 1270 kilometra hekurudhe dhe 960 km rrugore. Linja kryesore ndjek akset: Bari – Brindisi – Durrës - Tirana – Shkup – Burgas – Varna. Ka edhe disa degezime qe çojne ne Greqi dhe ne Turqi nepermjet korridorit 6.

¹⁶ Burimi: ky studim (i zbatuar nga BCEOM) parashikon nje trafik pasagjeresh prej rreth 1.3 milionesh ne 2015.



Figure 3-18 Korridori 8¹⁷

Linjat rrugore

Distanca midis porteve të ndryshme dhe tregjeve është tregues i mirë për vendndodhjen e portit kundrejt porteve konkurrense. Me faktorët e tjerë të njëjta për të gjithë, porti me distancën më të shkurtër prej tregut do të tërheqë pjesën më të madhe të trafikut që është paracaktuar për atë treg ose që është krijuar nga ai treg.

Largesia e porteve më të rëndësishme të rajonit me qendrat ekonomike më të rëndësishme të rajonit është matur dhe paraqitur në tabelën e mëposhtme. Qelizat e nënvizuara me të verdhë të errët tregojnë lidhjet më të rëndësishme. Qelizat e nënvizuara me të verdhë të hapur tregojnë alternativa interesante dhe qelizat e bardha tregojnë linjat më pak të rëndësishme.

Table 3-6 Distanca ndërmjet porteve dhe tregjeve të matura në km mbi rrugët

Portet	Tregjet			
	Shqiperi (Tirane)	FYR Maqedoni (Shkup)	Kosove (Prishtine)	Serbi (Beograd)
Durrës	40	320	355	710
Thesaloniki	375	225	310	635
Burgas	900	620	710	810
Varna	950	665	755	860
Bar	205	380	335	520

Nga tabela mund të kuptohet se në bazë të largësisë Tirana mund të konsiderohet një treg i rëndësishëm për portin e Durrësit meqenëse gjithë portet e tjera ndodhen 5 herë më larg.

¹⁷ Source: www.secretariat-corridor8.it

Per sa i perket qyteteve te tjera mund te cilesohet se, Selaniku ka vendndodhje te favorshme, ne fakt ai ndodhet ne largesine me te shkurter me tregun, pervec Beogradit, i cili ka me afer portin Bar, Mal i Zi.

Lidhjet me hekurudhat

Figura e meposhtme paraqet rrjetin hekurudhor te rajonit ballkanik. Jane matur largesite midis porteve dhe qendrave ekonomike duke u bazuar te kjo harte.



Figure 3-19 Harta rrugore dhe hekurudhore e Ballkanit

Jane matur largesite midis porteve dhe qendrave ekonomike dhe jane paraqitur ne tabelen e meposhtme.

Table 3-7 Distanca ndermjet porteve dhe tregjeve te matur ne km me hekurudhe

Treg Port	Tirana	Shkup	Prishtine
Durres	40 km me tren	120 km me tren 200 km rruge	120 km me tren 230 km rruge
Selanik	Ska lidhje te drejte me tren	225 me tren	310 me tren
Burgas	1315 km me tren	785 km me tren	700 km me tren
Varna	1360 km me tren	930 km me tren	745 km me tren



Bar	205 km me tren	715 km me tren	630 km me tren
-----	----------------	----------------	----------------

Shkupi ndodhet shume afer portit te Selanikut dhe mund te perfitoje nga nje lidhje direkte hekurudhore qe ndodhet midis qytetit dhe portit te Selanikut. Linja hekurudhore ndje pak a shume lidhjen rrugore midis ketyre te dyve dhe largesia eshte 225 km. Durresi eshte afersisht 100 km me larg prej Shkupit dhe duhet te parballet me konkurrencen e portit Bar per perqindjen ne treg.

Per Prishtinen, porti me i afert eshte Selaniku, megjithate porti i Durresit dhe Bar ndodhen pak a shume ne te njejten largesi. Selaniku ka vetem nje avantazh ne krahasim me portin Durres dhe Bar qe eshte lidhja direkte me tren. Ekziston nje lidhje hekurudhe midis Durresit, Barit (Mal i Zi) dhe Prishtines, por ajo merr nje drejtim te terthorte dhe kalon nga Cacaku dhe Kraljevi ne Serbi. Duhet kujtuar gjithashtu se nje lidhje hekurudhore behet konkurrencte e lidhjes rrugore kur largesite kalojne, lidhja rrugore do te behet me e rendesishme se linja hekurudhore. Praktikisht, konkurrencte midis ketyre porteve do te qendroje te cilesia aktuale e lidhjeve rrugore, perpunimi i mallrave ne port dhe trajtimi i mallit tranzit nga doganat ne shtetet e ndryshme.

Per Beogradin, Bar eshte porti me i afert, pas te cilit vjen Selaniku dhe Durresi. Pervec lidhjeve rrugore, porti Bar ka avantazhin se eshte nje kufi per tu kaluar, ndersa nga Selaniku jane minimumi 2 dhe nga Durresi, po ashtu jane dy per t'u kaluar.

Si rregull praktik, hekurudha perben konkurrencte per transportin rrugor te mallit te pergjithshem per largesi me te medha se 500 km. Largesia midis portit te Durresit dhe tregjet e shteteve fqinj (300 km – 400 km ne total) nuk justifikon transportin e mallit te pergjithshem me tren. Per kete arsye, Konsulenti supozon se ne rastin normal transporti i mallit tranzit ne shtetet fqinj duhet te kryhet me ane te rrjetit rrugor.

3.4.2 Perqindja e tregut portit te Durresit

Ne paragrafin e meparshem u trajtua largesia midis tregjeve dhe porteve konkurrencte. Nje model i perdorur shpesh per llogaritjen e perqindjes se tregut, bazohet ne lidhjet reciproke midis perqindjes se tregut dhe largesise me tregun:

$$MarketShare = \frac{\left(\frac{1}{d_j}\right)^6}{\sum_i \left(\frac{1}{d_i}\right)^6}$$

Ne te cilin:

di eshte largesia nga porti i caktuar per te llogaritur perqindjen ne treg

di eshte largesia nga nje port te tregu

i eshte numri i porteve

Kjo llogaritje ka mundesuar nje ndarje teorike te perqindjes ne treg si e paraqet tabela e meposhtme.

**Tabela 3-8 Perqindja e tregut te porteve te ndryshme**

Portet	Tregjet			
	Shqiperi (Tirana)	Maqedoni (Skopje)	Kosove (Pristina)	Serbi (Belgrado)
Durres	100%	11%	22%	10%
Selanik	0%	85%	48%	19%
Burgas	0%	0%	0%	5%
Varna	0%	0%	0%	3%
Bar	0%	4%	30%	63%

Duhet verejtur se ne kete grafik llogaritja e 10% te Durresit per Beogradin mund te jete me larte se ç'duhet. Gjithe malli i paracaktuar per Beogradin qe transportohet nga porti i Durresit duhet te transportohet me rruge ose me tren nga Podgorica, qe eshte vetem 50 km larg portit Bar, dhe nepermjet rruges qe shkon nga Bari (Mal i Zi) ne Beograd. Ne praktike pritet qe pervec vete Shqiperise tregjet me te rendesishme per Durresin jane Kosova dhe Maqedonia. Parashikimet e trafikut per keto dy tregje analizohen ne paragrafet e meposhtme.

3.4.3 Maqedonia

Ish Republika Jugosllave e Maqedonise ndodhet ne lindje te Shqiperise. Shkupi eshte Qendra ekonomike e shtetit dhe kryeqyteti, ndodhet 320 km larg Durresit, me te cilin lidhet me ane te rrjetit rrugor¹⁸. Ne vitin 2004 popullsia ishte baras me 2.5 milion bano¹⁹.r.

Per shkak te instabilitetit ne rajon gjate dhjetvjeçarit te fundit, GDP e Maqedonise e rreth 4 Miliard USD nuk eshte rritur gjate asaj periudhe. Per te ardhmen, Konsulenti propozon 3 plane veprimi per rritjen e GDP-se: +4.5% ne vit per planin e larte te veprimit, + 3.5% ne vit per planin e mesem te veprimit, dhe + 2.5% e vit per planin e ulet te veprimit.

Vlera FOB e importeve me Maqedonin²⁰ si funksion i GDP-se me nje koeficient lidhje (R^2) prej 0.89 eshte perdorur ne parashikimet e vleres se FOB te importeve totale net e ardhmen.

Per kete ngarkese, Porti i Durresit konkurren kryesisht me portin e Selanikut (ne veri te Greqise). Porti i Durresit nuk ndjek ne menyre te vecuar tregun e shteteve fqinj. Prandaj Konsulenti duhet t'i referohet te dhenave te mundesuara nga Departamenti Doganal per te llogaritur perqindjen e importeve totale qe kalojne nga porti i Durresit. Rezultatati eshte i paraqitur ketu poshte.

Tabela 3-9 Pesha e importeve totale te Maqedonise qe kalojne na Durresi

Viti	2004	2005	2006	2007
FOB i importeve totale ne Maqedoni	2,785	3,097	3,682	3,027
çmimi FOB i tregut maqedonas, qe kalon nepermjet Durresit (Lek)	1,043,3	3,398,3	5,794,1	3,851,7
Lek/USD	71	34	58	95
çmimi tregtar FOB i Maqedonise, qe kalon nga Durres (x milion USD)	99	97	93	89
	11	35	62	43

¹⁸ Ne pjesen e Maqedonis mungon nje lidhje prej 30 km per te kompletuar linjen hekurudhore midis Shkupit dhe Durresit.

¹⁹ Burimi: UNCTAD


²⁰ Burimi: Zyra Shteterore e Statistikave e Maqedonise



Perqindja e importit total te Maqedonis qe kalon nga Durrësi 0.4% 1.1% 1.7% 1.4%

Edhe pse po rritet, çmimi relativ i mallrave te importuar qe shkojne ne Maqedoni duke kaluar nga Durrësi, mbetet shume i ulet (maksimumi i verejtur eshte 1.7%). Duke ditur qe Shkupi perfaqeson zonen kryesore per importet e Maqedonise, Porti i Durrësit duhet te jete ne gjendje te fitoj 11% te importeve te Maqedonise (shih Seksionin 3.4.2). Si nje skenar me l ulet prej 5.5% eshte menduar dhe nje skenar l larte 16% eshte adoptuar. Meqenese ne Durrës po vazhdojne punet per permiresimin e portit, ateherë mendohet se porti i Durrësit do te arrije te fitoje nje perqindje gjithmone me te madhe te importeve te Maqedonise. Per me teper, per realizimin e mundshem te linjes hekurudhore direkte midis Durrësit dhe Shkupit (ndertimi i rreth 30km hekurudhe ne anen Maqedonase te kufirit), mund te miratohet nje plan i larte veprimi, ne te cilin Porti i Durrësit fiton me shume trafik tranziti se sa ishte llogaritur ne base te largesise. Me nje vlere mesatare prej 2264 USD/ton per importet e Maqedonise (bazuar ne te dhenat nga Dogana Shqiptare), volumi i importeve mund te percaktohet sic paraqitet ne Figuren 3-19 meposhte.

Figura 3-20 Tregtia transit me Maqedonine (mije ton)



Ashtu si me importet e Shqiperise, malli tranzit per Maqedoni supozohet qe te ndahet midis transportit RoRO (20%), dhe trafiku lo-lo te ndahet ne trafik te kontenjerizuar dhe te pakontenjerizuar (te njejtet koeficient si per importin).

3.4.4 Kosova


Kohet e fundit eshte shpallur pavaresia e Kosoves. Popullsia e kosoves ka nje lidhje te forte historike me popullsine e Shqiperise. Kosova nuk ka dalje ne det dhe ndodhet ne veri-lindje te Shqiperise. Kryeqyteti Prishtina lidhet me Shqiperine me ane te rrjetit rrugor, per te cilin nje project i rendesishem reabilitim eshte duke u zbatuar (perfundimi i caktuar rreth vitit 2010 – 2011). Ne vitin 2004 popullsia e Kosoves ishte rreth 2.9 milion banues²¹. Produktet kryesisht te importuara jane ushqimet dhe nafta.

²¹ Burimi: UNCTAD

Per shkak te trazirave gjate historise, GDP-ja shfaq shume çrregullsira gjate 15 viteve te fundit. Prandaj nuk eshte e mundur qe te formulohet nje parashikim i PBB-se te bazuar mbi nje studim te tendeces. Per qellimin qe ka ky studim, Konsulenti propozon 3 plane veprimi per evolucionin e PBB-se se Kosoves: +4.5% ne vit per planin e larte te veprimit, + 3.5% ne vit per planin e mesem te veprimit, dhe + 2.5% e vit per planin e ulet te veprimit –te aplikuar ne GDP-ne aktuale prej 1 milion USD.

Nderkohe per marredhenien e Maqedonise ndermjet vlerave FOB te importeve ne Kosove dhe GDP-ne bashke me rritjen e projektua te GDP-se eshte eshte perdorur per te vleresuar vleren e projektuar te FOB te importeve Kosovare²².

Figura 3-21 Vlera e parashikimit te importeve ne Kosove



Porti i Durrësit nuk ndjek ne menyre te veçuar tregun e shteteve fqinj – eshte i perfshire ne statistikat me volumin e pergjithshem te trafikut. Prandaj Konsulenti duhet ti referohet te dhenave te mundesuara nga Departamenti i Doganave.

Ne varesi te konkuresces qe perben linja Durrës-Shkup me linjat e tjera konkurrenente (kryesisht Selanik-Shkup), nje pjese e trafikut do te kaloj nga Porti i Durrësit. Tabela e meposhtme permbledh rezultatet kyçe te 4 viteve te fundit.

Tabela 3-10 Volumi I importeve totale te Kosoves qe do kalojne permes Durrësit

Viti	2004	2005	2006	2007
FOB e importeve totale me Kosoven (x 1000 Euro)	1,063,3	1,180,0	1,295,5	1,443,1
	47	22	58	29
vlera FOB e tregtise me kosoven, duke kaluar permes Durrësit (million Lek)	7,097	5,578	7,085	8,389
Lek/Euro	123	120	117	120
Vlera FOB e tregtise me Kosoven, qe kalojne nga Durrësi (x 1000 Euro)	57,854	46,380	60,484	70,070

²² Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave te Kosoves



Perqindja e importeve totale me kosoven qe kalojne nga Durrresi 5.4% 3.9% 4.7% 4.9%

Çmimi relativ i mallrave te importuar qe shkojne ne Kosove duke kaluar nga Durrresi, mbetet shume i ulet (maksimumi i verejtur eshte 5.4%). Duke ditur qe Prishtina perfaqeson zonen kryesore per importet e Kosoves, Porti i Durrësit duhet te jete ne gjendje te fitoj 22% te importeve te Kosoves (shif paragrafin 3.4.2).

Meqenese po vazhdojne punet per ndertimin e rruges qe lidhet me Prishtinen (mendohet se do perfundojne brenda pak vitesh), ashtu si po vazhdojne punet per permiresimin e portit, ateherë mendohet se porti i Durrësit do te arrije e fitoje nje perqindje gjithnje e me te madhe te importeve te Kosoves. Diagrama 3-21 paraqet 3 plane veprimi per penetrimin e portit te Durrësit ne tregun e Kosoves.

Figura 3-22 Perqindja e parashikuar e importeve te Kosoves nga Porti i Durrësit





Figure 3-23 Tregtia transit me Kosoven (mije ton)



Me një vlerë mesatare prej 1600 Euro/ton për tregun e tranzitit që kalon nga Shqipëria në Kosovë (e bazuar mbi të dhënat e zyres doganore të Shqipërisë), vëllimi i importit mund të përcaktohet ashtu si e tregon në Figuren 3-22.

Ashtu si me importet e Shqipërisë, malli tranzit për Kosovë supozohet që të ndahet midis transportit RoRo (20%) dhe LoLo (80%), dhe trafiku lo-lo të ndahet në trafik të kontenerizuar dhe të pakontenerizuar (të njëjtet koeficient si për importin).

3.5 Trafiku Ro-ro

3.5.1 Hyrje

Trafiku Ro-ro përfshin flukset kryesore të mëposhtme të trafikut:


- Ngarkesa dhe kamione / trailera
 - Kamione / trailera të përdorur për transportin e ngarkesave
 - Importi i kamioneve / trailerave
- Pasagjere dhe makina
 - Të përdorura për transportin e pasagjereve
 - Importin e makinave

Për të vlerësuar dhe projektuar numrin e automjeteve që do të përpunohen nga shërbimet e trageteve është performuar analiza e mëposhtme.

3.5.2 Kamione dhe trailera


Në seksionin e importeve të mallrave të përgjithshme projektimi për importet e ngarkesave të përgjithshme nëpërmjet ro-ro rezultoi në parashikimin e paraqitur në figuren 3-9. Kjo ngarkesë është importuar nëpërmjet kamioneve dhe trailerave. Ngarkesa mesatare historike për kamion është përcaktuar duke ndarë ngarkesën totale nga një numër kamionesh dhe trailerash që përdoren për transport. Duke vëzhguar trafikun e trageteve, mund të vërehet se numri i kamioneve të pashkarkuar i tejkalon ato të kamioneve të ngarkuar. Numri më i madh i kamioneve të shkarkuar se i atyre të ngarkuar për udhëtimin e kthimit supozohet si kamion importi. Trafiku i kamioneve të importit do të konsiderohet vecantazi nën titullin 'rolling stock'. Ngarkesa mesatare e vëzhguar për kamion ose trailer të përdorur për transport është 12 ton, duke dhënë importet e treguara në grafikun mëposhtë:

Figure 3-24 Trafiku kamion / trailer per importin e ngarkesave te pergjithshme (mije njesi)




Pervec trafikut te kamioneve dhe trailerave per transportin e mallrave te pergjithshme qe mberrijne me tragete, gjithashtu ka nje fluks hyres te kamioneve/trailerave qe mberrijne ne shqiperi per sektorin e transportit. Ky trafili vleresohet te jete diferenca ndermjet trafikut te hyres dhe dales te kamioneve / trailerave. Per te ardhmen, supozohet qe importi i kamioneve dhe trailerave do te ndjekoje GPD real te Shqiperise. Diagrama meposhte paraqet importet e vleresuara net e kaluaren (llogaritur si nje diference ndermjet numrit te kamioneve/trailerave te ngarkuar dhe shkarkuar), bashke me skenaret per te ardhmen (ritija e supozuar per te qene e barabarte me ritijen e GDP-se per skenaret respective).

Figura 3-25 Importi i kamioneve/trailerave (mije njesi)



Bashke me trafikun e perdorur per importet e ngarkesave te pergjithshme, njohja qe kamionet/trailerat e perdorur per importet ro-ro te ngarkesave te pergjithshme kthehen, kjo con ne nje parashikim trafikun kamion/trailer (mberritja * nisja, p.sh.kumulatibe per te dyja drejtimet) per importet e ngarkesave te pergjithshme sic paraqiten ne diagramen meposhte.

Figura 3-26 Totali i trafikut ro-ro te kamioneve per importin (mije njesi)




3.5.3 Makinat

Ashtu si trafiku I kamioneve, gjithashtu trafiku I makinave perbehet prej dy komponenteve me faktore te ndryshem nxitjeje:

- Makinat e perdorur nga njerez qe vizitojne Shqiperine, dhe kthehen mbrapsht (shih paragrafin 3.3.5)
- Importi I makinave (trafik vetem nje drejtim, n varesi te ekonomise Shqiptare)
Trafiku I makinave te perdorur nga vizitoret lidhet me numrin e vizitoreve nepermjet numrit te pasagjereve te tragateve per maikne te transportuar (numri aktual I pasagjereve per makine eshte me I ulet meqe ka gjithnje pasagjere qe nuk vijne me makine). Numri mesatar i pasagjereve per automjet bie dhe duket se arrin nje asimptote rreth 5.5 pax/automjet. Kjo vlere mbahet per te projektuar numrin e automjeteve bazuar ne trafikun e pasagjereve sic eshte percaktuar me pare.

Norma e rritjes per makinat e importit supozohet te jete e barabarte me normen e rritjes te GDP-se sic supozohet per skenaret respective. Per kete parashikim te makinave te perdorura qe arrijne dhe nisen nga terminali i tragateve, shtohet numri i projektuar i importit. Parashikimi total per mberritjen e makinave dhe nisjen e tyre tregohet ne Figuren Figura 3-27

Figura 3-27 Mberritjet dhe nisjet e makinave (mije njesi)





3.6 Anijet

Bazuar ne shifrat e tregetise dhe etrafikut, jane percaktuar dimensionet dhe she karakteristikat optimale te anijeve. Me poshte po japim dimensioned dhe karakteristikat optimale te anijeve;

- Karakteristikat (kapaciteti NRT,LOA, trau, thellesia e zhytjes) per anije maksimale dhe mesatare;
- Madhesia mesatare e pjeses
- Numri I anijeve

Kontenier Madhesia mesatare e pjeses (shuma e inportit dhe eksportit per anije) do te rritet afersisht 110TEU me fillimin e operimeve ne terminal (pranuar ne 2008) deri ne 382TEU ne 2030. Per te percaktuar madhesine koresponduese te anijes, eshte pranuar qe afersisht qe 1/6 e kapacitetit total te anijes te ngarkohet dhe 1/6 te shkarkohet. Kjo jep nje madhesi mesatare te anijes se kontainerave afersisht 330 TEU ne 2008 deri ne 1.300 TEU ne 2030. Numri I anijeve qe do te ankorohen ne 2008 do te jete 260 dhe 1.100 ne vitin 2030. Madhesia maksimale e anijes qe mund te jete eshte e kufizuar nga thellesia e maksimale e portit 10.5m e cila eshte percaktuar nga konfigurimi I portit.

Table 3-11 Specifikimet e anijeve per kontainer ne fillim te operimit. (2008)

	Kapaciteti [TEU]	Madhesia [TEU]	NRT	Loa [m]	B [m]	T [m]
Mesatare	330	110	2,400	100	20	6.5
Maksimale	1,700	550	9,500	200	29	10.5

Table 3-12 Specifikimet e anijeve per container ne vitin 2030

	Kapaciteti [TEU]	Madhesia [TEU]	NRT	Loa [m]	B [m]	T [m]
Mesatare	1,300	382	7.300	170	25	9.5
Maksimale	1,700	550	9.500	200	29	10.5

Klinker dhe Cimento Bazuar ne informacionin e siguruar nga investoret private potenciale madhesia mesatare e paketimit per anijet e klinkerit do te jete rreth 25,000t. Numri i anijeve do te jete rreth 80 ne vit.

Table 3-13 Vecorite kryesore te anijeve te Klinkerit

	Capacity [t]	Parcel size [t]	NRT	Loa [m]	B [m]	T [m]
Mesatare	20,000	20,000	7,000	157	23	9.2
Maksimale	30,000	30,000	10,000	180	26	10.5

Table 3-14 Vecorite kryesore te anijeve per Cimento

	Capacity [t]	Parcel size [t]	NRT	Loa [m]	B [m]	T [m]
Mesatare	6,500	6,500	2,280	115	17.5	7.1
Maksimale	17,000	17,000	6,500	180	23.5	10.4

Mineralet dhe qymyri Madhesite e anijeve per minerale dhe qymyr pritet te rriten kur te operojne kalatat per to. Kjo per shkak se ateherë do te importohet qymyr per prodhimin e cimentos dhe klinkerit.



Table 3-15 Karakteristikat e anijeve te mineralit dhe te qymyreve ne fillim te projektit.

	Kapaciteti [t]	Parcel size [t]	NRT	Loa [m]	B [m]	T [m]
Mesatare	13,000	10,000	4,000	135	20	8.2
Maksimale	30,000	30,000	10,000	180	26	10.5

Tabela 3-16 Karakteristikat e anijeve te mineralit dhe te qymyreve ne vitin 2030

	Kapaciteti [t]	Parcel size [t]	NRT	Loa [m]	B [m]	T [m]
Mesatare	25,000	20,000	7,000	165	24	10.0
Maksimale	30,000	30,000	10,000	180	26	10.5

Dritherat Madhesia mesatare e pjeses te anijeve te drithit pritet te jete rreth 4.000 deri ne 8.000 ton ne vitin 2030. Numri i anijeve qe do te prekin kalates pritet te jete 80-90 anije. Madhesia maksimale e anijes percaktohet nga konfigurimi i portit dhe nga kalata ku do te ankorohet anija sepse jot e gjitha kalatat kane te njejten kapacitet. Tabela e meposhteme percakton madhesime maksimale te anijes qe mund te hyje ne port llogaritur nga konfigurimi i portit.

Tabela 3-17 Karakteristikat e anijes se drithit ne fillim te projektit.

	Capaciteti [t]	Parcel size [t]	NRT	Loa [m]	B [m]	T [m]
Mesatare	5,500	4,000	1,800	100	16.0	6.5
Maksimale	30,000	30,000	10,000	180	26	10.5

Tabela 3-18 Karakteristikat e anijes se drithit ne vitin 2030.

	Capaciteti [t]	Parcel size [t]	NRT	Loa [m]	B [m]	T [m]
Mesatare	10,500	8,000	3,500	130	18.5	7.5
Maksimale	30,000	30,000	10,000	180	26	10.5

Ngarkesat e pergjithshme Mallrat e pergjitheshme transportohen me anije relativisht te vogla. Madhesia mesatare e pjeses eshte 1.500 ton. Madhesia mesatare e pjeses pritet te mbetet e njejte net e ardhmen: Numri mesatar i anijeve qe do te prekin kalaten do te shkoje nga 800 deri ne 1250 ne vitin 2030

Table 3-19 Karakteristikat e anijes per mallra te pergjitheshme

	Capacity [t]	Parcel size [t]	NRT	Loa [m]	B [m]	T [m]
Mesatare	2,000	1,500	660	80	12.4	4.5
Maksimale						

Kruizet Krocerat do te vijne kryesisht gjate periudhes se veres. Pritet qe te prekin kalaten rreth 20 anije. Kjo eshte dhene vetem nga nje pritshmeri por parashikimi i trafikut nuk eshte perfunduar akoma. Anijet do te sjellin rreth 600-800 pasagjere. Anijet kane nje gjatesi nga 100-170ml. Duhet theksuar se nuk ka nje lidhje ndermjet numrit te pasagjereve dhe madhesise se anijes. Tabela e meposhteme jep vetem nje tregues per karakteristikat e anijes qe pritet te vijje.



Table 3-20 Karakteristikat e anijes turistike (krocera)

	Kapaciteti[persons]	NRT	Loa [m]	B [m]	T [m]
Mesatare	700	9,000	130	23	5.5
Maksimale	800	10,000	170	29	7.0

Tragetet /Ro-RoTabela e meposhteme eshte bazuar nga raporti I Terminalit te Trageteve²³

Tabela 3-21 Vecorite kryesore te anijeve ro-ro

	Kapaciteti [persons]	GT	Loa [m]	B [m]	T [m]
Mesatare ²⁴	828	4,686	125.5	18.5	5.20
Maksimale ²⁵	1,000	31.785	178.9	25	6.06

²³ *Ndertimi i terminalit te trageteve dhe Infrastruktures se Oborrit te Portit te Durrësit; Raporti Final, 7 Janar 2003*

²⁴ Specifikime nga "Egitto Express"

²⁵ Specifikime nga "Norsea/Norsun", duke lundruar neper Mesdhe



4

STRATEGJI ALTERNATIVE ZHVILLIMI

4.1 Opsionet Alternative te Masterplanit

4.1.1 Hyrje dhe metodologji

Nje masterplan teknik eshte ne ngyre blu per zhvillimin e ardhshem te portit. Nje masterplan tregon elementet kryesore te infrastruktures se kerkuar operacionale, kur (fazimi) dhe ku (planimetria) duhet te zhvillohen ato. Nje masterplan i tille ka nje horizont kohor tipik prej 20 vjetesh, por duhet te rishikohet rregullisht cdo 5 vjet – me qellim qe te adaptoje ate kushteve ne ndryshim ne treg ose ne mjedis.

Nje masterplan ka disa objektive te tille si:

- Ai I siguron manaxhimit te portit nje kornize koherente per planifikimin e veprimeve afatshkurtra dhe afatmesme per te siguruar qe keto jane ne linje me zhvillimin afatgjate te portit.
- Ai e siguron manaxhimin e portit me nje plan k kundrejt te cilit kerkesat per facilitetet e portit mund te vleresohen
- Ai lejon qe ne nje faze te hershme te zbulohen kufizimet potenciale per zhvillimin e portit ne periudhe afatgjate
- Eshte nje mjet i dobishemk ne komunikimin me boten e jashtme (p.sh qytetin, qeverine, portet e tjera, institutetet financuese, linjat e transportit, operatoret portuale, etj.)
- Ai mbeshtetet ruajtjen ne fokus te zhvillimit afatgjate te portit.
-

Ne detyren aktuale Master Plani I Durrësit duhet te rishikohet dhe axhornohet. Ne vend qe te adaptojme planin ekzistues, me qellim qe te fitojme nje Master Plan koherent I cili eshet ne perputhje me evoluimet dhe pritjet me te fundit, Konsulenti formuloi masterplane alternative, te cilat sebashku me masterplanin ekzistues, kne evoluar ne baze te meritave dhe mangesive te tyre.

Keto alternativa jane formualuar ne baze te supozimeve te meposhtme:

- Kerkesa per sherbimet portuale sic tregohet ne parashikimin me trafikun
Parashikimi I trafikut perpunohet ne Kapitullin 3 te ketij raporti duhet te perpunohet.
- Infrastruktura e kerkuar e terminalit
Kerkesa per sherbimet portuale eshte baza per percaktimin e infrastruktures se kerkuar dhe per fazimin e planit te zhvillimit. Kerkesat jane llogaritur me ndihmen e rregulles se gishtit per planifikimin ne rast infrastrukture te re, ose ne baze te nje kontrolli per infrastrukturen ekzistues. Edhe pse opsionet e ndryshme jane zhvilluar per te njejtin trafik, kjo mund te coje ne zona te ndryshme ose gjatesi te ndryshme kalatash.²⁶
- Madhesia e Anijes

²⁶ Shembull. Infrastruktura aktuale thjesht mund te perputhet me nje maksimum minimal kerkesash (jo ideal) per perpunimin e nje ngarkese te caktuar, por aplikimi I praktikës se pergjithshme ne planifikimin portual do te conte ne dimensione te tjera (me te medha). Ne rast te tille Konsulenti ra dakort per planin e infrastruktures se re me dimensione te njejta me keto ekzistueset.



Masterplani është zhvilluar për një anije të dizenuar. Kjo është anija maksimale ndaj të cilës baseni aktual mund të bëhet konfrontuar me standardeve ndërkombëtare të sigurisë me një investim të arsyeshëm.

- **Terminalizimi**
Në kuadër të transformimit të portit të Durrësit në një port landlord (pronar tokë), koncepti i terminalizimit është aplikuar për formulimin e opsioneve të masterplanit. Kjo do të thotë që porti është ndarë në disa njësi fizike – terminale – që i janë dedikuar perpunimit dhe depozitimit të llojeve të vecanta të ngarkesave që janë të pershtatshme me njera-tjetren. Terminalët e identifikuar janë:
 - Terminali i kontenierëve
 - Terminali i ngarkesave të përgjithshme dhe i drithit
 - Terminali i trageteve dhe kruzeve
 - Terminali i mallit të thatë refuxho²⁷:
 - a. Eksporti i cimentos dhe klinkerit
 - b. Importi qymyrit dhe eksporti i mineraleve
 - c. Importi i skrapit
- **Projektet tashmë kanë filluar**
Disa projekte janë aktualisht në një fazë të avancuar të ekzekutimit – për shembull ndërtimi i terminalit të trageteve dhe rehabilitimi i kalatave 7/8. Këto projekte janë të përfshira në masterplan sic janë të planifikuara.
- **Supozimet në premisat aktuale portuale**
 - **Pronesia e tokës**
Për masterplanin teknik supozohet që Autoriteti Portual Durrës ka ose mund të përfitojë autoritet mbi tokën e treguar në opsionet e masterplanit.
 - Eshtë rialokuar terminali i karburanteve
 - Eshtë rialokuar porti i peshkimit
 - Rripi i tokës, i cili më parë ka qenë në pronësi të autoritetit hekurudhor, i transferohet portit
 - Kantieri detar është në dispozicion për infrastrukturën portuale
- **Qeratat aktuale të portit me paletë e treta supozohet se mbyllen nëse kjo kërkohej nga masterplani i ri.**

Pas perkufizimit të planeve alternative, një Analizë Multi Kriteriale ose një teknikë e ngjashme është parashikuar për vlerësimin krahasues të plan zhvillimeve alternative. Një element kyç në këto metode është perkufizimi i kriterëve në të cilëve bëhet vlerësimi i planeve. Këto kriterë përfshijnë tregues të tillë si kosto e investimit, fleksibiliteti, kapaciteti i perpunimit të ngarkesave, siguria detare, mundësia për zhvillimin në fazë, terheqja për investitorët private, përputhshmëria me qytetin / zhvillimin e turizmit, etj. Ky seksion ka për qëllim të mbështetë diskutimin mbi formulimin e kriterëve të tilla dhe alternativat për zhvillim

²⁷ Opsioni i kombinimit të cimentos dhe klinkerit është përzgjedhur pasi ato kërkojnë një infrastrukturë dhe instalime të ngjashme. Të dy produktet janë për eksport, kështu nuk kërkojnë asnjë instalim të rëndësishëm. Të dy produktet mund të transportohen lirisht nepermjet një pontili. Qymyri importohet, kështu që kërkon makineri të rëndësishme shkarkimi, duke bërë një kombinim me cimenton ose klinkerin. Nga ana tjetër, vinci i përdorur për shkarkimin e qymyrit mund të përdoret edhe për ngarkimin e mineraleve.



afatgjate special te portit te Durrësit. Ai paraqet disa alternativa se si porti mund te zhvillohet ne te ardhmen, bazuar ne zbulimet fillestare te Konsulentit. Lista e opsioneve te paraqitura nuk duhet e konsiderohet ne asnje menyre si kufizuese, dhe duhet te zgjerohet me opsione te tjera te bazuara ne diskutim me stakeholderat e portit.

4.1.2 Infrastruktura e kerkuar

Ne lidhje me infrastrukturen detare, vëzhgohet qe kufizimet e basenit aktual portual kufizojne anijen maksimale. Ne aneksin 3 te ketij raporti, kapaciteti I anijes maksimale qe mund te hyje ne port, vleresohet rreth 30 000 DWT ose 1700 TEU. Kjo madhesi eshte e kufizuar nga gjatesia e ndalimit e portit deri ne kalatat perendimore, me gjeresine e hyrjes se portit dhe me diameter te rrethit te kthimit. Gjatesite e ketyre anijeve jane brenda kufizimeve per ndalim dhe kthim brenda portit e cila percaktohet si 200m, dhe kerkon nje gjatesi kalate prej 240m.

Me tej infrastruktura e kerkuar operationale percaktohet ne baze te rregullave te pergjithshme te gishtit per normat e perpunimit dhe kerkesat e depozitimit (shi aneksin 3 te ketij raporti). Rezultati eshte qe infrastruktura e meposhtme baze eshte kerkuar per secilin nga terminalet e identifikuara:

- Terminali i ngarkesave te pergjithshme dhe drithit
 - Gjatesia e kerkuar e kalates: 600m – 900m
 - Depozitimi: ajer I hapur, magazine dhe kompleks sillosash (drith)
- Terminal konteniresh
 - Gjatesia e kerkuar e kalates: 600m
 - Sheshi I kerkuar: 15 – 25 hektar
- Terminal tragetesh dhe kruzesh
 - 8 kalata
 - Shesh parkimi: 5 - 10 hektare
- Terminal I mallit te thate te piste refuxho:
 - Minerale dhe qymyr
 - Gjatesia e kerkuar e kalates: 1 berth of 240m
 - Shesh per depozitim: about 2 hectares
 - Lidhja me hekurudhen
 - Cimento dhe klinker
 - Gjatesia e kerkuar e kalates: 1 berth of 240m
 - Sheshi per klinkerin dhe ose silosat e cimentos: rreth 3 hektare
 - Lidhja me hekurudhe
 - Skrap:
 - Gjatesia e kerkuar e kalates: 1 berth of 240 m
 - Shesh per depozitim: about 2 hectares
 - Lidhja me hekurudhe

4.1.3 Identifikimi I opsioneve

Vizatomet e plota per planet e zhvillimit jane te perfshira ne aneksin 1. te ketij raporti.



Tre opsionet baze jane zhvilluar²⁸:

- A. Planimetritë në të cilin ndodhet terminali I kontenierëve përgjatë skollës lindore
- B. Planimetritë në të cilin ndodhet terminali I kontenierëve ndodhet në kalatat perendimore (5-8)
- C. Planimetritë në të cilin ndodhet terminali I kontenierëve ndodhet në basenin e ri portual, në lindje të portit ekzistues – kjo në përputhje me masterplanin

Brenda 3 opsioneve, alternative të ndryshme janë gjeneruar. Seksionet e tjera japin një përshkrim për çdo alternative.

4.1.4 Opsioni A

Opsioni A karakterizohet nga lokalizimi i terminalit të kontenierëve në gjirin ekzistues në zonën lindore. Në mënyrë që të realizohet objekti duhet që vëllësi i jugor duhet të zgjerohet me 400 metra. Kokat e vëllësive duhet të hiqen që të mos pengojnë hyrjen dhe daljen e anijeve.

a. Alternativa A1

Terminali I Kontenierëve

Opsioni A. karakterizohet nga vendosja e terminalit në zonën lindore të limanit ekzistues. Në mënyrë që të krijohet thellësi e mjaftueshme në terminal duhet që zona të zgjerohet me tej. Një thellësi totale terminali prej 400 metra është në dispozicion. Moli mund të zgjatet deri në 870 metra ku ka 3 kalata 290 metra secila. Sipërfaqja e terminalit është me e madhe se për opsionin B dhe terminali I kontenierëve shtrihet në kalatat 5 dhe 7/8. Kjo sepse kur ndërton një terminal të ri, me thellësi 130 metra, sic është prapa terminalëve 5 dhe 7/8, nuk është e keshillueshme. Terminale me thellësi më të madhe lejojnë për një kohë me të gjatë qëndrimi, me shumë fleksibilitet për seleksionin e pajisjeve dhe transportimin e tyre horizontal sepse hapësira e sivimit do të jetë menjëherë pas kalatës. Për më tepër një hapësirë e mjaftueshme për lidhjen me hekurudhën.

Me tej, me shumë mundësi për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me kontenieret si aktivitetet logjistike të transportit, mbushjes dhe pastrimit dhe një zonë e lirë tregtie. Këto aktivitete mund të realizohen në një zonë të mëparshme depozitimi karburantesh.

²⁸ Pavarësisht se opsionet bazohen në të njëjtin parashikim mbi trafikun, vihen re ndryshimet në madhësinë e terminalëve (në sipërfaqe dhe/ose në gjatësinë e kalatës). Këto vijne si pasojë e vlerësimit të Keshilluesit mbi:

- Ekzistencën e mundshme të një hapësire që mund të përballonte trafikun e projektuar (ndoshta në kushte nën-optimale)

• Krijimin e një terminali të ri për të njëjtin trafik, në përputhje me kërkesat bashkekohore. Nëse konsideratat e planifikimit të portit tregojnë që një nivel i caktuar trafiku mund të përballohet me një kalatë ekzistuese, megjithatë jo në kushte ideale, ky opsion është përfshirë në alternativat e dhëna. Megjithatë nëse do të ndërtohet një terminal i ri, dizenjimi i tij do bazohet në parimet bashkekohore të planifikimit portual. Për shembull, në opsionin B terminali i kontenierëve shtrihet përgjatë vendit ankorimit ekzistues 5-8, me një thellësi rreth 150 m, e kombinuar me një oborr shtesë kontenieresh në zonën veriore të sipërfaqes së portit. Megjithatë kjo sipërfaqe është e mjaftueshme për të përballuar trafikun e projektuar, një terminal i ri kontenieresh i dizenuar për të njëjtin trafik duhet të ketë një hapësirë më të madhe të disponueshme për të lejuar operacione më efikente.



Pritet qe nje material i mjaftueshem mbushes te behet i disponueshem nga punet e thellimit te kanalit dhe basenit te portit. Duke perdorur kete material per korrigjimin e terminalit te ri te konteniereve, do te perftohet nje perfitima maksima nga materiali i thelluar. Nese kjo alternative do te perzgjidhet si opsioni I preferuar, mund te percaktohen nje thellesi optimale ne terminal.

Mallrat e paambalazhuara te thata dhe te pista

Ne kalatat 5, 6 dhe 7/8, ka mallra te paambalazhuara te thata dhe te pista. Ne keto kalata perpunohen minerale, qymyr, cemento dhe zhir (klinker). Gjatesia totale ne dispozicion e kalates do te jete afersisht 720m. Nje disavantazh e kesaj vendodhje eshte prania e qytetit ne terminal. Ererat me te forta fryjne nga drejtimi jugor duke shkatuar pluhur gjate ngarkimit dhe shkarkimit te mallit te thate refuxho. Per me teper, terheqja e zhvillimit te cdo turizmi ose aktivite lundrimi (krocere) do te reduktohet nga prezenca e nje terminali me mallrat e thata dhe te pista refuxho te cilat jane afer qytetit.

Mundesisht, facilitetet per importimin e skrapit mund te perfshihen ne keto kalata.

Ngarkese e pergjithshme jo e kontenierizuar


Ngarkesa e pergjithshme jo e kontenirizuar do te mbetet ne kalaten 1 deri 4. Gjatesia totale e kalates do te jete 480m. Kalata 1 do te jete nje terminal I kombinuar Ngarkese e Pergjithshme /Terminal dritherash. Terminali I dritherave ndodhet sa me lart te jete e mundur nga terminali I mallrave te thata te pista me qellim qe te reduktohe risku I ndotjes se mallrave te pista te thata.

Tragetet dhe facilitetet Ro-Ro

Tragetet dhe facilitetet Ro-Ro mbeten ne vendodhjen e tyre aktuale dmth ne kalaten 9. Ne kete plan ka mundesi zgjerimi te prashikuara ne zonen qe aktualisht perdoret nga Kurrumi.



Figura 4-1 Alternativa A1






b. Alternativa A2

Alternativa A2 është pothuajse e njëjte me Alternativen A1, me përjashtim të mallrave refuxho të pista të thata. Në këtë alternativë, mallrat e thata refuxho vendosen jashtë portit të Durrësit. Prej kësaj zgjidhen problemet e pluhurit për qytetin e Durrësit të shkaktuara nga mallrat refuxho të pistadhe krijohet mundësi për zhvillimin bregdetar, turizmin dhe kruzet (udhëtimet turistike).

Figure 4-2 Alternativa A2





4.1.5 Opsioni B

Opsioni B karakterizohet nga vendodhja e terminalit të konteniereve përgjate kalatave 5, 6 dhe 7/8. Në këtë mënyrë, prej kësaj nderhyrje me operacionet ekzistuese në port mbahet në minimum. Përballimi i ngarkesave të thata të anijeve është planifikuar në hapësirën aktuale të kantiereve detare dhe përgjate vlerësimit lindor²⁹

a. Alternative B1

Terminali i Konteniereve

Në opsionin B terminali i konteniereve zhvillohet përgjate kalatave 5, 6 dhe 7/8 dhe prapa kalatës 4. Gjatesia totale e kalatës së konteniereve do të jetë përafërsisht 720m. Terminali ka një thellësi mesatare prej 130m e cila është e vogël për një terminal kontenieresh. Për shkak të thellësisë së kufizuar të terminalit, jo të gjithë kontenieret mund të stivohen direkt prapa platformës. Prandaj, hapësira shtesë e depozitimit zhvillohet prapa kalatës 4 pranë zonës së Kurrumit. Zona ngjitur me Kurrumin aktualisht është përdorur për depozitimin e konteniereve bosh. Mundësi të mjaftueshme zgjerimi janë të disponueshme për këtë zonë depozitimi nëse kërkohej.

Ngarkesa e Përgjithshme e Pa-Kontenierizuar

Ngarkesa e përgjithshme e pa-kontenierizuar do të mbetet në kalatat 1-4 dhe kjo është e njëjtë si për opsionin A.

Tragetet dhe facilitetet Ro Ro

Tragetet dhe facilitetet Ro-Ro mbeten në vendodhjen ekzistuese në kalatën 9. Në këtë plan, mundësitë e zgjerimit janë parashikuar në zonën e Kurrumit.

Mallrat e thata dhe të pista refuxho

Në kalatën 10 dhe 11 do të transferohen mineralet dhe qymyri. Kjo është në koherencë me planet e autoriteteve portuale të levizjes dhe transferimit të mineraleve dhe qymyrit nga kalatat 7/8 në kalatën 10/11.

Për më tepër ka një mundësi për krijimin e një kalate shtesë përgjate zonës së Kantiereve, i cili supozohet që do të largohet.

Pranë kalatave 10/11, parashikohet një kalatë e re dhe një zonë terminali. Ky terminal parashikohet në vendodhjen e pontilit i cili do të largohet. Ky terminal i ri planifikohet për eksportin e klinkerit dhe cimentos. Një gjatësi totale e kalatës prej 240m do të realizohet me një thellësi terminali prej 125m. Ka një mundësi lidhëje me hekurudhën nëse kjo do të kërkohej.

²⁹ Thellessia e kalatës së propozuar përgjate vlerësimit lindor është 400m, ndërsa është 275m me shumë se ç'është treguar në Raportin Paraprak. Thelrimi i kalatës ekzistuese dhe të propozuar përgjate vlerësimit lindor rekomandohet sepse:

- Kjo i krijon një zgjerim hapësirës së kufizuar të zonës portuale
- Sasia e kërkuar e materialeve mbushëse do të jetë e disponueshme nga punimet të kryera pa kosto ose me kosto minimale shtesë
- Thelrimi me 400m i siguron portit fleksibilitet për të shndërruar këtë pjesë të tij në një terminal kontenieresh, nëse në një fazë të mëvonshme ngarkesat e thata do të hiqen nga porti i Durrësit (për t'u vlerësuar në një studim mbi strategjinë portuale kombëtare)



Dritherat


Ne zgjerimin e kalates 12, nje kalate e re (kalata 13) planifikohet me nje terminal ngjitur. Ky terminal planifikohet per importin e dritherave. Gjatesia e kalates eshte 240m me nje thellesi terminali prej 125 m.

Kruizet

Facilitetet e kruizeve ndodhen ne kalaten 4. Kalata 4 ndodhet prane qytetit dhe siguron nje lidhje direkte me pjesen e vjeter te qytetit. Nje ure kembesoresh mbi sheshin e konteniereve te stivuar do te siguroje hyrjen e kembesoreve ne qytet. Terminali gjithashtu do te jete i hyrshem per furnizimet e e rruges, etj.



Figura 4-3 Alternativa B1





b. Alternativa B2

Ndryshimi ndermjet alternatives B1 dhe B2 eshte vendodhja e terminalit te dritherave dhe vendodhja e faciliteteve te udhetimeve turistike (kruizeve).

Dritherat

Ne kete alternative, dritherat do te jene nje terminal i kombinuar ne kalaten 4 me terminalin me ngarkese te pergjithshme. Duke marre ne considerate shifrat relativisht te ulta te hyrjes se dritherave, eshte e justifikueshme per te kombinuar dritherat me nje mall tjeter. Gjatesia e disponueshme e kalates per dritherat eshte perreth 174m. Nje gjeresi kalate rreth 40m eshte e mjaftueshme per shkarkimin e anijeve. Per ngarkesen e pergjithshme te perpunuar ne kalaten 4, ngarkesa do te ngarkohet direkt ne kamione, ose te stivohet ne zonen prapa kalates 3.

Kruizet


Kruizet do te vendosen ngjitur me terminalin e trageteve pergjate kalates 7/8. Do te kete nje corridor ndermjet terminalit te trageteve dhe terminalit te konteniereve per pasagjeret e anijeve te udhetimeve turistike. Pergjate kalates do te vendosen vetem facilitate te vogla ndihmese.

Mallrat rifuxho te thata te pista

Ndersa ne alternativen e meparshme kalata 13 planifikohej per dritherat, ne kete alternative kjo kalate planifikohet si nje zgjerim opsional per facilitetet e mallrave te thata te pista refuxho.



Figura 4-4 Alternativa B2





c. Alternativa B3

Ndërsa në Alternativen B2, dritherat u kombinuan me një ngarkesë të përgjithshme, në këtë alternativë dritherat do të kombinohen me udhëtimin turistik. Për më tepër, është parashikuar një zgjerim shtesë i faciliteteve të mallrave të thata të pista.

Dritherat / Kruizet


Dritherat dhe kruizet do të kombinohen në kalatën 4. Të dy aktivitetet kërkojnë një zonë të kufizuar terminali dhe vetëm një numër i kufizuar anijesh do të priten në çdo vit. Kur përmiresojmë metodën e përpunimit të dritherave nga kanxhat në pneumatike, përpunimi i dritherave do të jetë operacion relativisht i pastër i cili rezulton në ndotje të vogël ose në mosndotje të platformës. Kjo është e rëndësishme për aktivitetet e udhëtimeve turistike pasi pasagjerët nuk do të pelqejnë të kalojnë përmes një platforme të pisët.

Mallrat rifuxho të thata të pista

Mallrat rifuxho të thata të pista (mineralet, qymyri, zhira, dhe çimento) planifikohen në kalatat 10, 11, dhe 12. Ka një zgjerim opsional për Mallrat rifuxho të thata të pista duke zgjeruar kalatën 12 me 24m (Kalata 13) ose duke krijuar një mol gisht në zonë aktuale të përdorur nga Kurrum. Me realizimin e molit gisht krijohen dy kalata shtesë ku në alternativën e mëparshme një kalatë realizohet në zonën e Kurrumit. Kështu, një total prej 6 kalatash për mallrat e thata rifuxho të pista. Disavantazhi i molit gisht është që zona për terminalin e trageteve do të jetë i kufizuar dhe zona e manovrimit të trageteve do të jetë e kufizuar.



Figura 4-5 Alternativa B3






d. Alternativa B4

Alternativa B4 është një kombinim i Alternativës B2 dhe B3. Plani i shtrirjes së faciliteteve të mallrave rifuxho të thata të pista është i njëjti me planin e prezantuar në Alternativen B2, ku plani i faciliteteve të tjera është i njëjti me planin e paraqitur në Alternativen B3.



Figura 4-6 Alternativa B4





4.1.6 Opsioni C

Ne opsionin C do te krijohet nje basen I ri porti ne lindje te portit actual. Duke krijuar nje basen te ri, ka mundesi per pritjen e anijeve me te medha. Duhet te verehet qe per shkak te ndertimit te nje baseni te ri, skoliera do te zgjerohet dhe kanali duhet te rindertohet. Keto jane kosto shtese qe nuk kerkohen ne dy opsionet e meparshme.

a. Alternativa C1

Terminali Konteniereve

Terminali konteniereve do te realizohet ne basenin e ri portual. Baseni do te kete nje gjeresi prej 650m I cili eshte I mjaftueshem per kthimin e anijeve Panamax. Do te kete dy kalata secila me 300m e cila eshte e mjaftueshme per perpunimin e anijeve Panamax. Gjatesia totale do te jete 600m me nje zgjerim opsional prej 900m. Thellesia e terminalit do te jete 400m. Terminali do te ndertohet me materialin e perftuar nga thellimi nga baseni dhe kanali.

Ngarkesa e Pergjithshme

Ngarkesa e pergjithshme do te largohet nga kalatat 1, 2 dhe 3 deri ne anen fundore te basenit te ri. Nje gjatesi totale e kalates prej 1,000m perfshihet ne plan. Megjithate, kjo gjatesi mund te adoptohet komform kerkeses se tregut. Nje kalate per ngarkesat e pergjithshme gjithashtu do te perdoret si terminal per importin e dritherave.

Mallrat rifuxho te thata te pista

Mallrat rifuxho te thata te pista do te vendosen pergjate kalatave 10 dhe 11 me cemento dhe zhir ne kalaten e re 12. Mundesite shtese te zgjerimit perfshihen ne zonen e Kurrumit ne linje me kalaten 12 (kalata e re 13).

Tragetit dhe terminali Ro-Ro

Facilietet e tragetit dhe faciliteteve Ro-Ro mbeten ne kushtet aktuale dmth ne kalaten 9. Ne kete plan ka mundesi zgjerimi te parashikuara ne zonen aktualisht te perdorur nga Kurrum.

Kruizet / Turizmi

Pergjate kalatave 1 deri ne kalaten 7 mund te realizohen zhvillime buze detit. Kjo zone eshte ngjitur me qytetin dhe kane nje lidhje te drejteperdrejte me te.



Figure 4-7 Alternativa C1





b. Alternativa C2

Ndryshimi ndermjet Alternatives C1 dhe Alternatives C2 eshte gjeresia e basenit te ri te portit. Ndersa ne alternativen C1 gjeresia ishte 650m, ne kete opsion, gjeresia eshte reduktuar ne 350m. Prandaj anijet mbi gjatesine afersisht 150m kthehen jashte basenit afer hyrjes. Kjo ka nje ndikim te rendesishem ne operacionet portuale ndersa porti do te bllokohet gjate kthimit te nje anije. Avantazhi ne raport me C1 eshte qe gjatesia e nje skoliere te re eshte me e vogel dhe do te kete me pak pune thellimi. Duke reduktuar gjeresine e basenit, ngarkesa e pergjithshme tashme do te lokalizohet kundrejt terminalit te konteniereve dhe nuk do te kete asnje kalate ne dispozicion ne fund te basenit.



Figura 4-8 Alternativa C2





4.2 Analiza multi-kriteriale

4.2.1 Hyrje dhe metodologjia

Nje analize multi-kriteriale (MCA) eshte nje mjet i dobishem per krahasimin e alternativave ne baze te kriterëve te nje natyre mjaft heterogjene, si ne rastin e perzgjedhjes se opsionit te zhvillimit te preferuar per Portin e Durrësit. Supozimet baze per nje analize te tille multikriteriale jane:

- Kriteret pergjate te cileve vleresohet performance e alternativave
- Faktoret peshe, qe tregojne rendesine relative te treguesve te ndryshem te perzgjedhur

Edhe pse eshte nje mjet i dobishem, duhet te mbahet ne mend se realizimi i nje MCA nuk eshte nje process shkencor dhe nuk synohet te jete i tille. Qellimi i tij eshte te beje vleresimin dhe nje process vendimmarrje transparent dhe te promovojë komunikimin ndermjet biznesit te ndryshem ne procesin e vendimmarrjes.

Kriteret

Konsulenti propozon te vleresojë planet alternative pergjate kriterëve ne 6 kriteret kryesore:

1. Ceshtjet e planifikimit portual
2. Lehtesia e implementimit
3. Ceshtje operacionale
4. Ndikimet ne mjedis
5. Investimet e kerkuara
6. Performanca ekonomike

Piket

Per kriteret alternativat do te krahasohen me njera tjetren. Alternativa me performancen me te mire do te marre piket me te medha. Keto pike jane nga 1 ne 5.

Perdorimi i faktoreve peshe

Per te lejuar ndryshimin relativ pe kriteret e ndryshme te perdorura ne analize, nje faktore peshe mund ti atribuohet kriterëve kryesore. Percaktimi i faktoreve peshe eshte nje zgjedhje politike me shume se sa nje ceshtje teknike – kjo varet nga prioritetet e politikave, psh. Ne industrine e minierave, ne krijimin e nje zone urbane te qete, ose ne kushtimin e vemendjes ndaj sherbimit te tregtise tranzite te shteteve fqinje.

Per studimin aktual, Konsulenti nuk aplikon asnje faktor peshe - kjo do te thote qe supozohet qe te gjashte kriteret kryesore mund te luajne nje rol njelloj te rendesishem ne vendimin nese te perzgjidhet apo jo nje alternative e caktuar. Sapo opsioni i preferuar perzgjidhet ne kete menyre, efekti i aplikimit te faktoreve peshe verifikohet.

4.2.2 Vleresimi krahasues i planeve alternative

Nje vleresim i detajuar krahasues te tete alternativave te ndryshme eshte kryer, qe do te thote nje analize shume kritereshe³⁰ – rezultatet e detajuara te analizave jane te perfshira ne aneksin

³⁰ Kjo analize shume kritereshe ishte nje proces i perseritur, gjate te cilit vleresimet me pike u pershtaten sipas diskutimeve te ndryshme te mbajtura me Klientin dhe me pale te tjera te interesit te projektit. Per kete arsye vleresimi me pike i prezantuar ne tabelat e mesiperme ndryshon nga ai i prezantuar ne raportin paraprak te 6 muajve me pare. Eshte e rendesishme te njihet qe nje MCA nuk duhet konsideruar si nje



4. Rezultatet me te rendesishme per cdo kriter kryesor I perdorur ne vleresim eshte paraqitur si meposhte:

1. Ceshtjet e planifikimit portual

Alternativa B2 ka piket me te medha pasi siguron fleksibilitet, lejon nje zhvillim me faza dhe mund te implementohet ndersa operacionet ne port vazhdojne. Shume e rendesishme eshte qe vetem ne opsionin B I gjithe trafiku I parashikuar perpunohet brenda basenit aktual, duke maksimizuar keshtu duke maksimizuar perdorimin e infrastructures aktuale. Opsioni 1 ka piket me te ulta, kryesisht pasi vendodhja e terminalit te mallrave te thata refuxho eshte ngjitur me qytetin.

2. Implementimi

Opsioni B do te zhvillohen brenda planit ekzistues portual. Keto alternative jane lehtesisht te zhvillueshme ne faza dhe per kete arsye vendimi per nisjen e zhvillimit do te jete shume me I lehte se sa ne opsionet e tjera (A dhe C). Opsioni B1 dhe B2 kane piket me te ulta per shkak te zonave te dedikuara respektivisht te terminalit te dritherave dhe bankines se mallrave te pista te thata refuxho te cilat kerkojne nje vendim I cili do te kete pasoja financiare dhe operacionale per portin.

Opsioni B3 gjithashtu merr pike te ulta, pasi nuk parashikon ndonje mundesi zgjerimi per terminalin e trageteve (zona e peshkimit I eshte caktuar mallrave te thata refuxho). Opsionet B2 dhe B4 parashikojne ne nje mundesi zgjerimi per zonen e mallrave te thata refuxho ngjitur me skolieren lindore. Perdorimi I kesaj zone eshte e nderkembyeshme me zonen e kantierit aktual detar, dhe per kete arsye kjo ofron nje menyre daljeje ne rast se ka ndonje kufizim qe mund te ndalojne perdorimin e kesaj zone per aktivitetet portuale.

3. Ceshtje operacionale

Kjo I referohet ceshtjeve qe mund te influencojne ne eficensen operacionale te portit – psh. eficensen e perpunimit te ngarkesave pergjate kalates dhe ne magazine. Sipas ketij kriteri alternative B ka piket me te ulta- kjo per shkak te thellesise shume te kufizuar te terminalit te konteniereve, qe mund te kerkojne depozitimin e perkohshem te konteniereve ne nje shesh te mbingarkuar me konteniere, I cili ndodhet ne port por ka nje distance te caktuar nga terminali I konteniereve. Alternativa C parashikon zhvillimin e nje terminali te ri kontenieresh, i dizenuar ne perputhje me udhezimet e planifikimit te terminaleve moderne te konteniereve. Alternativa C keshtu preferohet nga pikepamja operacionale.

4. Ndikimet mjedisore

Opsioni B eshte zhvilluar brenda basenit aktual, dhe aktivitetet ndertimore keshtu jane te kufizuara ne krahasim me alternativen A2 ose opsionet C. Alternativa A1 nuk eshte e preferuar nga nje pikepamje mjedisore per shkak te vendodhjes se terminalit te mallrave te thata refuxho menjehere prane qendres se qytetit.

proces i ngurte ose shkencor – rezultati i vleresimi duhet perdorur vetem si nje udhezues drej alternatives se preferuar.



5. Investimet

Opsioni B perdor basenin aktual, keshtu qe kerkon investimet me te ulta. Opsioni A2, me ndertimin e nje porti te ri per perpunimin e mallrave te thata refuxho vleresohet afersisht te jete 150 - 250 milion euro me I shtrenjte (ne varesi te kushteve te sheshit). Opsioni C2, qe perfshin ndertimin e nje baseni te dyte, vleresohet te kushtojte afersisht 100 milion Euro me teper se opsion B. Ndermjet te kater alternativave te opsionit B, alternativat B2 dhe B4 performojne me mire pasi ato nuk kerkojne ndertimin e kalates 13 (fundi I skoliresh lindore) per te perpunuar trafikun e projektuar.

6. Performanca ekonomike

Ky kriter I referohet distances ndermjet alternativave te ndryshme ne kostot dhe perfitimet ne ekonomine kombetare. Ana e koston konsiston ne investimet, kostot operacionale dhe mirembajtjen, dhe koston oportune te tokes se perdorur. Duke marre parasysh qe kostot operacionale nuk jane shume te ndryshme, dhe duke supozuar qe kerkesa e projektuar eshte permbushur, parametri kryesor dallues eshte kosto e investimit per secilen nga alternativat. Kjo eshte me e ulte per opsionin B2 dhe B4. Aneksi 7 ne raportin aktual permban vleresimin ekonomik per opsionin B2, duke konfirmuar fizibilitetin ekonomik te ketij opsioni.

Tabela e meposhtme paraqet piket e atribuara secilave nga alternativat per secilin nga kriteret kryesore te perdorura per vleresimin krahasues.

Tabela 4-1 Rezultatet e Analizes Multikriteriale Kriteret Kryesore³¹

Opsioni Kriteret Kryesore Alternativa	A		B				C	
	A1	A2	B1	B2	B3	B4	C1	C2
Planifikimi I Portit	1.8	2.7	2.9	3.6	3.4	3.4	3.4	2.9
Implementimi	2.4	2.4	3.6	4.8	3.6	4.8	1.2	1.2
Operacional	3.2	3.9	2.1	1.8	1.8	1.8	4.7	4.7
Mjedisor/social	2.2	3.8	3.2	3.5	2.7	2.7	3.0	3.0
Investimet	3.0	1.9	3.5	3.8	3.5	3.8	2.2	2.2
Performanca ekonomike	2.5	2.8	2.8	3.4	3.4	3.4	2.8	2.8
Totali Kryesor	15.1	17.5	18.2	20.9	18.4	19.9	17.2	16.7

4.3 Alternativa e preferuar e zhvillimit te Portit

Rezultati I pergjithshem I MCA-se te alternativave te paraqitura ne paragrafet e meparshem eshte qe Alternativa B2 eshte e preferuara ne baze te kriterëve te perzgjedhura, Konsulenti rekomandon alternativën B2 si masterplanin teknik per Portin e Durrësit.

Bazuar ne intervistat me biznesin, plotesuar me veshgimet personale te Konsulentit ne Durrës dhe ne eksperiencen me porte te ngjashme, mund te deklarohet qe vendodhja aktuale e portit, praktikisht ne me te qytetit te vjeter te Durrësit nuk eshte ideale. Sigurisht perpunimi I

³¹ Jeshile = alternativa me e mire performuese per ate kriter
E Kuqe = alternativa me e keqe performuese per ate kriter
Portokalli = Performim I ndermjetem



ngarkesave te mallrave refuxho paraqet nje sfide per qytetin e Durrësit. Nga ana tjetër, keto ngarkesa perbejne pjesen me te madhe te eksporteve Shqiptare dhe keshtu jane te rendesishme per ekonomine kombetare. Konsulenti ka mendimin qe porti duhet ti pergjigjet kerkeses per facilitete qe perpunojne mallrat e thata refuxho ne periudhe afatshkurter si dhe ne periudhe afatgjate.

Nese do te kishim ne dispozicion fonde te pakufizuara, do te ishte e lehte te rekomandonim qe nje port I ri me lidhje me brendesine e vendit te ndertohet jahte Durrësit, dhe ky I fundit te transformohet ne nje port turistik. Por per kete nuk ka fonde dhe duhet te gjendet nje kompromis. Konsulenti eshte i bindur se Alternativa B2 paraqet nje pergjigje adekuat e cila balancon kerkesat nga Biznesi.

Pikat e forta te B2 jane:

- Eshte relativisht I lehte per tu implementuar, duke I lejuar portit ti pergjigjet kerkesave te tregut
- Perpunon te gjithe trafikun e projektuar ne te ardhmen, dhe le vend per trafike te tjera te paidenfikuara ende
- Ben perdorimin me te mire te basenit aktual te portit
- Ky plan lejon nje kalim tek A2-shi nese nje studim kombetar (qe ende duhet te kryhet) kerkon nje vendodhje tjetër per zhvillimin e nje porti per mallrat refuxho. Ne kete rast, kalatat e caktuara mallrave refuxho prej alternatives B2, do te ktheheshin ne kalata kontenieresh, dhe terminali I kontenierëve ne B2 mund te ri-zhvillohet per aktivitetet e lidhura me turizmin.

Dobesite kryesore per alternativën e perzgjedhur B2 jane qe:

- Madhesia maksimale e anijeve eshte kufizuar ne 30 000 DWT per anijet e mallrave refuxho / 1700 TEU anijet e kontenierëve per shkak te zones se kufizuar te basenit aktual te portit. Nese do te planifikohej nje basen I ri per portin, kjo do te dizenohej per anije me te medha, duke shkurtur keshtu kostot e transportit detar.
- Plani nuk parashikon potencialin per zgjerim te metejshej per teq horizontit te masteplanit. Kjo eshte bere me qellim. Ne kuader te dobesive te lidhura me vendodhjen aktuale te portit, Konsulenti ka mendimin qe deri sa te kemi nje strategji portuale te nje niveli me te larte qe do te tregojte nje rezultat tjetër, nuk do te ishte e rekomandueshme per te projektuar asnje project zhvillim portual te nje shkalle te gjere ne kete fushe.

Nje risk I vecante per implementimin e ketij masterplani eshte qe zona aktualisht e okupuar nga kantieri nuk do te jete ne dispozicion te portit per aktivitetet e lidhura me te brenda vitit te ardhshem. Kjo do te thote qe ndertimi I terminalit te klinkerit dhe cimentos duhe te shtyhet. Nese ky rrezik materializohet, atehere do te ishte e mundur te zhvilloheshin keto terminale ne kalaten 13, dhe te mbahet vendodhja e pontilit te projektuar dhe kantierit si nje mundesi zgjerimi ne te ardhmen per perpunimin e ngarkesave te mallrave te thata refuxho. Disavantazhi i kesaj mase eshte qe mundesia e zgjerimit te ketij porti eshte I vlefshem vetem per keto ngarkesa – kjo eshte ne contrast me masterplanin I cili mund te lejoje perpunimin e kontenierëve te kalates 13 si nje zgjerim I mundshem.



4.4 Strategjite alternative te Biznesit

4.4.1 Arranxhimet PPP dhe filozofia

Kontraktimi PPP ofron nje shkalle te madhe arranxhimesh kontraktuale, secila me nje qellim te ndryshem, pergjegjesi, risqe dhe detyrime. Keto arranxhime prodhojne nje proces gradual te kalimit te pergjegjesive nga Autoritetet Publike Akorduese tek partneri privat.

Forma me e thjeshte e nje arranxhimi PPP eshte nje Kontrate Sherbimi ose nje kontrate operuese/manaxhuese. Ne kete marreveshje te thjeshte, sektori privat caktohet per te kryer nje sherbim specific kundrejt nje pagese nga Autoriteti; kjo gjithashtu kerkon zero ose pak fonde nga investimet private dhe ndarja e riskut

Pjesa tjeter e kontratave PPP eshte privatizimi i pastër i infrastructures, me kontroll te limituar te Autoriteteve Publike ne dizeno dhe levrim, kryesisht e lidhur me sjelljen e monitorimit te tregut te operatoreve private dhe veprimi si rregullator i sektorit per te mbrojtur interesin Publik. Kjo forme e PPP gjithashtu perdoret kur Qeverite vendosin te privatizojne nje sherbim ekzistues ose infrastructure, nepermjet nje strategjie investimi, per te terhequr nga nje sector specific.

Figura e meposhtme siguron nje pamje te gjere te arranxhimeve PPP te perdorura ne infrastructure dhe sektoret e sherbimeve publike te financuara ose te manaxhuara nen nje skeme PPP:






Figure 4-9 Qellimi I pergjithshem I arranjhimeve PPP arrangements (Burimi: RebelGroup Advisory BV)

Kompleksiteti I marreveshjeve PPP rritet me transferimin gradual te rrezikut dhe pergjegjesive ndaj sektorit privat. Shpejtesia e implementimit te kontrates PPP gjithashtu lidhet fuqishem me alokimin e pergjigjesive dhe investimeve/pronesise se asetete kryesore.

Pertej ketyre dy dimensioneve kritike, secili lloj I marreveshjes PPP ndermjet Autoritetit Kontraktues dhe Privatit, (partner privat ose investitor) karakterizohet nga tiparet e veta mbi tem ate tilla si:

- Si shperndahet fluksi I parave gjate ciklit te jetes
- Kush eshte klienti kryesor ne nje kontrate PPP e cila kanalizon te ardhurat ne infrastructure? (Autoriteti apo direct perdoruesi final)
- Afati I nje marreveshje te tille?
- Kush e mban riskun e te ardhurave? (Tarifa komerciale, transporti, etj)
- Kush e mban riskun operacional dhe kush eshte pergjegjes per O&M?
- Kush e ka pronesine ligjore mbi investimin?

Matriksi meposhte siguron nje permbledhje te tipareve kryesore te arranjhimeve PPP, sipas Bankes Boterore. Duhet te kujtohet qe ky kendveshtrim nuk lidhet specifikisht me sektorin portual, por eshte nje krahasim gjenerik i tipareve te PPP:

	Kontrate sherbimi	Kontrate Manaxhimi	Kontrate qeraje	BOT/DBFMO dhe te ngjashme	Koncesion	Privatizim i plote/ Divestiture
Afati kohor	Zakonisht shkurter	2-5 vjet, deri 10	10-15 yrs, deri 25	10-30 yrs, deri 95 yrs.	20-30 vjet	I perhershem
Klienti	qeveria/ Sigurues sherbimi	qeveria/ Sigurues sherbimi	Perdoruesi perfundimtar	qeveria/ Sigurues sherbimi	Perdoruesi perfundimtar	Perdoruesi perfundimtar
Pronesia	Publike	Publike	Publike	Publike	Publike	Private
Investimi	Publike	Publike	Publike	Private	Private	Private
O&M rasp.	Publike(private)	Private	Private	Private	Private	Private
Risk operacional	Publike	Public (private)	Private	Private	Private	Private
Risk I te ardhurave	Publike / Private	Public / Private	Private	Publike	Private	Private
Profili I fluksit te parave	Tarife fikse per sherbimet	Tarife fikse per sherbimet	Subjet ndaj riskut te tregut	Subjet ndaj riskut te tregut	Subjet ndaj riskut te tregut	Subjet ndaj riskut te tregut

Tabela 4-2 Arranjhimet PPP tiparet kryesore (Burimi: World Bank 2000, te rregulluara)

Ne kete matriks mund te vereni qe sa me shum risk I transferohet sektorit privat, aq me e gjate eshte kohezgjatja e kontrates. Kjo I jep kohe investitorit te rimare investimin pergjate nje te drejte kontraktuale afatgjate per te operuar dhe gjeneruar te ardhura nga asetet, si dhe te mund



te paguaje cdo hua te lidhur, ne menyre proporcionale e rritur me madhesine e investimit qe eshte realizuar nga pala private.

Risku I te ardhures lidhet ngushte me llojin e klientit ne kontraten kryesore PPP. Me klient kuptohet pala e cila eshte marresi primar i sherbimit dhe /ose aktiveve te organizuara ne kontraten PPP.

Per shembull, ne nje kontrate DBFM(O) (per dizenjimin, ndertimin, financimin, mirembajtjen dhe oeprimin), net e cilin kontraktori privat levron nje infrastructure per jne cmim te caktuar, marresi kryesor eshte Autoriteti Publik, I cili nga ana e tij jep infrastrukturen per perdoruesit finale; ne nje lloj kontrate me koncesion, Klienti eshte perdoruesi final, meqe kontraktori privat mund te mbledhe direct te ardhurat nga klienti/perdoruesi final. Kjo lloj arranzhimi I fundit keshtu funksionon mire per infrastrukturen e karakterizuar nga nje aspekti I forte komercial, te tille si portet detare, aeroportet apo projektet e pronave te patundshme, ku e ardhura mbledhet direct nga operatori privat, I cili paralelisht gjithashtu ndermerr te manaxhoje dhe mbaje riskun e te ardhures (p.sh tregun).

Pershkrimi I shkurter eshte nje permbledhje e nivelit te larte e filozofise PPP ne financimin infrastrukturor. Sektori portual paraqet specifikat e veta me modele te ndryshme qe rezultojne me te aplikueshme se te tjeret, por gjithashtu me rregullime mbi tipare te caktuara per industrine portuale. Strategjia PPP per duresin paraqitet meposhte, dhe eshte me shume e bazuar ne perspektiven mbi kete sektor.

4.4.2

Vizioni I modeleve PPP ne Dures

Qellimi, shtrirja dhe mbulimi I perfshirjes se sektorit privat

Qellimi, shtrirja dhe mbulimi nga sektori privat eshte primar nga angazhimi I sektorit privat eshte factor determinant per te gjitha ceshtjet e tjera. Kjo eshte nje ceshtje me ngjyrim te forte politik dhe interesa te partizaneve te ndryshem. Ceshtja kryesore eshte nese sektori privat do te kete mundesine te ofroje sherbimet te pjesshme ose te plota gjate gjitha mandatit te autoritetit portual, apo te mbetet thjesht nje nen-kontraktor per sherbimet portuale apo manaxhime objektesh ne port. Pergjigja e kesaj pyetje do te jepet vetem nese do te kete nje qellim te qarte te sektorit public ne ftesen ndaj sektorit privat:

Ky qellimi mund te jete nje ose te gjitha sa vijojne:

- Permiresimi I kapacitetit menaxhues te subjektit portual
- Reduktimi I kerkesave financiare nga rezervat shteterore
- Permiresimi I kualitetit te sherbimit portual dhe cmimeve te sherbimeve portuale
- Stimulimi I investimeve private dhe nxitja e businessit
- Transferimi I teknologjise dhe fjales se fundit te menaxhimit.

Nivelet e dallimit

Dallimi duhe te behet ne 4 nivele te ndryshme:

- **Angazhimit te gjithanshem, te plote dhe te perhershem te sektorit privat** (kur nje port I tere kalon nga duart e sektorit public ne ato te nje kompanie private, e cila eshte pergjegjese per te gjitha funksionet, sherbimet, operacionet duke perfshire dhe detyrimet e sherbimeve publike);
- **Angazhimi I nje pjese, I pjesshem, por I perhershem I sektorit privat** (nje pjese e portit eshte transferuar ne menyre te pehereshem nga autoritet publike tek nje kompani

- private, per te cilat kjo e fundit do te jete e pergjegjeshme per funksione, sherbime dhe operacione te vecanta);
- **Angazhim i pergjithshem, i plote por i perkohshem i sektorit privat** (Per nje periudhe te perkoheshme i gjithe porti i transferohet nje kompanie private nga autoriteti public. E para do te jete pergjegjese per te gjithe funksionet, sherbimet dhe operacionet per nje kohe te caktuar – ne fund te periudhes se nenshkruar kohore te gjitha funksionet, sherbimet dhe operacionet do t'i transferohen autoritetit public);
 - **Angazhimi i nje pjese, i pjesshem por i perkohshem i sektorit privat** (Per nje periudhe kohe per te cilen eshte rene dakort porti transferohet nga autoriteti public tek nje kompani private per funksione, sherbime dhe operacione te caktuara).

Forms of private sector participation




Figure 4-10 Format e pjesemarrjes se sektorit privat

Kur behet fjale per Portin e Duresit, duhet te pranohet sic eshte dhe me pas ne nje faze kur te mundesohet implikimi i sektorit privat (nje pjese, i pjesshem dhe i i perkohshem) do te jete i pranueshem nga Qeveria.

Disa modele te mundshem mund te konsiderohen per pjesemarrjen e sektorit privat ne porte. Ato fillojne nga nje nivel i ulet i perfshirjes se kompanive private ne rastin e kontraktimit vetem te sherbimeve deri ne nje kontroll te plote sin e rastin kur shitet nje prone tere portuale. Format e ndryshme te pjesemarrjes se sektorit privat tregohen ne Figuren Figure 4-10.

4.4.3

Modele alternative dhe marreveshje kontraktuale te aplikueshme

Pjesmarrja e sektorit privat eshte shume e ulet kur autoriteti public (per lehtesi do ta quajme autoriteti portual ne kete rast, mund te jete dhe nje autoritet regjional, ndoshta mund te jete dhe nje agjensi qeveritare ose ministri) eshte ai qe **kontrakton** per sherbime ose aktivite me kompanite e sektorit privat. Keta te fundit punojne me kontrata te qarta per nje kompesim fix. Ne



kete rast nuk ka nevojë që të behen investime në port. Kontratat janë përcaktuar në terma afat shkurtër.

Me kontratat e qiradhenies sektori privat merr përsipër operacione të specifikuar në detaje të objekteve si terminalët, për një periudhë të përcaktuar. Asnjë investim i madh nga ana e qeramarresit nuk kërkohej për infrastrukturën ose superstrukturën. Megjithatë investimet në makineri, mund të jenë të nevojshme. Ai i paguan qirane e përcaktuar autoritetit portual, që është pronari i objekteve dhe mjeteve. Ai duhet të përmbushë një numër të kufizuar kushtesh performance.

Në koncesionet e zakonshme, sektori privat merr përsipër operacione shumë të qarta si dhe objekte për një periudhë kohore të përcaktuar, por gjithashtu pritet që ky entitet të bëjë dhe investime në superstrukturë dhe mjete. Gjithashtu duhet të paguaje dhe qirane tek autoriteti portual nëpërmjet një sistemi pagesash të caktuar. Autoriteti portual metet pronari i përdorimit të infra dhe superstrukturës. Nga atëherë ky operator duhet të sigurojë dhe një sërë kushtesh të përdorimit të cilat mund të jenë shumë kërkuese dhe është përgjegjës për kushtet e kontratës së qirase.

Në tipin B.T.O të arrangimit, në këtë tip operatori duhet të marrë përsipër përveç shërbimeve dhe objekteve të përcaktuara mirë përderishte është përgjegjës për investime të mëdha në ndërtim dhe operacione të lidhura me infrastrukturën, në superstrukturë dhe mjete. Një herë që janë bërë këto investime pronësia i kalohet autoritetit portual (në infra dhe superstrukturë, por operatori ka të drejtë të përdorë objektet për një kohë shumë mirë të përcaktuar. Në shumicën e rasteve kjo është vështësia kryesore për operacionet nga sektori privat të cilat mund të përdorin fondet e përshatësive vetëm nëse egzistojnë ligjëzat kombëtare të cilat lejojnë koncesionet.

B.O.T., është e njëjtë si B.T.O, përveç një diference mëdhe që është se pronësia operative e objekteve mbetet tek operatori deri në fund të kohës së përcaktuar dhe më pas i transferohet autoritetit portual. Nëse koncesionari nën një kontratë BOT ose BTO ende i paguan autoritetit kontraktues (ose autoritetit portual) një tarifë të caktuar kjo arë nga nënë për të cilat kanë rënë dakort të dyja palët. Në analizën finale, tarifa të tilla duhet të reflektojnë përfundimisht përfitueshmërinë e pritshme financiare nga projekti për koncesionerin gjatë gjithë kohëzgjatjes së koncesionit.

B.O.T. e plote, është një kontratë koncesioni e kombinuar që fillon me një infrastrukturë operacionale egzistuese e dhënë në koncesion, por që mund të vazhdojë me një zgjatje të koncesioneve me anë të ngritjes të strukturave të reja operacionale (këtu kemi kombinimin e një B.O.T me një kontratë qiradhenese ose koncesion normal).

Në përfundim, në **B.O.O.**, koordinimi i shitjeve dhe shërbimeve nga operatori privat do të çojë në angazhimin e plote, të përgjithshëm dhe jo vetëm të përgjegjësive që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e përveçen në përdorim dhe investimet e transferuara nga autoriteti portual tek operatori privat, por dhe transferimi i të gjithë mandatit të komplet shërbimit publik. Është e qartë se kjo e fundit përjashtohet për të aplikuar në sektorin portual të Shqipërisë pasi nuk përputhet me politikën ekonomike të Qeverisë.

Aty dhe atëherë ku egziston egzistencioni i duhur dhe ligji mbi koncesionet ato favorizojnë kontratat për koncesionet. Kontratat B.O.T. janë më të vështira për t'u realizuar nëse objektet duhet të kenëqin nevojat specifike të investitoreve private dhe garen për treg nëse mungojnë kushtet e mesipërme (kjo çështje do të diskutohet në kapitullin tjetër ku diskutohet sektori privat).



Pra, ne kontekstin Shqiptar modelet me te rendesishme te listuara me lart dhe arranzhimet kontraktuale per te promovuar pjesemarrjen private ne porte jane marreveshjet e qerase dhe ato te koncesioneve te rregullta. Megjithetete, per disa nga facilitetet e reja te mallrave refuxho te planifikuara ne master plan, nje B.O.T e mire-strukturuar do te ishte nje arranzhim i preferuar ne rast se Qeveria ose APD deshiron te minimizojë ekspozimin e tyre financiar.

4.4.4 'Objekti I vecante I angazhimit te sektorit privat

Problemi I "objektit" te angazhimit te sektorit privat eshte shume ngushte I lidhur me c'ka autoriteti publik konsideron term ate pranueshme per shtrirjen dhe plotesimin e planit kryesor. Ky I fundit ka lidhje me cfare do te ofroje autoriteti portal si asetet fizike tper operatorin privat te perdore (per nje terminal operimi perfshin apo jo vendin e ankorimit, siperfaqe ose jo-siperfaqe pas vendit te ankorimit, disa ose te gjitha mjetet qe perdoren aty etj.)

Kjo e fundit eshte shume e rendesishme ne portin e Durrësit. Kapaciteti I vogel per zgjerim ne port ne vendodhjen e sotme dhe konfiguracioni I tij aktual, numuri I kufizuar I pikave te ankorimit qe sherbejne per perpunimin e ngarkesave speciale si dhe shume kerkesa te reja qe vijne nga biznese tregtare dhe industriale per objekte te reja te cilat duhet te zbatohen bazuar ne prioritet e vlerave te tyre ekonomike dhe duhet qe secili nga objektet e dhena me koncesion duhet te jene te mire pershkruara. Kerkesat konkruuese jane regjistruar per terminalin e trageteve, kantierin privat dhe ne vecanti kalatat e mallrave refuxho. Keshtu, kjo e fundit, mund te perdoret per secilen nga keto qe vijojne: te furnizojë metalurgjikun e Elbasanit me materialet e para, per perpunimin e eksporteve te cimentos, per te permbushur kerkesen per mallra te tjera refuxho dhe per cdo perdorim per te cilin eshte identifikuar nje nevojë e forte reale ose potenciale.

Qellimi per kombinimin e aktiviteve te ndryshme ne te njeitin facilitet eshte i kufizuar. Kjo e ben urdheruese qe kerkesat te priorizohen ne baze te vleres se tyre te shtuar ekonomike dhe secili nga facilitetet duhet e ofruara me koncesion eshte perkufizuar dhe pershkruar qarte. Eshte esenciale qe Qeveria te deklarojë qarte prioritetet brenda planimetrisë se master planit dhe vlereson secilin nga projektet me koncesion me nje pikepamje per te realizuar performancen me te mire operationale, duke arritur keshtu nivelet me te mira te perdorimit dhe gjenerimin e kontributit me te madhe te mundshem ne ekonomine kombetare.

4.4.5 Kohezgjatja e perfshirjes se sektorit privat

Termat e perdorur ne marreveshjet e koncesionit (except for B.O.O. concessions³²) jane ceshtje strategjike sepse ndermjet te tjerash varen dhe nga faktore sic jane;

- Tipi I kontrates se koncesionit te nenshkruar;
- Investimet respective kapitale te behen nga ai qe eshte autoriteti koncesionar ndaj atij qe I jepet koncesioni
- Dhe shperblimi ose pagesa qe sektori privat bie dakort t'I paguaj autoritetit portal.

Kohezgjatja e koncesionit duhet te behet ne radhe te pare duke u bazuar ne kalkulimet financiare te cilat jane te bazuara ne termat dhe kushtet e marreveshjes koncesionare te marre

³² In B.O.O. there is no transfer back to the contracting authority of the facilities built under the concession contract and hence as a rule no duration is set for this type of arrangement.



ne shqyrtim (psh duke u mbeshtetur ne CAPEX, shperndarja e veshtiresive te investimeve te te dypaleve ne kete rast autoriteti portat dhe operatori privat,tarifat e perdoruesit,faturat e qirave,nivelet e perfitiomeve nga per nivele te ndryshme etj.)

I vetmi limit legal eshte ai i cituar ne ligjin 9663 te dates 18/12/2006 qe deklaroi se koncesionet jepen deri ne nje maksimum 35 vjecar. Nese kjo kohezgjatje per nje koncesion eshte e vlefshme mbetet per t'u gjykuar te pikave kyce te marreveshjes se koncesionit duke konsideruar parametrat financiar me objektivat e kontrates, te parashtruara nga Ministria e transportit dhe autoriteti portat te kombinuara edhe me cfare prët operatori privat nga kjo marreveshje.

Insistimi nga nje sere entitetesh publike per dhenie koncesionesh me afat te shkurter con mesazh dekurajues ne sektorin privat qe eshte i interesuar per kete sektor.Ketyre te fundit ju duhet te investojne ne nje shkalle te gjere, te transferojne dhe ndajne fitimet, nderkohe qe autoriteti koncesionar duke ngulur kembet ne periudha te shkurtera tregon minimumin e besimit per projektet e tyre afatgjata, aftesite e tyre managuese ne objekte dhe stauren e tyre financiare. Prandaj duhet treguar kujdes nga autoriteti qe jep koncesion qe te jape sinjalet e duhura kur bie dakort per pikat e kontrates me sektorin privat, duke marre ne konsiderate dhe kerkesat e tyre.

Nga eksperiencia boterore kontrata e qiramarrjes vetem perr investime te kufizuara eshte 15 vjet, kontratat pe nje game me te madhe investimesh qe perfshin investimet ne superstrukture (zyrat, portat, workshops) dhe paisjet eshte tipikisht 25 vjet dhe per tipet e kontratave B.O.T.kohezgjatja eshte 25 deri ne 35 vjet me variantin per t'u rinovuar.Gjeja kryesore qe te vendosen marredhenie bashkepunimi eficiente midis autoritetit qe ben koncesione dhe atyre te pales qe perfitojne nga koncesioni, ne menyre qe te dy palet te bejne te mundur te punojne sebashku.

4.5 Interesi i sektorit privat

Me qellim qe te paraqitet nje status i Masteplanit te propozuar eshte organizuar seminari me Biznesin, ku jane shpjegur planimetria e preferuar dhe opsionet e terminalizimit dhe ristrukturimit te Portit.

Semina i organizuar ne Portin e Durrësit, me nje asistencë te vlefshme te skuadres se portit per te organizuar takimin. Workshop-i mblodhi 40 deri 50 perfaqesues bashke me skuadren e konsulences.

Pas prezantimit te statusit te studimeve te masterplanit, seksioni kryesor pati qellim nderaktivitetin dhe shkembimet ndermjet Portit te Durrësit dhe Konsulentit dhe kryesisht paleve te ndryshme te sektorit privat.

Rezultati kryesor i ketij seminari ishte rafinimi ose marrja ne konsiderate e propozimeve qe do te permbledhen ne planimetrine e masterplanit te preferuar dhe qe duhet te jene ne linje me vizionin dhe njohurite e sektoreve specifike te biznesit qe do te luaje nje rol madhor ne ristrukturimin e portit.

Temat kryesore qe u diskutuan jane si vijon:

Propozimi i terminalit te perpunimit te Cimentos / Klinkerit



Pyetjet e ngritura mbi temat e meposhtme nga Prodhuesit e Cimentos ne Shqiperi:

- Nderveprimi ndermjet kalates dhe sheshit te depozitimit dhe aftesise per te siguruar nje fluks te vazhdueshem ndermjet te dyjave
- Koha e implementimit potencial
- Propozimi i vendodhjes se zones aktuale ku ndodhet kantieri i Kurumit dhe problemet komplekse ligjore qe ngre ky propozim
- Interesi ne propozimin BOT ne privatizimin e terminalit

Masterplani merr parasysh transferimin potencial kalate – toke. Koncepti bazohet ne depozitimin Silo per te kursyer hapesire depozitimi dhe transferimi I bere nga konvejeri ose sistemet pneumatike. Transferimi direkt ne kamion nuk rekomandohet per shkak te sasive.

Operacionet e trageteve dhe vendodhja kundrejt termianaleve te mallrave te thata refuxho

Ka nje shqetesim ne lidhje me perputhshmerine e Terminalit te Trageteve dhe kalatave qe perpunojne mallrat e thata refuxho, dhe efektit potencial mbi pasagjeret qe kalojne transit ne port.

Keshtu qe strategjia qe fokusohet mjaft ne mallrat refuxho te pista nuk eshte zgjidhja e preferuar.

Me qellim qe te lehtesohet nje afersi e tille, parashikohet nje pontil per perpunimin e cimentos. Nese mendohet qe kjo nuk eshte zgjidhja ideale per trafikun specifik, objektivi i pergjithshem eshte qe porti do te mbeshtese zhvillimin industrial te ekonomise Shqiptare. Diskutimi i alokimit te tregtise ndermjet porteve eshte subjekt ndaj I nje strategjie me te gjere Kombetare nese Masterplani studion mundesite e biznesit dhe formulon propozim per portin e Durrësit.

Koha e sekuencave te Koncesionit

Disa shqetesime ekzistojne rreth kohes se propozuar, e cila shperndahet ne 3 deri 4 vjet per implementimin e plote te synuar te terminalave te privatizuar.

Eshte kujtuar qe secila PPP kerkon burime dhe kohe substanciale, dhe kjo sekuence ka qellim adresimin e prioriteteve. Per kete arsye, punet aktuale jane drejt biznesit te konteniereve. Disa implementime gjithashtu kerkojne ndertime madhore te infrastruktures, implementimi i pergjithshem do te performohet ne disa vjet.

Paketat PPP dhe aktivitetet portuale

Situata e investitoreve locale dhe operatoreve ne privatiziet e ndryshme eshte gjithnje e mundshme. Kjo do te varet nga kriteret e perzgjedhjes te dizenuara per secilen pakete dhe aftesine per operatoret lokale per ti pershtatur keto, pozicioni lokal i cili sjell avantazhe specifike dhe kushtet e tregut ne kohen e leshimit te nje projekti koncesioni ne treg. Paketat per marreveshjet PPP ne te vertete nuk jane te detajuara plotesisht, meqenese faza e planifikimit nuk mund te hyje ne strukturim te plote per nje PPP specifike; kjo do te behet kur nje tender real eshte dizenuar dhe ku karakteristikat specifike jane thelluar me tej.

Nuk ka kufizime te investitoreve lokale ose nderkombetare, meqenese secili tender do te jete totalisht kompetitiv. Aspekti social do te prioritizohet nga perspektiva e perdoruesit, Autoritetit Kontraktues.

Ne lidhje me sugjerimet mbi lidhjen me tregun e Kosoves, ky element eshte nderuar ne parashikimet e tregut dhe faktoret qe ndikojne. Nderkohe, thruputi i ulet qe ai paraqet deri tani pritet te kete nje impakt te kufizuar mbi zhvillimin e pergjithshem te tregtise.



Ne lidhje me zhvillimin e qendrave të logjistikës, rekomandohet zhvillimi i tyre jashtë portit. Duke patur mungesë kapaciteti dhe objektivi primar i Portit është perpunimi i ngarkesave, këto ambiente mund të zhvillohen në rrethinat, ku ka me shumë toke dhe është potencialisht me të lirë, nderkohe që mbahet një lidhje e ngushtë me terminalët.

Vendodhja e terminaleve të mallrave të thatë të pista refuxho

Në lidhje me këto mallra, është vërejtur një pakënaqësi. Kjo justifikohet me faktin që porti ndodhet direkt në një zonë urbane dhe që trafikë të tjera mund të shqetesohen nga perpunimi i cimentos ose i skrapit. Workshopi edhe pse mundësoi nënvizimin e të gjithë këtyre aspekteve që janë konsideruar, dhe që propozimi i Masterplanit është strukturuar në një mënyrë ku zhvillimi i biznesit portual dhe karakteristikat e tregtisë dhe perputhshmëria të balancohen në mënyrën më të mirë të mundshme. Besohet që teknologjia e perpunimit në port tashmë mund të ofrojë lehtësisht efekte të tilla dhe që i gjithë shpirti i mbështetjes së Ekonomisë Nacionale do të merret si element kryesor, por që do të balancohet plotësisht me efektet anësore mjedisore që pritet të ndodhin.

Porto Romano është shembulli i parë se si një ceshtje e tillë mund të përballohet. Nderkohe, objektivi i Masterplanit është optimizimi i prones aktuale që ka porti dhe të shërbejë sa më mirë komunitetin dhe tregtisë shqiptare, dhe që një konsiderim i tillë ose mund të vendoset në një nivel më të lartë ose të diskutohet në periudhë afatshkurter. Madhësia aktuale fizike mundëson perpunimin e zhvillimit të konsiderueshëm tregtar me strukturimin e përshtatshëm dhe optimizimin operacional.



5 MASTER PLANI

5.1 Hyrje

Ne kapitullin e mëparshëm është prezgjedhur opsioni i Masterplanit të preferuar. Ky kapitull paraqet një pamjet të përgjithshme të masterplanit të propozuar. Detajet mbi secilin nga terminalët, duke përfshirë llogaritjet e kapacitetit dhe vlerësimet e kostos përfshihen në aneksin 8 të këtij raporti.

5.2 Parimet udhëzuese për përpunimin e Master Planit

Parimet për zhvillimin e masterplanit u paraqiten në kapitullin 4, dhe për arsye qartësie dhe për shkak të rëndësisë së tyre ato përmbledhen mëposhtë:

- Kërkesa për shërbimet portuale sic tregohet në parashikimin e trafikut
Parashikimi i trafikut i përpunuar në Kapitullin 3 të këtij raporti do të përpunohet
 - E gjithë ngarkesa duhet të përpunohet në Portin e Durrësit
Derisa rezultati i një strategjie portuale nacionale të tregojë ndryshe, i gjithë trafiku i cili përfshin gjithashtu mallin e thatë, duhet të përpunohet në portin e Durrësit.
 - Infrastruktura e kerkuar e terminalit
Kërkesa për shërbime portuale është baza për përcaktimin e infrastrukurës së kerkuar dhe për fazimin e masterplanit. Llogaritjet e kapacitetit janë përfshirë në aneksin 8.
 - Madhësia e anijes
Masterplani është zhvilluar për një anije të dizenuar prej 30 000 DWT. Kjo është anija maksimale ndaj të cilave baseni aktual mund të bëhet kundërt standardeve ndërkombëtare të sigurisë me një investim të arsyeshëm.
 - Terminalizimi
Në kuadër të transformimit të portit të Durrësit në një port landlord (pronar toke), koncepti i terminalizimit është aplikuar për formulimin e opsioneve të masterplanit. Kjo do të thotë që porti është ndarë në disa njësi fizike – terminale – që i janë dedikuar përpunimit dhe depozitimit të llojeve të vecanta të ngarkesave që janë të përshtatshme me njëra-tjetrën. Terminalët e identifikuar janë:
 - Terminali i kontenierëve
 - Terminali i ngarkesave të përgjithshme dhe i drithit
 - Terminali i trageteve dhe kruzeve
 - Terminali i mallit të thatë refuxho
 - a. Eksporti i cimentos dhe klinkerit
 - b. Importi qymyrit dhe eksporti i mineraleve
 - c. Importi i skrapit
 - Projektet tashmë kanë filluar
Disa projekte janë aktualisht në një fazë të avancuar të ekzekutimit – për shembull ndërtimi i terminalit të trageteve dhe rehabilitimi i kalatave 7/8. Këto projekte janë të përfshira në masterplan sic janë të planifikuara.
- Supozimet në premisat aktuale portuale
- Pronesia e tokës
Për masterplanin teknik supozohet që Autoriteti Portual Durrës ka ose mund të përfitojë autoritet mbi tokën e treguar në opsionet e masterplanit.
 - Është rialokuar terminali i karburanteve



- Eshte rialokuar porti I peshkimit
 - Rripi I tokes, I cili me pare ka qene ne pronesine e autoritetit hekurudhor, I transferohet portit
 - Kantieri detar eshte ne dispozicion per infrastrukturen portuale
- Qerate aktuale te portit me palet e treta supozohet se mbyllen nese kjo kerkohet nga masteplani I ri.
 - Te siguroje perdorimin maksimal te faciliteteve ekzistuese dhe te shmange shkaterrimin e kapitalit

Plan zhvillimi I perzgjedhur karakterizohet nga vendodhja e terminalit te konteniereve ne pjesen perendimore te basenit dhe vendodhjes se mallrave te pista refuxho ne pjesen lindore. Me kete plan aktivitetet e 'pastra' ndodhen prane qytetit te Durrësit dhe aktivitetet e 'pista' ndodhen sa me larg te jete e mundur nga qyteti I Durrësit.

Avantazhet e kesaj alternative jane qe:

- Ekzekutimi i Masteplanit mund te filloje shpejt pa investime te medha meqe terminale te ndryshem do te ndodhen ne te njejtin vend sic jane.
- Ka nje mundesi per realizimin e Master Planit ne faza
- Perdorimi i basenit aktual dhe zonat portuale optimizohen
- I gjithe trafiku i projektuar mund te perpunohet, dhe ka mundesi zgjerimi (kalata 13, nese do te kerkohet
- Ajo siguron nje fleksibilitet te tille qe, nese nje strategjit kombetare portual do te kerkoje qe ngarkesat refuxho te transferohen ne nje port te ri (ose ekzistues), terminali I tyre mund te destinohet per perpunimin e konteniereve

Me kombinimin e aktiviteve te Trageteve dhe Kruzeve ne nje terminal te kombinuar, zhvillimi I turizmit mund te stimulohet. Me nje ndertese se re pasagjeresh dhe nje zone te re portuale, hyrja per ne Durrës do te jete me atraktive se sa aktualisht. Ne kete menyre keto aktivite mund te zhvillohen me tej.

5.3 Prezantimi i Master Planit

5.3.1 Pamje e pergjithshme e masterplanit te propozuar

Planimetria e Masterplanit sic paraqitet ne faqen tjeter (dhe ne vizatimin numer 9S0723.21/DFR/310 te aneksit 1) e tregon portin ne fund te horizontit te projektit. Master Plani do te zhvillohet ne 4 fazat te cilat percaktohen ne baze te kerkesave te percaktuara nga parashikimet e ngarkesave dhe konsiderimet ne lidhje me sekuencen e ndertimeve. Fazat jane kryesisht te percaktuara nga zhvillimi I tregtise se konteniereve si shumica e mallrave te tjera qe nuk tregojne nje zhvillim te rendesishem ne kohe.

9S0723.21/DFR/401180/Nijm
28 Mars 2008



manaxhim i zones do ti vishet APD-se. Kjo do te perfshije, por nuk do te jete e kufizuar ne sa vijon:

- Transferimin e rripit te tokes nga Hekurudha tek APD-ja;
- Largimi i Depozitave dhe Pontilit dhe transferimi i tokes APD-se;
- Sheshi i kantierit te Kûrûmit i transferohet APD-se;
- Sheshi qe do te rregullohet pas kalates 10/11 dhe kalates 12;
- Largimi i portit te Peshkimit dhe Transferimi i Tokes tek APD-ja.

Ripi i tokes aktualisht nen pronesine e hekurudhes ndodhet ne pjesen perendimore prapa kalatave 5 – 7/8. Me transferimin e ketij rripi toke, sheshi i konteniereve do te zgjerohet. Shinat ekzistuese do te largohen, zona do te pastrohet dhe nje rruge e re per ne port do te ndertohet.

Te gjitha aktivitetet me mallrat e lengshme refuxho do te rialokohen ne nje port te ri ne veri te Durrësit (Porto Romano), duke liruar zonen aktualisht te okupuar nga Depozitat e naftes (ne veri te portit) dhe nga pontili (pergjate skolieres lindore). Per shkak te avantazhit qe ka vendodhja aktuale prane rruges kryesore per te hyre ne port dhe gjithashtu me hekurudhen aktuale, masterplani percakton kete zone si porta kryesore e portit.

Ne Master Plan, kantieri i Kûrûmit do te perdoret per aktivitetet mallrave te thata refuxho, sheshin e tejngarkuar te konteniereve dhe zgjerimin e terminalit te Trageteve/kruzeve. Kjo zone te te duhet te pastrohet perpara se te perdoret per aktivitetet portuale.

Kalatat e reja 10/12 dhe ne kalaten 12 do te perdoren per zhvillimin dhe zgjerimin e aktiviteve te mallrave te pista refuxho. Porti i peshkimit do te perdoret per zgjerimin e aktiviteve te Trageteve dhe Kruzeve. Kater veprimet e para duhet te ndodhin ne fazen e pare te Master Planit. Pika e peste do te duhet te realizohet ne Fazen 3 te Master Planit i cili pershkruhet me tej ne raport.

5.3.3 Risqet

Masterplani i paraqitur bazohet ne disa supozime baze, prej te cileve dy jane kritike:

- E gjithë ngarkesa duhet te perpunohet ne portin e Durrësit
- Sheshi aktualisht i okupuar nga Kantieri i Kurumit do ti vendoset ne dispozicion APD-se ne peridhe afatshkurter.

Mosperputhja e njerit ose te dy ketyre supozimeve do te kerkoje nje amendim te masterplanit. Meqenese ne kete moment nuk kemi nje pergjigje finale per asnje nga ceshtjet, metoda e perzgjedhur eshte te ndertohet nje fleksibilitet ne masterplan, keshtu qe te mund te amendohet relativisht lehte (ndoshta te ndryshohet) pa shkaterruar investimet e bera.

Ne lidhje me ceshtjen e pare, mund te thuhet qe nese ne nje kohe te caktuar ne te ardhmen do te indikohet nje vendodhje e re pergjate bregdetit Shqiptar per perpunimin e mallit te thate refuxho (per shembull me qellim qe te mbeshtetet nje zhvillim me i qendrueshem i turizmit ose qytetit te Durrësit ne pergjithesi) masterplani do te duhet te adaptohet ndaj kesaj situete te re. Ne kete aspekt eshte e rendesishme te verejme qe masterplani aktualisht parashikon qe kalatat pergjate skolieres lindore do te jene me te gjera se sa aktualisht, dhe qe keto kalata jane dizenuar per nje anije me te njeften thellesi dhe gjatesi per anijen me te madhe te konteniereve qe mund te pritet ne port. Keshtu, rekomandohet te kerkohet qe kalatat e mallrave te thata refuxho pergjate skolieres lindore jane te dizenuara per te lejuar nje transformim relativisht te lehte ne terminal kontenieresh.

Problemi i dyte, dmth pasiguria per disponueshmerine e kantierit, mund te ndaloje zhvillimin e terminlit te projektuar te eksportit te klinkerit dhe cimentos.Meqe planet per kete zhvillim te vonshem jane shume te avancuara, nje vonese e tille do te kishte nje ndikim negativ ne eksportet e cimentos dhe klinkerit. Nese eshte e nevojshme, dedikimi i kalates 13 per cimenton dhe klinkerin mund te konsiderohej. Megjithate kete, kjo zgjidhje duhet te perdoret vetem si nje mundesi e fundit nese te gjitha negociatat per transferimin e tokes se kantierit do te deshtonin.

Shenim:

Zbatimi i masterplanit te propozuar varet nga transferimi me sukses tek Autoriteti Portual i pronesis se tokes qe aktualisht eshte e zene nga Kantieri Detar. Nese ky transferim nuk realizohet, atehere duhet hartuar nje masterplan tjeter alternativ – referoju kuadrit me poshte. Ne kete plan, zona e kantierit detar nuk eshte e disponueshme per zhvillimin e portit, vendankorimi 12 eshte i parashikuar per cemento/ klinkera dhe vendankorimi 13 per skrape. Duhet theksuar qe ky masterplan nuk eshte opsioni i preferuar, pasi ai redukton kapacitetin total te portit me rreth 5 milion ton ne vit krahasuar me planin e propozuar, dhe nuk i krijon portit hapësirat e nevojshme per te qene fleksible ne kerkesa te ardhshme te mundshme per zgjerim.



5.4 Diskutim mbi Terminalet

Masterplani parashikon zhvillimin e 6 terminaleve kryesore:

1. Terminali i mallrave te pergjithshme dhe drithit
2. Terminali i kontajnerave



3. Terminali i trageteve dhe krocerace
4. Terminali i cimentos dhe klinkerit
5. Terminali i mineralit dhe qymyrit
6. Terminali i skrapit

Karakteristikat kyce te secilit nga keto terminale pershkruhen meposhte. Nje diskutim me i detajuar i secilit nga keto terminale paraqiten ne aneksin 8 te ketij raporti.

5.4.1 Terminali I ngarkeses se pergjithshme dhe drithit

Ngarkesa e pergjithshme do te ngarkohet dhe shkarkohet me ane te vincave mobil. Ne terminal, ngarkesa do te transportohet me Kamiona Pirune Forklift Trucks (FLT's). duke marre ne considerate kushtet e vincave te ngarkimit dhe FLT, eshte parashikuar blerja e makinerive te reja:

- 4 vinca te rinj mobil 5 ton
- 18 FLT's ne Fazen 1
- 4 FLT's ne Fazen 4

Kjo duhet te mjaftoje per trafikun e projektuar prej 1.2 milion ton deri ne fund te horizontit te master planit. Vincat aktualisht te perdorur per shkarkimin e drithit jane ne kushte te mira. Prandaj do te blihen makineri te reja ne fund te fazes 3. Kjo do te behet ne kohen qe shkarkimi i drithit do te rialokohet nga kalata 5 ne kalaten 4. Makineria e re eshte ne jvakuator me kapacitet prej 250 t/h.

Dritherat mund te sillen nepermejt shkarkimit direkt (direkt ne kamiona), por ne rast se kerkohet magazinim, mund te krijohen nje set me kulla silosi. Lartesia e kullave duhet te kufizohet deri ne 10m maksimumi, ne menyre qe te minimizohet pengesa vizuale.

Magazinimi i ngarkeses se pergjithshme mund te behet ne vend te hapur, ose ne magazinene e pjese me veriore (afër ndertesës së kapitenerisë). Pjesa tjetër e magazinave ne anen jugore duhet te shkaterrohet dhe vendi i krijuar duhet shfrytezuar si nje vend magazinimi i hapur.

Keshilluesit i eshte raportuar qe ka disa propozime per ndertimin e nje magazine te ftohte ose frigoriferike ne portin e Durrësit. Magazina te tilla do te sherbenin per te ruajtur produkte si perime, zarzavate, mish dhe peshk. Megjithate, duke pare trendin e tregut, transporti me ruajtje ne ambjent te fresketa po kalon shume shpejt nga mjetet lundruese frigoriferike ne konteneret frigoriferike – shiko figuren me poshte. Nga figura 5-3 mund te kuptohet qe numri i mjeteve lundruese frigoriferike do jete shume i vogel rreth vitit 2015, duke supozuar nje jete mesatare per 25 vitesh per keto lloj mjetesht transporti.

Figura 5-2 Evoluimi i perqindjes se kapacitetit te disponueshem per transportin frigoriferik





Prezantimi i taksës së ankorimit jep të njëjtin efekt, duke i sjellë të ardhura shtesë APD. Megjithatë ky burim të ardhurash mund të konsiderohet si më pak i qëndrueshëm se sa tarifatat portuale, nëse merret parasysh numri i madh i linjave të rregullta që vijnë në Durrës me një trafik të konsiderueshëm tragetesh si dhe rritja e shërbimit të konteneireve në port. Nga ana tjetër, vendosja me detyrim të një takse ankorimi për vëllime të larta siç janë çimento, klinkeri apo skrapë bie në kontradiktë me strukturën e BOT e cila pritet të aplikohet tek këta terminalë të specializuar. Nderkohe që kërkesat në financimin fillestar janë pothuajse njëlojë, rreth 65 Milion Euro për një periudhë shumë të shkurtër.

Për të përmblodhur, këto dy alternativa ndikojnë në strukturën e të ardhurave të APD duke kanalizuar taksa shtesë tek Autoriteti. Menyra e tretë konsiderohet si më interesante sepse ajo ndikon direkt tek të gjithë strukturat portuale në sistemin e ri të portit pronar dhe krijon mundësi për të përmirësuar pagesat koncesionare të APD. Në këtë mënyrë, preferohet një rregullim i tarifave sepse kjo mbart të njëjtin risk me të ardhurat nga taksat portuale por mund të transferohet tek një palë e jashtme nëpërmjet grancive mbi vëllime dhe mekanizmeve të mirëstrukturuar.

Mund të vihet re përmirësimi i pozicionit të cash-it në 3 deri 4 vite me shpejtësi se sa parashikojnë dy alternativat e para; kjo ndodh kryesisht nga rritja në pagesat koncesionare; nga ana tjetër, kërkesa për financim reduktohet me vetëm 3 Milion Euro. Interesi kryesor për venien në zbatim të strukturës së re tarifore është që të krijohen kushte shtesë tërheqëse për paketat e ndryshme PPP, të cilat mund të përkeqësohen direkt në të ardhura të autoritetit të portit pronar. Nga një pikëpamje tregtare, megjithatë rritja e tarifave do bëhet sipas impaktit që kanë përdoruesit dhe pozicionit konkurrues në Durrës, mendohet si një rregullim më transparent në linjë me realitetin ekonomik të vlerës së menaxhimit të shërbimeve në Durrës, duke ndjekur modernizimin drastik të terminalëve nëpërmjet paketave PPP.

Struktura e parashikuar e tarifave, megjithatë frenon atraktivitetin e terminalit të Mineraleve/ Qymyrit, prodhon përfitime në të gjitha paketat e tjera. Ndryshimet me të mëdha qëndrojnë në pagesat koncesionare të disponueshme për Autoritetin Portual, të paraqitura si më poshtë:

	T1	T2	T3	T4	T5	T6
--	----	----	----	----	----	----



Artikulli	Mineralet (eksport Nikel, Krom, import Qymyr)	Cimento, Klinker (eksport)	Ngarkesa te pergjithshme dhe Ngarkesa te medha agri.	Kontenierte	Pasagjere (Tragete dhe Kruzer)	Importi i Metaleve skrap
Niveli ekuivalen concesionar me tarifen aktuale (e rregulluar per kontenierte)	Pjesa e te ardhurave 10%	Pjesa e te ardhurave 10%	Pjesa e te ardhurave 10%	Pjesa e te ardhurave 15%	Pjesa e te ardhurave 78%	Pjesa e te ardhurave 10%
Niveli ekuivalen concesionar me tarifen e re te planifikuar	Pjesa e te ardhurave 7%	Pjesa e te ardhurave 31%	Pjesa e te ardhurave 16%	Pjesa e te ardhurave 30%	Pjesa e te ardhurave 78%	Pjesa e te ardhurave 36%

0-1 Mekanizmat koncensionare ne strukturen e re tarifore

Ky trajtim mund te shihet si nje menyre terheqese per te lehtesuar te ardhurat, duke kerkuar garancine minimale mbi volumet (se bashku me pjesen e qerese se tokes se mekanizmave koncensionare) per te siguruar nje pjese fikse te ta ardhurave pet Autoritetin e Portit Pronar.

Nga ana tjeter, mund te vihet re qe alternativat e te ardhurave kane impakt te kufizuar ne nevojat per financim. Kjo ndodh kryesisht sepse pjesa me e madhe e investimeve qe duhen bere nga APD jane te shperndara nje periudhe 2-3 vjecare, gje qe detyron marrjen e metejshme te borxhit po ne kete periudhe te shkurter kohore. Me supozimin qe 87% e tij mund te konsiderohet i siguruar per portin, kjo shume gjasa qe kjo borxhamrje te realizohet, dhe si pasoje pozicioni i ardhshem ne cash i APD nen sistemin e portit pronar te filloje te balancohet shume shpejt, sapo te fillojne te mblidhen pagesat koncensionare.

8.0 IMPLEMENTIMI PPP: PERZGJEDHJA DHE MONITORIMI I PARTNERËVE PRIVATË

8.1 Kriteria për përzgjedhjen e ofruesit më të mirë


Gjatë zhvillimit të një pakete PPP dhe krijimit të një strategjie për privatizimin e terminaleve, duhen identifikuar dhe organizuar kriteret për përzgjedhjen e ofruesve të ftuar dhe propozimit më të mirë për nevojat e një koncesioni të caktuar.

Kriteret e përzgjedhjes mund të ndahen në tri grupe:

- Kriteria parakualifikuese
- Kriteria për vlerësimin teknik
- Kriteria për vlerësimin financiar

8.2 Kriteret bazë parakualifikuese

Kriteret parakualifikuese lidhen kryesisht me profilin si korporatë dhe me profilin e financiar të ofruesit, i cili duhet të tregojë:




- Eksperiencën e tij në menaxhimin dhe veprimtarinë me shërbimet dhe paisjet portuale
- Eksperiencën e tij në menaxhimin dhe veprimtari të tjera portuale dhe/ ose në projekte këshëllimore
- Eksperiencën e tij në Shqipëri (shteti që fton ofertat për projektin)
- Biznesin e tij veprues në të gjithë botën
- Pronësinë mbi aksionet e kompanisë
 - o Përshtatshmërinë e strukturës së korporatës
 - o Aksionerët kryesorë
 - o Aksionet e aksionerëve kryesorë si kapital
- Pjesëmarrje të mundshme të përdoruesve në kompani (p.sh. linjat e transportit detar, transportuesit, operatorët shumë modalë).
- Pozicionin më të fundit financiar

8.3 Kriteret bazë teknike dhe tregtare

Vlerësimi teknik që duhet bërë për cdo transkasion, duke marrë parasysh llojin dhe specifikat e paisjeve, duhet të jetë specifik sipas projektit. Kriteret duhet të përqëndrohen në elementët e mëposhtëm kyc:

- Cilësia e planin të propozuar të biznesit
 - o Niveli praktik i supozimeve
 - o Garancitë e ofruara dhe konfirmimi i të dhënave
 - o Niveli i detajimit teknik
 - o Përshtatshmëria e objektivave menaxheriale të shpallura
 - o Qëndrueshmëria e parashikimit të kërkesës së tregut
 - o Mundësia për të tërhequr biznes të ri
 - o Performanca e pritur financiare e kompanisë
 - Saktësia e parashikimeve të flukseve të arkës
 - Saktësia e planitë të financimit
 - Saktësia e parashikimit të performancës
- Struktura e korporatës e popozuar për t'u zbatuar për kompaninë
 - o Niveli i auonomisë
 - o Funkcionaliteti i strukturës së propozuar
 - o Aftësia për të prodhuar iniciativa të reja
 - o Aftësia për të monitoruar performancën
 - o Kualifikimet e drejtorëve ekzekutivë të propozuar dhe e personelit kyc operacional
- Plani i veprimit për pajisjet
 - o Përshtatshmëria e përgatitjeve operacionale
 - o Qëllimi i përmirësimit të kapacitetit
 - o Cilësia e pajisjeve dhe sistemeve të propozuara
 - o Cilësia e operimit të terminalit dhe sistemit të kontrollit
 - o Efikasiteti i planit për të zgjidhur problemet ekzistuese dhe për të përmbushur sfidat e ardhshme
- Kapacitetet për të investuar në mjete, pajisje dhe sisteme
 - o Shepenzimet kapitale, CAPEX, të propozuara
 - o Pësia e burimeve të veta
 - o Faza e programit të financimit
 - o Burimet e financimit të jashtëm të propozuar



- Plani i punësimit dhe mekanizmat e propozuar për transferimin e njohurive
 - o Kushte të përgjithshme të punësimit që ofrohen
 - Nivelet e rrogave dhe pagesave
 - Bonuse, pagesa stimuluese dhe shpërblime të tjera dytësore
 - Perspektivat për zhvillimin e karrierës
 - Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore
 - Propozime për të vënë në punë ose adaptuar forcën punëtore
 - o Trajtimi i zhvillimit të burimeve njerëzore në përputhje me kërkesat menaxheriale dhe operacionale dhe kualifikimet në dispozicion
 - o Kontributi i emigrantëve
 - Numri i emigrantëve dhe pozicioni i tyre
 - Kohëzgjatja e detyrave
 - Kontributi i pritur për transferimin e njohurive

8.4 Kriteret bazë financiare

Ashtu sic ndodh edhe me propozimet teknike, edhe propozimet financiare duhet të jenë specifike sipas projektit. Propozimet financiare të paraqitura nga ofrues të ndryshëm kanë nevojë për një teknikë vlerësimi që mundëson vlerësimin e tyre mbi cilësitë aktuale dhe kapërcimin e problemeve të krijuara nga:


- Elementë të ndryshëm që përbëjnë të ardhurat, secili me afatet përkatëse
- Ndryshimet në kurset e këmbimit
- Pasiguria e parashikimeve përdorura

Problemi i parë mund të kapërcehet duke zgjedhur zgjidhjen me “vlerën aktuale më të lartë”. Vlerësimi financiar do të vazhdojë më tej duke u bazuar në të ardhurat e agreguara për çdo ofrues dhe ofruesi fitues do jetë ai me vlerën aktuale më të lartë. Ky ushtrim duhet bërë duke përdorur norma skontimi reale dhe mundësisht duke marrë një periudhë jo më të madhe se 20 vjet (përdorimi i periudhave më të gjata nuk do të ketë ndonjë efekt mbi rezultatin e krahasimit, të paktën nëse është përdorur një normë reale skontimi). Ofruesi duhet të dorëzojë një formular me “ofertën financiare” të kompletuar në të cilën janë shënuar të gjithë përbërësit kryesorë të të ardhurave që i ofrohen autoritetit kontraktues (p.sh. komision licensimi, komision vjetor qeraje, royalties, pagesa për përvetësimin e disa paisjeve që i përkisnin më parë autoritetit kontraktues, etj).

Problemi i dytë mund të kapërcehet nëse kompensimet financiare paraqiten dhe paguhen në një njësi që përfaqëson një tërësi me valutat e zgjedhura (kjo nënkupton që edhe koncesioner ka të drejtë të vendosë tarifat e tij në valutë të huaj).

Zgjidhja për problemin e tretë konsiston në përdorimin e qarkullimit dhe parashikimit të vetë autoriteti kontraktues për të vlerësuar ofertat financiare të ofruesve të ndryshëm.

Vlerësimi financiar mund të bëhet duke u mbështetur edhe në kriteret e tjera, si për shembull qeraja vjetore fikse më e lartë, royalty më e lartë për kontenier ose për ton. Këto metoda alternative do konsiderohen të pranueshme vetëm nëse një komponent specifik i të ardhurave duhet peshuar dhe nëse një teknikë vlerësimi e plotë është përdorur paraprakisht.



Si përfundim, ekonomisti duhet të argumentojë mirë që faktori vendimtar duhet të jetë ajo cka është më fitimprurëse për ekonominë kombëtare. Duke marrë si shembull vendvendankorimin e madh në Durrës, çfarë do t'i shtonte më shumë vlerë ekonomisë dhe çfarë do rriste shkallën e punësimit për ekonominë në përgjithësi? Një vendankorim cimentoje, qymyri ose hekuri? Apo ndonjë tjetër lloj vendvendankorimi?

8.5 Monitorimi i efikasitetit dhe cilësisë së PPP: Indikatorët kyc të përformancës

Cdo koncesion që jep autoritet përballat me vendime që kanë të bëjnë me mënyrat se si duhet monitoruar përformanca e operatorëve privatë. Nga ana tjetër, autoriteti portual mund t'i kërkojë koncesionerit që të përmbushë disa nivele të caktuara përformance në kategori të caktuara të aktivitetit operacional. Kjo përfshin zakonisht produktivitetin dhe masat e cilësisë së shërbimit, si për shembull:

- Numri i lëvizjeve ose tonazhi i mbajtur gjatë itinerarit anije-tokë, për orë, në vendankorim
- Numri i lëvizjeve ose tonazhi i zhvendosur me vinc për orë
- Numri i lëvizjeve të kryera ose tonazhi i lëvizur për metër linear të molit në vit
- Indeksi i cilësisë së shërbimit për koha e një cikli të anijeve
- Indeksi i cilësisë së shërbimit për koha e një cikli të kamionëve
- Indeksi i cilësisë së shërbimit për koha e një cikli të trenave (ku dhe kur është e aplikueshme)

Për të matur se sa mirë përdoren pajisjet e dhëna me koncesion, autoriteti portual përfshin shpesh në kontratat e koncesionit vlerat minimale, të cilat ndryshojnë sipas llojeve të ndryshme të terminaleve në port, për vlerat e mëposhtme:


- Numri i lëvizjeve ose tonazhi i zhvendosur për metër të gjatësisë së vendvendvendankorimit
- Numri i TEU ose tonazhi i zhvendosur për metër katrorë të zonës së terminalit

Kritere të tjera jo operacionale që mund të përfshihen janë:

- Frekuenca e kohës së humbur nga dëmtimet
- Frekuenca e programeve të trainimit të personelit dhe efikasiteti i këtyre programeve
- Zbatimi dhe aplikimi i një sistemi menaxhimi të ambjentit rrethues
- Funksionimi i një sistemi menaxhimi për sigurinë

KPI kritike = garancite mbi volumet

Në kontekstin e ndërtimit të strategjisë PPP për Durrësin, garancite mbi volumet konsiderohen si parameter kyc oferte. Është rënë dakord që volumet do të vendosen neper kontrata që do të lidhen nga operatorët; është e rëndësishme të theksohet që garancite mbi volumet nuk do të vendosen nga Autoriteti Portual. Për të qenë me të sakte, Autoriteti do të përzgjedhë një operator sipas disa kriteresh vlerësimi, përfshirë një propozim mbi garancinë e volumeve. Duke marrë parasysh që ofrueset do të mundshëm do t'ju kërkojë të bëjnë parashikimet e tyre për ngarkesat, APD do të duhet të përdorë parashikimet e veta si reference për të vlerësuar propozimet e ndryshme



(p.sh. baze e njejte per krahasimin e te ardhurave te pritshme te APD nga koncensionit me propozimet e ardhura nga ofrues te ndryshem)

Praktikisht, APD do te perzgjedhe bazuar ne kritere te ndryshme, perfshire e dhe volumet e synuara. Sapo rezultati i synuar te jete percaktuar ne formen e garancise minimale mbi volumet, ky rezultat i synuar do te shnderrohet ne nje KPI kontraktore dhe detyrim kontraktual per operatorin, dhe do t'i jape keshtu APD mundesine per monitoruar performancen dhe pere te siguruar nje nivel te caktuarte te ardhurave koncensionare.

Ne marreveshjet e koncensionit, nje nivel minimal i garancise mbi volumet percaktohet vertet si KPI; ai sherben si baze per pagesat minimale koncensionare duke garantuar keshtu te ardhurat e APD dhe e lejuar ate te transferoje riskun e tregut nga autoriteti portual tek operatori. Per te perfrazuar, ne propozojme trajtimin e meposhtem:


8.6 Sistemet e penaliteteve dhe stimujt e performancës

Për të tre grupet e indikatorëve kyc të performancës të listuara më sipër duhet vënë në zbatim edhe një sistem penalitetesh. Përsiatja për penaltetin bazohet në pasojat financiare për autoritetin portual në rastet kur operatori nuk përmbush objektivat ose detyrimet e tij. Në lidhje me grupin e parë të indikatorëve kyc, mund të përcaktohet një diferencë, e shprehur si përqindje e niveleve dhe periudhave të synuara, që përcakton momentin dhe nivelin e penaltetit.

Nga ana tjetër, autoriteti portual mund të shmangë matjen e performancës së koncesionarëve kundrejt kritereve operationale, dhe ndërkohë mund të përdorë momentet e investimit. Performanca e operatorit në këtë rast matet me faktin nëse ai ka plotësuar ose jo në momentin e duhur investimin e paracaktuar më parë si rezultat i marrëveshjes me autoritetin kontraktues dhe me operatorin e ardhshëm privat, si pjesë e programit të investimit të projektit gjatë bisedimeve mbi kontratën. Problemi me mënyrën e momenteve të investimit është që ato që planifikohen në fillim të periudhës së koncesionit mund të jenë jorealiste në afat të gjatë sepse parametrat tregtarë, teknikë dhe operacionalë ndryshojnë krejtësisht gjatë periudhës së koncesionit.

Metoda e momenteve të investimit qëllimisht përfshin cdo indikator kyc performace për produktivitetin ose për të tjetra. Supozimi kyesor që përforcon këtë metodë është fakti që një operator efikas do të sigurojë pa shumë kontroll nga rregullatori praktika efikase operationale me qëllim përmbushjem e momentetve e investimit dhe nuk do të shmaget nga pagesa e detyrimeve të tij koncesionare.


Nga pikëpamja e APD, avantazhi i përdorimit të indikatorëve kyc të performancës operationale është që kjo metodë lejon autoritetin portual të monitorojë në të ardhmen ecurinë e koncesionerit nga ana e performancës operationale. Nëse ka dicka që nuk shkon në performancë, APD duhet të jetë në gjendje ta identifikojë në kohë problemin dhe të zbatojë penaltete ose të përdorë mënyra të tjera që ka në dispozicion për të nxitur operatorin të përmirësojë efikasitetin operacional. Gjithësesi kjo kërkon një përcaktim të kujdesshme të indikatorëve kyc të performancës dhe të rezultateve që synohet të arrihen. Vetëm indikatorët që tregojnë performancën reale të operatorit duhet të përfshihen. Ato matje mbi të cilat APD nuk ka kontroll ose ka pak kontroll (si për shembull koha e qëndrimit e ngarkesave ose kontenierëve) duhen përjashtuar. Kjo



mënyrë i përgjigjet edhe vërejtjes se investitorët e interesuar besojnë që në disa raste operatorët e terminaleve nuk mund të kontrollojnë në mënyrë efikase pjesën më të madhe të indikatorëve të produktivitetit, dhe si rrjedhojë nuk mund të konsiderohen përgjegjës për mosplotësim të rastësishëm. Ndërsa vlerat e rezultateve të synuara ndikohen më shumë nga parametrat e shumtë që përcaktojnë kontekstin operacional të mjeteve dhe pajisjeve të dhëna në koncesion. Për më tepër performanca e indikatorëve kyc të performancës i hap rrugë ndërhyrjes së tepërt të APD tek aktiviteti i operatorit dhe mund të çojë në konflikte të panevojshme rreth praktikave operationale, standarteve të performancës dhe përcaktimeve, formulave dhe njësive të matjes të zbatuara.

Avantazhi kryesor i metodës së momenteve të investimit është thjeshtësia e saj dhe fleksibiliteti që i jep koncesionerit për të arritur të ardhurat e dëshiruara. Megjithatë disavantazhi kryesor mund të jetë rreziku që nëse lihet pa kontroll, operatori privat mund të mos rezultojë me përmirësimin e performancës operationale duke dëmtuar kështu të gjithë realizueshmërinë e koncesionit. Gjithësesi, risku nuk duhet mbivlerësuar, përveç rasteve kur kapitali i premtuar për investim nuk shoqërohet me përmirësime domethënëse në performancë dhe si rrjedhojë mund të çojë në rritje të kostove fiks duke i bërë operationet e koncesionit jo më të sukseshme.

Me prezantimin e “Standarteve për Cilësinë e Terminaleve të Kontenierëve” (propozuar nga shoqëria e klasifikimit Germanischer Lloyd), autoritetet kontraktuese tanimë kanë një mënyrë të tretë për dhënie me koncesion të terminaleve të kontenierëve. Ata thjesht mund të përcaktojnë që koncesioneri të paraqesë një herë në vit certifikatën standarte për indikatorët e cilësisë për terminalët e kontenierëve, cka nënkupton se ai ka përmbushur kërkesat ndërkombëtare minimale të performancës të vendosura nga shoqëria certifikuese. Kjo duhet duhet të kënaqë plotësisht autoritetin kontraktues por gjithashtu edhe përdoruesit dhe palët e interesuara të terminalit.



9.0 PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Mbi ndryshimet ligjore dhe institucionale dhe strategjinë PPP

Megjithëse në portet shqiptare Ligji N° 9130 mbi Autoritetin Portual duhet të jetë ligji bazë tek i cili duhet mbështetur drejtimi dhe veprimtaria e portit, është Ligji i ri mbi koncesionet N° 9130 që ka përparësi dhe në këtë mënyrë pengon kalimin nga një port shërbimi në një port me status pronari. Problemi i autoritetit kontraktues i ngritur nga ligji mbi koncesionet ka nevojë për një zgjidhje urgjente. Marrëveshja tripalëshe e koncesionit, e propozuar për dhënien me koncesion të terminalit të kontenierëve si një rrugëdalje për ngricën e krijuar nga kushtet kontradiktore të dy ligjeve të sipërpërmendura, nuk mund të konsiderohet si zgjidhje afatgjatë, pasi ajo përmban shumë paqartësi ligjore në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e të tria palëve. Zgjidhja e vetme dhe e qëndrueshme në kohë, në kontekstin e portit pronar, është që APD të bëhet autoriteti kontraktues dhe të firmosë direkt marrëveshjet e koncesionit me ofruesin e preferuar për terminale të ndryshme të ofruara për koncesion. Kjo natyrisht kërkon ndryshime të ligjit për koncesionet. Ndaj rekomandimi që i drejtohet Qeverisë është që të fillojë sa më shpejt procesin e duhur ligjor për të shkuar drejt përshtatjes dhe ndryshimit të nenit 5 të ligjit mbi koncesionet, duke i dhënë kështu autoritetit portual të drejtën për të vepruar si autoritet kontraktues.

Cështja tjetër kritike me të cilën po përballet porti i Durrësit dhe që kërkon gjithashtu një zgjidhje sa më të shpejtë, në mënyrë që të lejojë APD të funksionojë si një port pronar, është pronësia që ka Durrës – Kürüm Shipyard Sh.a mbi tokën ku ndodhet kantieri i ndërtimit dhe riparimit të anijeve. Një situatë shumë komplekse është krijuar nga kombinimi i shitjes së kësaj toke të pozicionuar strategjikisht tek një kompani private, dhe kërkesave të Grupit, që është pronar i kësaj kompanie, për të marrë me koncesion terminalin e trageteve/pasagjerëve dhe të drejtat e operimit në një strukturë për manovrimin e skrapit . Pasiguria që rrethon të ardhmen e kësaj toke portuale tregon njëfarë dykuptueshmërie (*ambiguity*) në lidhje me vendin e propozuar dhe realizimin e terminaleve që janë propozuar në këtë masterplan. Edhe në këtë rast është Qeveria që ka mundësinë t'i japë cështjes një zgjidhje që mund të kënaqë si pronarin egzistues të tokës (Durrës - Kürüm Shipyard Sh.a) ashtu edhe autoritetet (MPPTT dhe APD).

Nga të gjitha paketat e ndryshme PPP që janë propozuar në këtë kapitull, ajo që konsiderohet si më e përshtatshme brenda konceptit të portit pronar është koncesioni i rregullt. Kjo pakete siguron përfshirjen e perkohshme dhe të pjeseshme të sektorit privat dhe ashtu siç ka treguar eksperiencën botërore, ndihmon në rritjen e aftësive menaxhuese të entiteteve të përfshira, zvogëlon kërkesën për Thesarin e Shtetit, zhvillon cilësinë e shërbimeve portuale, redukton cmimet për shërbimet portuale, nxit sipërmarrjen private dhe lejon transferimin e teknologjisë dhe menaxhimit të tipit "state-of-the-art".

Nga të gjitha paketat e ndryshme të PPP që janë konsideruar në këtë kapitull, ajo që është më e përshtatshme brenda konceptit të portit pronar është koncesioni normal. Kjo sjell një përfshirje të pjesshme dhe në kohë të kufizuar të sektorit privat, dhe, siç ka treguar përvoja botërore, ndihmon që të rriten kapacitetet menaxhuese të entiteteve të përfshira, redukton kërkesat ndaj buxhetit të shtetit, rrit cilësinë e shërbimit portual, redukton cmimin e shërbimeve portuale, stimulon sipërmarrjen private dhe lejon një transferim të teknologjisë dhe metodave moderne të menaxhimit.



Se cilët entitete do të ishin partnerët privatë më të mirë për APD, do varet shumë nga tipi i praktikës me të cilën do jepet koncesioni. Për terminalin e kontenierëve, në mënyrë që të menaxhohet si një strukturë me shumë përdorues, koncesionerët e mundshëm mund të jenë ose operatorë kontenierësh me reputacion ose një *joint –venture* mes një operatori terminali të tillë dhe një ose shumë kompanish transportuese (megjithëse nuk duhen përjashtuar kombinime të tjera të *joint –venture*). Kjo do të garantonte një ekspertizë operacionale dhe arritjen e niveleve minimale të prodhimit. Për terminalin e mallrave të thata vështirësia për autoritetin kontraktues është që ti japë koncesionin një operatori që mund të gjenerojë ngarkesë të mjaftueshme për të përdorur plotësisht kapacitetin e terminalit dhe që ka qëndrueshmërinë financiare për të bërë investimet e duhura. Rrjedhimisht, importuesi ose eksportuesi i ngarkesave të mëdha do jetë me shumë mundësi operatori i këtij terminali. Për terminalin e pasagjerëve dhe trageteve zgjidhja më e mirë do të ishte që koncesioni t'i jepej një operatori me eksperiencë në terminalin e pasagjerëve/ trageteve, ose një operatori për shërbime tragetesh/ katamaranësh, ose një *joint-venture* midis një operatori në terminal dhe një shoqërie tragetesh/ katamaranësh.


Probabiliteti që konkurrenca në Portin e Durrësit të krijohet vetë, për çdo alternativë të shpjeguar në paragrafin e mësipërm, është shumë e vogël ose thuajse joekzistente. Autoriteteve do ju duhet të pranojnë që konkurrenca në këtë treg mund të krijohet vetëm nëpërmjet tenderit të hapur ndërkombëtar për kontratat. Mungesa e kundërshtimeve në treg ose mungesa e të paktën një shumë të kufizuar të konkurrencës ndërportuale, shpjegon faktin se pse përzgjedhja e ofruesit më të mirë duhet bazuar në një sërë kriteresh të përcaktuara përpara se procesi i ofertës (ofertave të parakualifikimit, ofertave teknike dhe financiare) të fillojë. Kjo është edhe arsyeja pse në një marrëveshje koncesioni duhen përfshirë një tërësi indikatorësh që masin performancën operacionale, të cilave iu duhet përmbajtur në mënyrë rigorozë. Një kombinim i indikatorëve kyç të performancës me momentet e investimit do të ishte gjithashtu e pranueshme, me kusht që momentet e investimit të përshtaten vazhdimisht ndaj ndryshimeve të parametrave tregtarë, teknikë dhe operacionale.

Mbi implikimet financiare të zbatimit

Investimet e projektuara dhe zhvillimet e kostove të parashikuara në Masterplan kërkojnë ndërmarrjen e investimeve shumë të rëndësishme në portin ekzistues; keto investime konsiderohen shumë të mëdha për t'u përballuar nga një entitet i vetëm si APD. Gjithashtu, pjesa që i mbetet Autoritetit dhe që ka të bëjë me shumë me rinovimin e strukture dhe riorganizimin e disa prej zonave, plus kompensimin potencial për të rifituar kontrollin mbi një tokë të portit që aktualisht është në pronësi private, shfaqet që në periudhën e parë të zbatimit, duke kërkuar në të njëjtën kohë borxhe shtese, përveç kredive tashme të marra.

Për keto investime janë të domosdoshme për të optimizuar kapacitetin ekzistues dhe për të terhequr trafik të ri në Durrës, me objektivin e madh për të mbështetur zhvillimin e tregtisë në Shqipëri dhe për të përkrahur prodhimin industrial dhe eksportet.

Shkeputja e APD nga operacionet e terminalëve dhe shpenzimet perkatëse është një strategji me vend që shërben për të transferuar riskun e zhvillimit tregtar tek partneret private, për të marrë pjesë në zhvillimin tregtar të portit të Durrësit si dhe për të mbështetur tranzicionin e kalimit drejt modelit të menaxhimit të portit Pronar; optimizimi i



burimeve financiare te APD eshte outputi pozitiv i nje strategjie te tille, e cila siguron vendosjen e nje strukture te balancuar PPP qe garanton ndarje te drejte dhe te barabarte te vleres (nepermjet mekanizmeve te duhur koncensionare). Nga ana tjeter, zbatohet transferimi i te ardhurave, cka modifikon gjithashtu strukturen financiare te kompanise; ashtu sic eshte permendur edhe me siper, transferimi i ketyre te ardhurave do te realizohet nepermjet pagesave koncensionare duke reflektuar me se miri riskun e ndermarre nga cdo partner ne terma investimi dhe ekspozimi tregtar. Ne kete kuptim, APD duhet te meshoje mbi aftesine e operatoreve portuale private per te menaxhuar trafikun, ne menyre qe a ivete te perqendrohet ne perpjket financiare per optimizimin e hapesires dhe per rinovimin e infrastruktures, me qellim qe te mbeshtese atraktivitetin e prgjithshem dhe eficencen e portit te Durrësit per te gjithë klientet dhe perdoruesit e tij.

Paketa PPP eshte krijuar ne parime qe balancojne nga njera ane riskun dhe nga ana tjeter te ardhurat, te garantuara sigurisht nga mekanizmat e duhura koncensionare. Nderkohe qe operatorët dhe investitorët jane te angazhuar te zhvillojne projekte investimi me nje kthim minimal te caktuar, APD do te shperblehet nga risku i ndermare ne investimet portuale (rinovimi i infrastruktures si per shembull muret e kalates apo gerryerja) e cilat realizohen per te rritur atraktivitetin e portit per klientet dhe perdoruesit.

Ky parim realizohet me mekanizma pagese koncensionare, ne te cilat operatorët private rishperndajne pjese te vleres se pergjithshme tregtare qe gjenerohet ne portin e Durrësit, per sa kohe vetefinacimi i tyre eshte shperblyer ne menyre te mjaftueshme bazuar edhe ne riskun qe ata kane vene ne zhvillimin e biznesit te Durrësit. Nderkohe qe mekanizmat koncensionare zakonisht prezantojne kombinime te ndryshme, pikepamja aktuale eshte te identifikohen nivele te mjaftueshme te flukseve te arkës per te mbuluar pagesa te tilla, pavaresisht cdo strukturimi; strukturimi mendohet te perpunohet me tej kur paketa koncensionare te jete ndertuar dhe vene ne zbatim.

Per APD rekomandohet qe te cliroje bilancin e tij nga investimet qe do t'i tranferohen sektorit privat, si per shembull pajisjet, makinerite dhe disa superstruktura. Nga ana tjeter APD mund te kete me shume fleksibilitet ne financimet e veta, per sa kohe qe korniza tregtare ne port krijon vlere te mjaftueshme per t'u rikuperuar nga Autoriteti i Portit pronar sipas streteggjise se re PPP.

Kjo gje prek strukturen e tarifave qe zbatohet aktualisht ne Durres. Ne menyre qe te ardhurat te rriten ne te njeften linje me investimet e propozuara dhe me rinovimin e portit, kerkohet patjeter nje rishikim i tarifave. Se pari, eshte vene re se aktualisht porti i Durrësit ka tarifa te ulta, cka eshte ne linje me strukturen e shpenzime operacionale aktuale; se dyti, disa investime te medha kerkohen te behen ne disa prej terminaleve te specializuara qe i sherbejne klienteve te medha industriale. Ne keto raste cmimi i tregut nuk ka shume lidhje dhe struktura tregtare lidhet me shume me transferimin e cmimit, meqenese kosto e tranzitit integrohet me koston e prgjithshme te produktit te prodhurar. Meqenese kjo gje dihet vetem nga ofrues te mundshme te ardhshem, supozimi qe behet eshte qe duhet e kete nje rritje ne tarifa per te reflektuar te ardhurat qe kerkohen per te mundesuar investimet ne kete zone dhe per ta perkthyer me pas ne cmim tregu (i rregulluar per nerritje)

Te ardhurat jane faktori kryesor prapa suksesit te zbatimit te strategjise PPP ne Durres; nderkohe ekzistojne edhe parametra te tjere si per shembull kohezgjatja e kontrates, por ato kane impakt me te vogel sepse pjesa me e madhe e investimit qe lidhet me rinovimin e organizimit operacional te portit dhe zhvillimit te trafikut te ri, realizohet ne



periudhe afatshkurter. Kontratat afatgjata jane terheqese per investitorin privat nga nje pikepmaje cilesore, por ato nga ana tjeter penalizojne APD per te qene fleksibel ne afat te gjate qe te cliroje token e tij ne linje me ndryshimet afatgjata. Aty ku eshte e mundur, opsionet 15 vjecare + 10 vjecare rekomandohet se mund te ofrojne aktraktivitet afatgjate per investitoret, nderkohe qe siguron edhe pak fleksibilitet ne rast parashikimi te nje performance te ulet.

Ne terma financimi, rekomandohet qe te minimizohen investimet e bera nga APD. Meqenese investimi ne terminalin e trageteve perfaqeson nje investim thelbesor, tashme te planifikuar dhe te financuar nga porti, ne opsion interesant do te ishte te hiqej dore nga ky investim i bere, ose te jepej me koncension kundrejt nje pagese te madhe te menjehershme qe do te mundesonte portin te rikuperonte vleren prej operacioneve me tragetet, qe perfaqesojne nje pjese te madhe ne te ardhurat tregtare te portit. Ne te njejten kohe, ky aspekt dueht kontrolluar me kuadrin perkates ligjor ne lidhje me pronesine e terminalit kundrejt financuesit te projektit.

Pa kete opsion specifik, APD do t'i duhet te financonte detyrim ne masen 63 deri ne 67.4 Million EUR (pjeserisht e rregulluar deri ne masen 87%). Nderkohe qe vihet re qe ka te ardhura te medha koncensionare nga aktivitetit me tragetet/ kruzerat, rekomandohet qe te vendosen disa kushte minimale per terminalin e tjere per mekanizmat e pagesave, ne menyre qe te ardhurat dhe risku i portit ne disa linja biznesi te shperndahen sa me mire (duke rregulluar edhe tarifat qe zbatohen aktualisht). Propozohet si fillim nje prag prej 10% te te ardhurave i cili i korespondon me rinovimin specifik te tarifave.

Implikimi financiar per APD eshte qe ai do te arrije te mbaje raporte dhe angazhime te kenaqshme sapo zbatimi i plote te jete realizuar, me kusht qe te sigurohen mjete te ndryshme financimi me kushte interesante, si per shembull kredi nga banka shumekombeshe te kombinuuar me garanci shteterore.

Nderkohe qe 32 Milion Euro jane gjetur ne lidhje me disa projekte specifike, pjesa qe mbetet duhet mbuluar me kredi te tjera ose me dy burime alternative financimi. Nese APD mund te siguroje nje tjeter kredi prej 22.5 Milion Euro, sipas informacionit te mbledhur ne Shqiperi, pjesa qe mbetet mund te mbulohet fare mire me nje kredi afatshkurter, qe do te merret kryesisht per te mbajtur pozicionin e shendoshe te flukseve te arkës ne vitet kritike kur do te realizohen investimet madhore.

Perfundimisht, ne terma tarifash, pritet qe struktura e re e Librit te Tarifave te sjelle perfitime per te gjihte portin e ristrukturuar, duke lidhur te ardhurat e operacioneve te terminalleve me investimet thelbesore qe kerkohen per te rinovuar superstrukturat dhe pajisjet, si dhe per te zbatuar konceptin e ri te terminalizimit qe bazohet ne sisteme moderne menaxhimi. Nga ana tjeter, kjo strukture bazohet ne menyren "Activity Based Costing" duke patur parasysh portin me statusin e sotem. Ne sistemin e porti pronar, ne terminalin do te operojne entitetet private te cilet mund te kene nje tjeter strukture te kostove operacionale. Si rrjedhoje keto tarifa te reja perfaqesojne nje "benchmark" te mire qe do te sherbeje ne studimin e propozimeve te ardhshme per privatizimin e terminalleve si dhe ne lehtesimin e masave qe APD duhet te marre per sigurimin e te ardhurave.

Aneksi 10

Politika Kombetare

Barbarossastraat 35
P.O. Box 151
Nijmegen 6500 AD
The Netherlands
+31 (0)24 328 42 84 Telephone
++31 24 360 96 34 Fax
info@nijmegen.royalhaskoning.com E-mail
www.royalhaskoning.com Internet
Arnhem 09122561 CoC

Document title Establishment / Update of the Masterplan for
the Port of Durrës

Document short title

Status

Date 28 March 2008

Project name Establishment/Update of the Masterplan of
the Port of Durrës

Project number 9S0723.21

Client European Commission

Reference 9S0723.21/DFR/401180/Nijm

Drafted by

Checked by

Date/initials check

Approved by

Date/initials approval



CONTENTS

	Page
ANNEX 10: POLITIKA KOMBETARE	1-1
1 HYRJE	1-1
2 KONTEKSTI DHE OBJEKTIVAT	2-2
3 POLITIKA KOMBETAR PORTUALE: PERMBAJTJA	3-3



ANNEX 10: POLITIKA KOMBETARE

1 HYRJE

Ne perputhje me termat e references kerkohet qe te prergatitet nje studim (Mater – Plann) kute parashikohet zhvillimi afat – gjate i Portit te Durrësit. Porti I Durrësit eshte porti me I rendesishem I vendit dhe nje porte tregtare dhe ekonomike e Shqiperise. Per kete arsye zhvillimi i tij percakton te ardhmen e zhvillimit ekonomik dhe tregtar te Shqiperise ne nivel kombetar dhe nderkombetar. Aq me teper, nje rendesi e tille e nje porti te vetem ne sistemin kombetar te porteve, eshte e rekomandushme qe te kete nje plan strategjik zhvillimi brenda nje Politike Kombetare per Portet. Kjo politike duhet te tregojë rruget e zhvillimit te ketij sektori te ekonomise ne nivel kombetar ku cdo port duhet te kete nje master – plan te vetin qe t'i pergjigjet ketyre politikave.

Meqenese nje politike e tille nuk eshte akoma pergatitur ne Shqiperi, studimi i Master – Planit te Portit te Durrësit eshte zhvilluar duke pranuar qe ky port do te jete porti kryesor qe do te mbeshtese zhvillimin e tregetise ne Shqiperi. Keshtu qe nje master – plan i tille parashikon zgjerimin e Portit te Durrësit si porti me i rendesishem qe do te mbaje rolin udheheqes nder portet e tjera. Poashtu ka dhe tregues te tjere qe na detyrojne (mbeshtesin) qe te pranojme nje gjete tille. Sic jane:

- Vend – ndodhja dhe lidhja e tij me rjetin e transportit
- Inisiativa e TEN (Trans-European Network) per te ndertuar Koridorin e VIII
- Eshte tashme I zhvilluar nje nivel maritim dhe komercial ne qutetin e Durrësit.
- Zhvillimi ne nje stad te caktuar tashme te disa sektoreve si p.sh. Terminali I Kontainerave ,apo Terminali I Trageteve

Keto verejtje te shkuera jepen me qellimin qe te ilustrojne nevojën per te patur nje port te integruar kryesor ne panin sektorial.



2 KONTEKSTI DHE OBJEKTIVAT

Sektori portual është me lëndesishmi në zhvillimin ekonomik në shkallë kombëtare. Një sektor i fuqishëm dhe eficient portual do të thotë një kosto e ulët transporti dhe tranziti gjë që do të stimulojë tragjetinë dhe prodhimin.

Historikisht, vendet janë përfshirë intensivisht në zhvillimin e porteve të tyre nepermjet prezencës së vetë shtetit si përgjegjësi kryesor për aktivitetet në port, nga investimet për intensifikimin e përpunimit e deri tek siguria & sigurithia..

Kohët e fundit, gjithsesi tregojnë që ka një përfshirje të vazhdueshme të qeverive në sektorin portual. Qeveritë kanë inkurajuar tërheqjen e Privateve në sektorin portual për aftësinë e tyre që të kryejnë shërbimet në mënyrë të shkelqyer dhe aftësinë për të investuar në infrastrukturën portuale, gjë që tani shpesh duket në Sektorin portual. .

Ky proces tashmë ka filluar dhe në Shqipëri. Me nxhjerjen e Ligjit Nr. 9130 të dt. 8 Shtator 2003, Parlamenti i Republikës së Shqipërisë futi konceptin e portit “Land-Lord” dhe përcaktoi principet organizative të Autoritetit përgjegjës të porteve të tilla, rregullat, funksionet dhe administrimin si dhe marrëdhëniet me operatorët dhe organet shtetërore.

Ligji mbi Autoritetin Portual përcakton portin “land-Lord” si një port që administrohet nga Autoriteti Portual duke manaxhuar token dhe infrastrukturën e portit si pronën e saj, por nuk përfshihet në shërbimet dhe investimet në paisje. Roli i portit “land-lord” është që Autoriteti Portual t’i sektorit privat rol më të madh në drejtimin e operacioneve dhe shërbimeve në port.

Është e dukshme që në një sektor ku përgjegjësia komerciale dhe investimet janë ndare ndërmjet shtetit dhe privatit, roli i qeverisë si lehtësues dhe kontrollues i një zhvillimi të qëndrueshëm, bëhet me lëndesishëm. Kështu që sipas opinionit të nevojat për një “land-lord” koncept në një Politikë Kombëtare për Portet, vetëm rritet.



3

POLITIKA KOMBETAR PORTUALE: PERMBAJTJA

Pa pretenduar kompletimin e nje Politike Kombetare Portuale, duhet te kemi parasysh te pakten disa ceshtje qe krijojne nje prespektive kombetare:

1. Organizimi I sektorit te Porteve
2. Planifikimi afat-gjate i porteve
3. Financimi i sektorit te porteve
4. Hyrja ne treg
5. Zhvillim I qendrueshem
6. Manaxhimi I lidhjeve me rjetin kombetar dhe planifikimi urban

Organizimi I Sektorit te Porteve.

Duhet te percaktohet roli, pergjegjesia dhe mandati i akotoreve sektorial sic jane:

- Ministria e Ekonomise, Tregetise dhe Energjise
- Ministria e Transportit
- Autoriteti Portual
- Kapiteneria e Portit.
- Biznesi

Duhet te percaktohen rolet respective ne marrjen e iniciativave, perpunimin, aprovimin, zbatimin dhe kontrollin e cdo Politike Kombetare per Portet.

Planifikimi afat-gjate I porteve

Ndoshta elementi primar i nje Politike Kombetare per Portet duhet te perkthehet ne nje kerkese kombetare (dhe rajonale) afat-gjate per sherbiet portuale dhe kapacitetet ne mbi te gjitha nje strategji zhvillimi qe te shpie ne ceshtjet te tilla si:

- Vizionet & Objektivat e Zhvillimit Kombetar te Porteve
- Parashikimi I kerkeseve kombetare dhe vend-ndodhja etyre..
- Planifikimi kapaciteteve, ekzistuese, zgjerimeve, hapsirat e gjelberuara, modelet konkuruese brenda portit
- Performanca & Rinovimi I teknilogjise, proceseve dhe , organizimi.

Pershtatshmeria me Master – Planin e qytetit te Durrësit.

- Zgjerimi I ardheshem jashte teritorit aktual
- Vend-ndodhja e nje zone te gjelberuar jashte Terminalit te mmallrave rifuxho.
- Rritja e thellesise zhytjes ne terminalin e kontainereve pertej basenit aktual

Financimi ne sektorin e porteve

Ceshtejt te do tetrajtohen jane:

- Zgjedhja dhe zhvillimi I nje structure te pershtateshme te partneritetit shtet-privat
- Shkalla e kerkuar e panvaresise financiare te PDA: dhenia e fondeve dhe pergjegjesite ndermjet PDA dhe qeverise.
- Adoptimi I ardheshem I legjislacionit/direktivave europiane.
- Cmimet
- Mbi te gjitha ndikimi ekonomik I Politikës sektoriale te Portit duhet te jete I tille qe te justifikojë Vleren Direkte dhe indirekte ekonomike te parashikuar ne Politike.
- Aktualisht kuadri ligjor I koncesionit eshte I paqarte.
- Niveli I autonomise financiare eshte I pa qarte (autonomia/vet-financimi) kush do t'i beje investimet ne te ardhmen e afert ne port.
- Struktura e cmimeve aktuale ne port nuk eshte optimale.



Hyrja ne treg: Niveli me te cilin do te luhet ne kete fushe

Politika Kombetare e Porteve duhet te percaktoje nje udhesues te qarte te hyrjes ne treg per te siguruar nje konkurrence te ndershme e per me teper udhezuesi duhet te ndihmoje ne percaktimin e nje ekuilibri te pershtateshm ndermjet rregullave strukturale dhe konduktive. Shqetesimet e meparshme ishin si te krijohej tregu me disa rregulla te thjeshta te hyrjes ne treg si (cila firme do te hyje ne treg dhe me vfare aktiviteti) ndersa me vone shqesimet vijne mbi masat qe duhen marre per te ruajtur konkurrencen jo te ndershme, abuzumet mbi monopolin etregut, kontrolli i cmimeve, dhe te tjera rregulla perte siguruar nje konkurrence te ndershme.

Zhvillimi i Qendrueshem

Zhvillimi i qendrueshem eshte nje objektiv themelor i Bashkimit European. Ne kete concept jane te unifikuara te gjitha politikat e Bashkimit European e per rjedhoje dhe Sektori Portit. Ne dqofte se Shqiperia do te aderoje ne keto principe si kerkesat per nje zhvillim te qendrueshem duhet qe te ndertoje nje politike koherente dhe te koordinuar sepse nuk mund qe kjo te garantohet vetem nga mekanizmi i tregut. Kjo kerkon t paraprihet nga nje Politike Kombetare:

- Qendrueshmeria ambjentale
- Punesim neteardhmen,
- Cilesia e punes,
- Siguria dhe shendeti
- Te ruhen Standartet profesionale net e gjitha aspektet e politikës sociale.

Manaxhimi i Lidhjes me rjetin Kombetar dhe Planifikimi Urban

Nje aspect i rendesishem i portit eshte dhe manaxhimi i zonave pereth.. Nje port shpesh krijon nje pjese integrale me dendesimin e popullsise pereth tij. Zhvillimi i portit duhet qe te marre ne konsiderate dhe efektet negative qe krijohen nga aktivitetet e tij ne zonat e banuara pereth tij.

Shpesh zona e portit nuk eshte vetem nje hapsire qe shkakton shqetesime me funksione te tjera urbane dhe pengon zhvillimet e reja. Zona e portit nuk ka interes si per zone banimi ashtu dhe per aktivitet komercial nga pikpamja financiare. Zhvillimet buze detit jane meshume atraktive per komunitetin se sa per zgjerimin e portit. Nepermjet Strategjise Kombetare Portuale jepet nje zgjidhje ne nivele te larta duke parezgjidhje qe kenaqin dhe nivelin lokal dhe nivelin nacional.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë

Hyri në shtyp më 4.6.2009
Doli nga shtypi më 4.6.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 730 lekë